



**ME EMRIN E ALLAHUT
TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

FONDACIONI I KUR'ANIT
SHQIPËRI

DRITA E KUR'ANIT

REVISTË SHKENCORE E HULUMTIMEVE
DHE E STUDIMEVE KUR'ANORE

THE LIGHT OF QUR'AN

SCIENTIFIC JOURNAL OF QUR'ANIC
RESEARCHES AND STUDIES

TIRANË, 2015

Drejtör: H. Vullnet MERJA

REDAKSIA:

Prof. dr. Hajri SHEHU (*kryeredaktor*)

Sabrie FEZA (*zëvendëskryeredaktore*)

Prof. dr. Bedri BYLYKU (*anëtar*)

Prof. dr. Feti MEHDIU (*anëtar*)

H. Jetmir ÇELA (*anëtar*)

H. Sulejman efendi REXHEPI (*anëtar*)

H. Selim STAFJA (*anëtar*)

Redaktore: Liseda RAMAJ

Korrektura teknike: Vjollca KARAJ

Përkthyesit: Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU

©: Fondacioni i Kur'anit

Del katër herë në vit.

Viti VIII, 2015, Nr. 1 (32)

Shtypur në Shqipëri, në shtypshkronjën "LILO"

ISSN 2309-3668

Adresa e redaksisë:

Fondacioni i Kur'anit

Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272

Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana - Albania

Website: www.fqurani.com

E_mail: f_quran114@yahoo.com & quranfondation114@gmail.com

Director: Haji Vullnet MERJA

EDITORIAL BOARD:

Prof. Dr. Hajri Shehu
Sabrie FEZA

Editor-in-chief
Vice-Editor-in-chief

Prof. Dr. Bedri BYLYKU

Member

Prof. Dr. Feti MEHDIU

Member

Haji Jetmir ÇELA

Member

Haji Sulejman ef. REXHEPI

Member

Haji Selim STAFA

Member

Editor: Liseda RAMAJ

Proofreader: Vjollca KARAJ

Translators: Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU

©: Foundation of Qur'an – Albania

A Quarterly Journal

Vol 9, issue 32, 2015

Printed in Albania by “LILO” Printing House

ISSN 2309-3668

Address of the Editorial Board:

Fondacioni i Kur'anit

Rruga “Hoxha Tahsin”, Nr.168, Kutia Postare: 8272

Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania

Website: www.fqurani.com

E_mail: f_quran114@yahoo.com & quranfondation114@gmail.com

PASQYRA E LËNDËS

HYTBJA E LAMTUMIRËS.....	10
Sejjid Ebul A'la Maududi	
PROFETËSIA E MUHAMEDIT' REVOLUCIONARI	
MË I MADH.....	18
Vullnet Merja	
PROFETI I MËSHIRËS.....	29
Abdu Daim Kahiil	
ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI VII.....	36
Metush Skeja	
TRURI DHE EDUKIMI.....	49
Qani Banaj	
PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ.....	56
Prof. Misbah Jezdi	
VEPRIMET E ALLAHUT' NUK JANË KOHËSORE.....	64
Muhsin Keraeti	
TA NJOHIM MË TEJ KUR'ANIN.....	69
Naser Mekarim Shirazi	
KUR'ANI, MREKULLI E PËRJETSHME.....	78
Vullnet Merja	
FJALOR KUR'ANOR: XHINET.....	89
Osman Nuri Topbash	
HISTORI E PROFETËVE - Profeti Shuajb.....	94
Liseda Ramaj	
BIBLIOGRAFI E REVISTËS "DRITA E KUR'ANIT",	
2014.....	105
VEPRIMTARI KUR'ANORE.....	109
Përmbledhjet në gjuhën angleze.....	113
Përmbledhjet në gjuhën arabe.....	119

TABLE OF CONTENTS

FAREWELL KHUTBAH.....	10
Sayyid Abul A'la Maududi	
MUHAMMAD'S PROPHETHOOD 'THE GREATEST' REVOLUTIONARY.....	18
Hajj Vullnet Merja	
THE PROPHET OF MERCY.....	29
Abdu Daem Kaheel	
SCIENTIFIC ARGUMENTS FROM THE QUR'AN VII.....	36
Metush Skeja	
BRAIN AND EDUCATION.....	49
Qani Banaj	
THERE IS A REMEDY FOR EVERY DISEASE.....	56
Prof. Mezbah Yazdi	
ALLAH'S DEEDS ARE NOT TEMPORAL.....	64
Muhsin Keraeti	
LESSONS FROM SURAH "AL-BAQARAH".....	69
Naser Mekarem Sherazi	
QUR'AN, THE ETERNAL MIRACLE.....	78
Vullnet Merja	
QUR'ANIC GLOSSARY: JINNS (GENIES).....	89
Osman Nuri Topbash	
PROPHET SHU'AYB.....	94
Liseda Ramaj	
BIBLIOGRAPHY OF "THE LIGHT OF QUR'AN"	
Journal, 2014.....	105
QUR'ANIC ACTIVITIES.....	109
SUMMARIES IN ENGLISH.....	113
SUMMARIES IN ARABIC.....	119

المحتويات

١٠.....	خطبة الوداع
	السيد ابو الاعلى مودودي
١٨.....	النبي محمد (ص) الثائر الاعظم
	الحاج/ فولنت مريا
٢٩.....	نبي الرحمة
	عبد الدائم كحيل
٣٦.....	أدلة علمية في القرآن الكريم
	متوش إسكيا
٤٩.....	الدماغ والتربية
	كاني باناي
٥٦.....	لكل داء دواء
	اية الله مصباح يژدي
٦٤.....	أمور الله ليست بزمينة
	محسن قرائتي
٦٩.....	دروس مستنبطة من سورة «البقرة»
	ناصر مكارم شيرازي
٧٨.....	إن القرآن معجزة خالدة
	الحاج/ فولنت مريا
٨٩.....	قاموس قرآني: الجن
	عثمان نوري طوب باش
٩٣.....	النبي شعيب
	ليسدا راماي
١٠٥.....	٢٠١٥ «نور القرآن» في مجلة (بحث فهرسي) في مجلة «نور القرآن»
١٠٩.....	نشاطات علمية و قرآنية
١١٣.....	ملخص باللغة الانجليزية
١١٩.....	ملخص باللغة العربية

HYTBJA E LAMTUMIRËS*¹

“O njerëz, dëgjoni se çfarë do t’ju them, se nuk e di a do t’ju takoj më në këtë vend pas këtij viti! O njerëz, frikësojuni Zotit dhe respektojeni Atë, bëhuni të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj të tjerëve! Kjo është dita e kurbaneve, me emrin e Allahut. Vërtet, gjaku, nderi dhe pasuria janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend. Ruajuni, respektoni dhe nderoni vlerën e personalitetit! Njeriu është vepër madhështore e Allahut. Mjerë ai që e përçmon nderin dhe dinjitetin e veprës së Tij! O njerëz, ju sigurisht do të ktheheni tek Allahu i Madhëruar dhe Ai do t’ju thërrasë të përgjigjeni për veprat dhe punën tuaj. O njerëz, dijeni se ka përfunduar koha e padijes dhe e traditave të këqija, të cilat i kanë sjellë aq fatkeqësi gjinisë njerëzore. Unë ju kam treguar rrugën e shpëtimit, drejt së cilës duhet ecur. Sendet që ju janë dhënë amanet ruajini si të ishin tuajat dhe kthejuani ato besnikërisht dhe me kohë atij që i përkasin. Gjakmarrja është e ndaluar. Të gjitha të këqijat, të cilat rrjedhin nga koha e injorancës, anulohen. Akuza e parë, e cila anulohet, është gjakmarrja e ungjit tim, Ibn Abdul Mutalibit, të cilin, e vranë njerëzit nga fisi Hudhejl. Kjo gjakmarrje le të harrohet dhe të gjitha të tjerat në të ardhmen le të falen! Kamata është e ndaluar. Huadhënësi duhet të marrë nga huamarrësi vetëm atë, që ai ia ka huajtuar. Huatë e para që i nënshtrohen këtij vendimi, janë huatë e ungjit tim Abasit,



¹ * Është Hytbja që profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka mbajtur në Arafat, në Haxhin e Lamtumirës, në vitin 633. (Shih al-Bukharin, hadithet 1623, 1626, 6361. Edhe imam Muslimi e përmend Hytben në hadithin 98. Imam al-Tirmidhiu e përmend këtë Hytbe në hadithet 1628, 2046, 2085. Imam Ahmed bin Hanbeli ka sjellë versionin më të gjatë dhe ndoshta, më të plotin e kësaj Hytbeje në hadithin 19774.)

i cili ka pasur mjaft borxhlinj. O njerëz, ua falni kamatat borxhlinjve! Dëgjojeni këshillën time dhe pasuria juaj do të shtohet, sepse ju mbetët kryegjëja për tregti dhe punë të ndershme. Nëse këtë nuk e bëni, dijeni se e keni zemëruar shumë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Nëse borxhliu juaj është në vështirësi, shtyjani afatin e pagimit; ndërsa, nëse mund t'ia falni borxhin, atëherë kjo është edhe më e mirë për ju. O njerëz! Frikësojuni Ditës, e cila, vërtet do të vijë, kur të gjithë do të paraqiteni para Allahut, Gjykatësit të Vetëm Suprem, Ditën kur ju pret drejtësia absolute! Kur të keni një borxh, paguajejeni në kohë dhe, kur ta bëni marrëveshjen, bëjeni atë me shkrim, saktë dhe theksojeni besnikërisht afatin e pagesës... O ju që do të vdisni! Duajeni dhe dëgjojeni Zotin, Krijuesin e materies dhe asaj që është shpirtërore, i Cili krijoi mashkullin dhe femrën, prej të cilëve u zhvillua e tërë gjinia njerëzore! Frikësojuni Allahut, me ndihmën, prehjen dhe mëshirën e të Cilit të gjithë jemi udhëzuar! Ne jemi të vdekshëm dhe në çdo moment jemi më afër vdekjes dhe takimit me Të, me Allahun e Madhëruar, Gjykatësin e Drejtë. Respektojeni farefisninë. Përbushni besnikërisht detyrat dhe detyrimet ndaj burrit dhe gruas, si dhe ndaj prindërve dhe fëmijëve! Ruhuni nga imoraliteti, tradhëtia bashkëshortore dhe xhelozia. Imoraliteti dhe tradhtia bashkëshortore janë gjynahe të rënda, ndërsa xhelozia sjell përçarje në martesë. Martohuni me ato të cilat i doni, e kur Zoti, me vullnetin e Vet do t'ju bashkojë, atëherë respektojeni dhe duajeni njëri-tjetrin dhe jetoni në dashuri e harmoni! O bashkëshortë, silluni ndaj grave tuaja me shumë mirësi dhe dashuri! O njerëz, iu largoni ngatërresave dhe përgojimit! Le të jenë të mallkuar në të dyja botët ata që u bëjnë shpifje grave të ndershme! Ata që i akuzojnë gratë e ndershme për tradhti në martesë ose për imoralitet, e për këtë nuk mund të sjellin katër dëshmitarë të besueshëm, dënojeni me tetëdhjetë goditje (shkopinj) dhe mos u besoni më asnjëherë, sepse janë të ulët dhe të këqinj! Nëse e ndjeni se ndaj grave tuaja ju është dobësuar dashuria, mos nxitoni (në shkurorëzim) por mendohuni mirë, sepse nëpërmjet këtij sprovimi, Allahu ju udhëzon në rrugët e së ardhmes



së re dhe të madhe me të cilën dëshiron t'ju përgëzojë. Mos kërmoni shkurorezim pa shkaqe të arsyeshme, sepse prej të gjitha gjërave që ka ndaluar Allahu është shkurorezimi. Gratë tuaja janë dorëzuar në besë të Zotit; pra respektojeni këtë amanet të Zotit! O njerëz, sot, djalli i mallkuar është i dëshpëruar, sepse ka pësuar humbje dhe nuk mundet të ndikojë te ju. Megjithatë, gjithnjë bëhuni të kujdesshëm, që ai i mallkuari të mos ju largojë as në gjërat më të vogla! O njerëz, kur e caktoni dhe e ndani ndërmjet vetes trashëgiminë, bëhuni të drejtë dhe përmbajuni Librit të Zotit (Kur'anit)! Ruajeni pasurinë e të miturve, të të paaftëve dhe të të marrëve. Zoti ia ka dhënë gjithkujt të drejtën e vet; prandaj është e nevojshme t'u lihen trashëgimtarëve testament. Si testament mund të lihet një e treta e pasurisë. Fëmija i takon atij, në shtratin e të cilit është lindur. Kush pohon se i takon tjetërkujt përveç prindit, atë do ta zërë mallkimi i Allahut. Nuk i lejohet gruas të japë nga pasuria e burrit të vet pa lejen e tij. Borxhi duhet paguar, ndërsa sendi i huajtuar duhet kthyer. Dhurata duhet kthyer me dhuratë. Kush hyn dorëzanë për dikë, detyrohet me përgjegjësi për dorëzani. Me robërit dhe shërbëtorët silluni njerëzisht! Ushqejini ata sikurse ushqeheni vetë, dhe vishini ata sikurse visheni vetë. Mos guxoni t'u bëni keq e t'i keqtrajtoni. Edhe ata janë njerëz, edhe ata janë shërbëtorë të Zotit. O njerëz, dijeni dhe mos harroni se të gjithë myslimanët janë vëllezër. Ju jeni plotësisht të barabartë në të drejta dhe në detyra. Arabi ndaj joarabit nuk ka kurrfarë përparësie e kjo vlen edhe për të ziun ndaj të bardhit, përveçse në devotshmëri. Të gjithë ju jeni pasardhësit e Ademit e Ademi është krijuar nga dheu. O njerëz, kujdesuni për njëri-tjetrin, duajeni dhe ndihmojeni njëri-tjetrin! Mos guxoni ta fyeri apo ta grabitni njëri-tjetrin. Këto janë gjynahe të rënda. Merrni vetëm atë që ju jepet me dëshirë! Respektojeni pacënueshmërinë e pasurive tuaja, derisa të jeni në frymën e Ligjeve të Zotit. Islami dhe interesi i përgjithshëm le të jetë mbi ju dhe mbi interesin tuaj! Përkushtojani Islamit jetën tuaj dhe në punën për Islamin jepni prej vetes gjithçka që mundëni! Kurrë mos e shkelni të drejtën dhe nderin e tjetrit! Mos i bëni dhunë



vetes! Mos harroni se mëshira është një ndër themelet e Islamit! O njerëz, dëgjoni se ç'po ju them dhe mbajeni mend mirë! Po ju lë Librin e Zotit, Kur'anin, të cilit nëse i përmbaheni, gjithnjë do t'ju ruajë që të mos e humbni rrugën e drejtësisë dhe të së vërtetës. Kur'ani është libër i qartë dhe i shenjtë, vepër e vërtetë e Allahut dhe fjala e Tij, në vërtetësinë e të cilit nuk ka asnjë dyshim. Para vetes e keni tërë jetën time, të gjitha fjalët dhe veprat e mia, gjithçka që kam folur dhe punuar. Jam përpjekur të jenë në përputhje të plotë me urdhrat e Allahut. Vërtet nuk do të gaboni, nëse i përmbaheni Kur'anit (Librit të Zotit) dhe synetit (traditës sime). O njerëz, pas meje nuk do të vijë më i Dërguar tjetër nga Zoti dhe pas jush populli nuk do të ketë më Pejgamber! Pra, bëni ibadet dhe adhuroni Zotin; agjëroni muajin e Ramazanit; jepni zekatin me zemër të plotë dhe të kënaqur dhe kryejeni haxhin. Kështu, do të hyni në Xhenetin e Zotit të Madhëruar! O njerëz, thoni gjithnjë të vërtetën e pastër! Asnjëherë të mos ju largojë urrejtja nga rruga e drejtë. Drejtësia është motra e devotshmërisë. Frikësojuni Allahut se Ai i sheh mirë veprimet tuaja! O njerëz, e dëgjuat porosinë time. Atëherë, futeni atë në zemrën tuaj dhe në jetën tuaj! Të gjithë ata që i dëgjuan fjalët e mia, le t'ua përcjellin atyre që nuk i kanë dëgjuar se ndodh që ata i kuptojnë më mirë.

“O Zoti im, a e përmbusha detyrën dhe misionin e besuar?” Mbi njëqind mijë haxhinj folën njëzëri: O i Dërguari i Zotit, ti e përmbushë misionin tënd besnikërisht dhe na e komunikove atë që të urdhëroi Zoti... Atëherë, Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: “O Zot, dëshmo! O Zot, dëshmo! O Zot, dëshmo!” Atë ditë iu shpall ajeti nga Zoti i Lartësuar: **«Sot kam përsosur fenë tuaj, plotësova dhuntinë time për ju dhe jam i kënaqur që Islami të jetë feja juaj.»** (Sure El Maide, ajeti 3)



FAREWELL KHUTBAH

Prophet Muhammad (SAWS) delivered his last Khutbah (sermon) on the ninth of Dhul Hijjah (12th and last month of the Islamic year), 10 years after Hijrah (migration from Makkah to Madinah) in the Uranah Valley of mount Arafat. His words were quite clear and concise and were directed to the entire humanity. After praising, and thanking Allah he said: **«O People, lend me an attentive ear, for I know not whether after this year, I shall ever be amongst you again. Therefore listen to what I am saying to you very carefully and TAKE THESE WORDS TO THOSE WHO COULD NOT BE PRESENT HERE TODAY.**

O People, just as you regard this month, this day, this city as Sacred, so regard the life and property of every Muslim as a sacred trust. Return the goods entrusted to you to their rightful owners. Hurt no one so that no one may hurt you. Remember that you will indeed meet your LORD, and that HE will indeed reckon your deeds. ALLAH has forbidden you to take usury (interest), therefore all interest obligation shall henceforth be waived. Your capital, however, is yours to keep. You will neither inflict nor suffer any inequity. Allah has Judged that there shall be no interest and that all the interest due to Abbas ibn ‘Abd’al Muttalib (Prophet’s uncle) shall henceforth be waived... Beware of Satan, for the safety of your religion. He has lost all hope that he will ever be able to lead you astray in big things, so beware of following him in small things. O People, it is true that you have certain rights with regard to your women, but they also have rights over you. Remember that you have taken them as your wives only under Allah’s trust and with His permission. If they abide by your right then to them belongs the right to be fed and clothed in kindness. Do treat your women well and be kind to them for



they are your partners and committed helpers. And it is your right that they do not make friends with any one of whom you do not approve, as well as never to be unchaste. O People, listen to me in earnest, worship ALLAH, say your five daily prayers (Salah), fast during the month of Ramadan, and give your wealth in Zakat. Perform Hajj if you can afford to. All mankind is from Adam and Eve, an Arab has no superiority over a non-Arab nor a non-Arab has any superiority over an Arab; also a white has no superiority over black nor a black has any superiority over white except by piety and good action. Learn that every Muslim is a brother to every Muslim and that the Muslims constitute one brotherhood. Nothing shall be legitimate to a Muslim

which belongs to a fellow Muslim unless it was given freely and willingly. Do not, therefore, do injustice to yourselves. Remember, one day you will appear before ALLAH and answer your deeds. So beware, do not stray from the path of righteousness after I am gone. O People, **NO PROPHET OR APOSTLE WILL COME AFTER ME AND NO NEW FAITH WILL BE BORN.** Reason well, therefore, O People, and understand words which I convey to you. I leave behind me two things, the QURAN and my example, the SUNNAH and if you follow these you will never go astray. All those who listen to me shall pass on my words to others and those to others again; and may the last ones understand my words better than those who listen to me directly. Be my witness, O ALLAH, that I have conveyed your message to your people».



خطبة الوداع

ألقاها الرسول صلى الله عليه وسلم في حجة الوداع يوم عرفة من جبل عرفة الحمد لله نحمده ونستعينه ونستغفره ونتوب إليه، ونعوذ بالله من شرور أنفسنا ومن سيئات أعمالنا من يهده الله فلا مضل له ومن يضلل فلا هادي له، وأشهد أن لا إله إلا الله وحده لا شريك له وأشهد أن محمداً عبده ورسوله. أوصيكم عباد الله بتقوى الله وأحثكم على طاعته وأستفتح بالذي هو خير. أما بعد أيها الناس اسمعوا مني أبين لكم فإني لا أدري لعلى لا ألقاكم بعد عامي هذا في موقفي هذا.

أيها الناس إن دماءكم وأعراضكم حرام عليكم إلى أن تلقوا ربكم كحرمة يومكم هذا في شهركم هذا في بلدكم هذا - ألا هل بلغت اللهم فاشهد، فمن كانت عنده أمانة فليؤدها إلى من ائتمنه عليها.

وإن ربا الجاهلية موضوع ولكن لكم رؤوس أموالكم لا تظلمون ولا تظلمون وقضى الله أنه لا ربا. وإن أول ربا أبداً به عمى العباس بن عبد المطلب.

وإن دماء الجاهلية موضوعة، وإن أول دم نبدأ به دم عامر بن ربيعة بن الحارث بن عبد المطلب وإن مآثر الجاهلية موضوعة غير السدانة والسقاية والعمد قود وشبه العمد ما قتل بالعصا والحجر وفيه مائة بعير، فمن زاد فهو من أهل الجاهلية - ألا هل بلغت اللهم فاشهد.

أما بعد أيها الناس إن الشيطان قد يئس أن يعبد في أرضكم هذه، ولكنه قد رضى أن يطاع فيما سوى ذلك مما تحرقون من أعمالكم فاحذروه على دينكم، أيها الناس إنما النسيء زيادة في الكفر يضل به الذين كفروا يحلونه عاماً ويحرمونه عاماً ليوطئوا عدة ما حرم الله فيحلوا ما حرم الله ويحرموا ما أحل الله. وإن الزمان قد استدار كهيئته يوم خلق الله السماوات والأرض، وإن عدة الشهور عند الله اثنا عشر شهراً في كتاب الله يوم خلق الله السماوات والأرض، منها أربعة حرم ثلاثة متواليات وواحد فرد: ذو القعدة وذو الحجة والمحرم ورجب مضر الذي بين جمادى وشعبان - ألا هل بلغت اللهم فاشهد.

أما بعد أيها الناس إن لنسائكم عليكم حقاً ولكم عليهن حق. لكم أن لا يواطئن فرشهم غيركم، ولا يدخلن أحداً تکرهونه بيوتكم إلا بإذنكم ولا



يأتين بفاحشة، فإن فعلن فإن الله قد أذن لكم أن تعضلوهن وتهجروهن في المضاجع وتضربوهن ضرباً غير مبرح، فإن انتهين وأطعنكم فعليكم رزقهن وكسوتهن بالمعروف، واستوصوا بالنساء خيراً، فإنهن عندكم عوان لا يملكن لأنفسهن شيئاً، وإنكم إنما أخذتموهن بأمانة الله واستحللتم فروجهن بكلمة الله فاتقوا الله في النساء واستوصوا بهن خيراً - ألا هل بلغت.... اللهم فاشهد. أيها الناس إنما المؤمنون إخوة ولا يحل لامرئ مال لأخيه إلا عن طيب نفس منه - ألا هل بلغت اللهم فاشهد. فلا ترجعن بعدى كافراً يضرب بعضكم رقاب بعض، فإنني قد تركت فيكم ما إن أخذتم به لن تضلوا بعده: كتاب الله وسنة نبيه، ألا هل بلغت ... اللهم فاشهد.

أيها الناس إن ربكم واحد وإن أباكم واحد كلكم لآدم وآدم من تراب أكرمكم عند الله اتقاكم، وليس لعربي على عجمي فضل إلا بالتقوى - ألا هل بلغت.... اللهم فاشهد قالوا نعم - قال فليبلغ الشاهد الغائب. أيها الناس إن الله قد قسم لكل وارث نصيبه من الميراث ولا يجوز لوarith وصية، ولا يجوز وصية في أكثر من ثلث، والولد للفراش وللعاهر الحجر. من ادعى إلى غير أبيه أو تولى غير مواليه فعليه لعنة الله والملائكة والناس أجمعين لا يقبل منه صرف ولا عدل. والسلام عليكم.



PROFETËSIA E MUHAMEDIT

(Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

REVOLUCIONARI MË I MADH

Abstrakt

Në vargun e gjatë të historisë botërore, figura sublime e këtij njeriu të mrekullueshëm ngrihet lart mbi të gjithë njerëzit e mëdhenj të të gjitha kohëve. Ai mendon dhe mediton thellë. Ai kërkon dritën, që zhdruk errësirën gjithëpërfshirëse. Ai kërkon të kapet pas asaj Fuqie, e cila sjell shkatërrimin e botës së kalbur dhe të çorientuar dhe vë themelet e një bote të re më të mirë. Dhe ja, një revolucion i shkëlqyer ndodh në qenien e tij. Krejt papritur, zemra e tij ndriçohet nga Drita e Zotit dhe i jep forcën që e kishte dëshiruar aq shumë. Ai del nga shpella Hira, shkon te njerëzit dhe u drejtohet atyre kështu: "Tdhujt, që adhuroni ju, janë absurditet. Mos i adhuroni më tani e tutje! Asnjë qenie e vdekshme, asnjë yll, asnjë dru, asnjë gur, asnjë shpirt nuk meriton të adhurohet nga njeriu. Prandaj, mos e ulni kryet para tyre! I tërë universi, me gjithçka përmban ai, i përket vetëm Zotit të Gjithëfuqishëm...."

Drita e Kur'anit - Nr. 1 - 2015



Në vargun e gjatë të historisë botërore, figura sublime e këtij njeriu të mrekullueshëm ngrihet aq lart mbi të gjithë njerëzit e mëdhenj të të gjitha kohëve, të cilët shquhen e përmenden si heronj

* E përktheu nga gjuha angleze H. Shehu.

të popujve, sa duken si xhuxhë, kur krahasohen me të. Asnjëri prej tyre nuk pati dhunti për të lënë ndonjë përshtypje të thellë për një apo për dy aspekte të jetës njerëzore. Disa janë eksponentë teorish dhe idesh, por u mungon veprimi praktik. Disa të tjerë janë njerëz të veprimit, por kanë dije të pakta. Disa janë të njohur vetëm si burra shteti; të tjerë janë mjeshtër strategjish dhe manovrash. Disa janë përqendruar në një aspekt të jetës shoqërore, në atë mënyrë, sa aspektet e tjera i kanë lënë mënjanë. Disa të tjerë ua kanë kushtuar energjitë e tyre vlerave etike dhe shpirtërore, por kanë shpërfillur ekonominë dhe politikën. Disa janë marrë me ekonomi dhe politikë, por kanë shpërfillur moralin dhe anën shpirtërore të jetës. Me fjalë të tjera, shohim heronj, që janë të aftë dhe ekspertë vetëm në një fushë të jetës. Kurse profeti Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) është i vetmi shembull, ku janë bashkuar në një personalitet të gjitha shkëlqimet. Ai është filozof e vëzhgues dhe një mishërim i gjallë i mësimëve të tij. Ai është një burrë shteti i madh dhe po aq, një gjeni ushtarak. Ai është ligjvënës, por edhe mësues i moralit. Ai është yll ndriçues shpirtëror dhe udhëheqës fetar. Vizioni i tij depërton në çdo aspekt të jetës dhe nuk ka gjë që ta prekë ai e të mos e zbukurojë. Urdhrat dhe urdhëresat e tij mbulojnë një fushë të gjerë, që nga rregullimi i marrëdhënieve ndërkombëtare e deri te sjellja në jetën e përditshme, si ngrënia, pirja dhe pastërtia e trupit. Duke u mbështetur në teoritë e tij, ai themeloi një qytetërim e kulturë dhe solli një ekuilibër të tillë të shkëlqyer në pikëpamje të konflikteve jetësore, sa nuk mund të gjendet as edhe gjurma më e vogël e ndonjë të mete ose paplotësie. A mundet, atëherë dikush të na tregojë ndonjë shembull tjetër personaliteti kaq të përkryer dhe të gjithanshëm?

Thuhet se shumica e personaliteteve të famshëm të botës janë produkt i mjedisit të tyre. Kurse rasti i profetit Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) është unik, i pashoq. Mjediisi i tij duket se nuk ka luajtur asnjë rol në formimin e personalitetit të tij. Nuk mund të provohet, gjithashtu se historikisht,



lindja e tij mund të sinkronizohet me rregullin e gjërave në Arabinë e atëherëshme. Ajo që mund të thuhet, më së shumti është se rrethanat në Arabi kërkonin fort daljen e një njeriu të tillë, i cili do të mund t'i bashkonte fiset armiqësore në një komb dhe të vinte themelet e solidaritetit të tyre ekonomik dhe të mirëqenies së tyre, duke sjellë edhe vende të tjera nën pushtetin e tyre - thënë shkurt, daljen e një udhëheqësi kombëtar, që do të kishte të gjitha tiparet e një arabi të asaj kohe dhe me mizori, shtypje, gjakderdhje, mashttrim dhe hipokrizi, ose me ndonjë mjet tjetër - të mirë ose të keq, të mund ta pasuronte popullin e vet dhe të linte një mbretëri si trashëgimni për pasardhësit e tij. Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk është modeli i këtij udhëheqësi.

Ajo që mund të thuhet, më së shumti në dritën e filozofisë së historisë së Hegelit ose të materializmit historik të Marksit është se koha dhe mjedisi kërkonin daljen e një udhëheqësi, i cili do të mund të krijonte një komb dhe të ndërtonte një perandori. Por filozofia hegeliane dhe ajo marksiste nuk mund ta shpjegojnë se si një mjedis i tillë mund të nxirrte një njeri, misioni i të cilit ishte tu mësonte të tjerëve moralet më të mira, ta pastronte njerëzimin nga e tërë zgjyra dhe të fshinte paragjykimet dhe supersticionet e kohës së injorancës dhe të errësirës, që të shihte tej ndarjes së madhe - racë, komb, vend, që të vinte themelet e superstrukturës morale, shpirtërore, kulturore dhe politike për të mirën e botës dhe jo vetëm për vendin e tij, që praktikisht dhe jo teorikisht, t'i vinte marrëdhëniet tregtare, të drejtën civile, politikën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare mbi bazën morale dhe të krijonte një sintezë të tillë të ekuilibruar dhe të matur midis jetës së kësaj bote dhe përparimit shpirtëror, që edhe sot konsiderohet një kryevepër e urtësisë dhe e parashikimit po aq të saktë, siç konsiderohej në kohën e tij. A mundet, atëherë ndershmërisht ta quajë dikush një njeri të tillë produkt të errësirës gjithëpërfshirëse të Arabisë?

Ai nuk është vetëm i pavarur nga mjedisi i tij. Është më shumë se kaq. Kur shohim arritjet e tij, në mënyrë të pakundërshtueshme



shkojmë te përfundimi se ai, vërtet i tejkalon të gjitha kufizimet e kohës dhe të vendit. Vizioni i tij i çan të gjitha barrierat kohore dhe fizike, kalon përtej shekujve dhe mijëvjeçarëve dhe përfshin brenda vetvetes tërë veprimtarinë njerëzore dhe tërë historinë njerëzore.

Ai nuk është nga ata, të cilët historia i ka hedhur në harresë dhe nuk lavdërohet vetëm sepse ishte udhëheqës i mirë në kohën e tij. Ai është udhëheqësi i pashoq dhe i pakrahasueshëm i njerëzimit, që marshon bashkë me kohën, që është modern në çdo shekull dhe në çdo epokë, po aq sa ishte në shekullin e tij të historisë. Vërtet, mësimet e tij janë po aq moderne sa edhe mëngjesi i nesërm.

Ata, që njerëzit i etiketojnë si “bërësit e historisë”, janë vetëm “krijesa të historisë”. Në tërë historinë e njerëzimit, ai është, vërtet shembulli i pashoq i bërësit të historisë. Njeriu mund të këqyrë jetën dhe rrethanat e udhëheqësve të mëdhenj të botës, që sollën revolucione dhe do të shohë se në çdo rast të tillë, forcat e revolucionit ngriheshin për përmbysjen e caktuar, merrnin kursin e tyre në drejtime të caktuara dhe prisnin vetëm momentin e favorshëm për të shpërthyer. Në përgatitjen e këtyre forcave në kohë për veprim, udhëheqësi revolucionar luante pjesën e një aktori, për të cilin skena dhe roli ishin përcaktuar që më parë. Kurse profeti Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ndër të gjithë bërësit e historisë dhe të figurave revolucionare të të gjitha kohëve, është i vetmi person, që duhej të gjente rrugët dhe mjetet për t’i bashkuar forcat e revolucionit, që duhej të brumoste dhe të prodhonte llojin e njerëzve që i duheshin për qëllimin e tij, sepse vetë shpirti i revolucionit dhe nevojat e domosdoshme për këtë revolucion nuk ekzistonin te njerëzit, midis të cilëve ai pati fatin të jetonte.

Me personalitetin e tij të fuqishëm, ai la përshtypje të pashlyeshme në zemrat e mijëra dishepujve të tij dhe i brumosi ata me simpatinë e tij. Me vullnetin e tij të hekurt, ai përgatiti truallin për revolucion, mbraujti formën dhe tiparet e tij dhe i çoi rrjedhat e ngjarjeve në drejtimin që dëshoi dhe dëshiroi ai. A mund të citohet



ndonjë shembull tjetër i një bërësi të historisë me tipare të tilla? A mund të citohet ndonjë shembull tjetër i një revolucionari tjetër me këtë shkëlqim dhe me këtë madhështi?

Diamant në një grumbull gurësh

Tani mund t'i hedhim një vështrim jetës dhe punës së këtij njeriu fisnik, jo vetëm brenda kontekstit të shoqërisë arabe, por edhe të të gjithë botës së atëhershme.

Ai është krejt i ndryshëm nga njerëzit, ku është lindur dhe me të cilët ai kalon rininë e tij dhe burrërinë e tij të hershme e të mëvonshme. Ai nuk thotë asnjëherë asnjë fjalë të pavërtetë. I tërë kombi i tij vërtetëson drejtësinë e tij. Madje, edhe armiqtë e tij më të egër kurrë nuk e akuzojnë se thotë ndonjë gënjeshtër gjatë gjithë jetës së tij. Ai bisedon me mirësjellje me të tjerët dhe kurrë nuk përdor gjuhë të pakëndshme dhe fyese. Ai ka një personalitet magjepsës e një sjellje të përkryer dhe pushton kështu zemrat e atyre që janë në kontakt me të. Në marrëdhëniet e tij me njerëzit, ai ndjek gjithmonë parimet e drejtësisë dhe të mirësjelljes. Ai merret për vite të tëra me tregti, por asnjëherë nuk bën tregti të pandershme. Ata që kanë të bëjnë me të, kanë besim të plotë në integritetin e tij. I tërë kombi e quan atë *el-Emiin* (i Drejti dhe i Besuari). Edhe armiqtë e tij ia lënë sendet e kushtueshme për t'ua ruajtur dhe ai e përligj besimin e tyre në mënyrë skrupuloze. Ai është mishërimi i modestisë në mesin e asaj shoqërie, që është jomodeste deri në palcë. I lindur dhe i rritur midis një populli, që i quante pijen dhe bixhozin gjë e mirë, ai kurrë nuk e preku alkoolin dhe kurrë nuk u mor me bixhoz. Njerëzit ku jetonte ai ishin të pagdhendur, të pakulturë dhe të papastër, kurse ai mishëron me vetvete kulturën më të lartë dhe botëkuptimin më të hollë estetik. I rrethuar nga të gjitha anët me njerëz të pazemër, ai vetë ka një zemër të mbushur plot e përplot me dhembshuri njerëzore. Ai ndihmon jetimët dhe vejushat. Ai mirëpret udhëtarët. Ai nuk i bën dëm askujt; përkundrazi, ai shkon gjithandej për të



marrë mbi vete vështirësi për hir të të tjerëve. Duke jetuar midis atyre, për të cilët lufta është bukë e gjalpë, ai e do aq shumë paqen, sa i plas zemra për ta, kur ata rrokin armët dhe i presin kokën njërit-tjetrit. Ai nuk përziehet në armiqësitë e gjakësitë e fisit të tij dhe është i pari që përpiqet për t'i pajtuar. I rritur në një racë idhujtare, ai është kaq mendjehapur dhe ka një shpirt të tillë të pastër, që e bën atë të mos adhurojë asgjë në qiej dhe në Tokë, përveç Një Zotit të Vërtetë. Edhe në fëmijëri, ai nuk përkulet përpara asgjëje të krijuar dhe nuk shijon asnjë lloj oferte, që i bëhet për idhujt. Ai i urren të gjitha llojet e adhurimit të të gjitha krijesave dhe të qenieve, përveç Zotit. Shkurt, personaliteti i lartë e shkëlqimtar i *këtij njeriu* në një mjedis kaq të errët është si një pishtar që ndriçon në një natë të zezë sterrë, ose si një diamant që shkëlqen në një grumbull gurësh.

Dhe revolucioni vjen

Pasi kalon një pjesë të madhe të jetës së tij me një sjellje kaq të ndershme, të pastër dhe të qytetëruar, në qenien e tij vjen revolucioni. Ai e ndien veten të ngopur me errësirën dhe injorancën përreth. Ai dëshiron të notojë në një det të qetë, pa injorancën, kalbësinë, imoralitetin, idhujtarinë dhe çrregullimin, që e rrethojnë në të gjitha anët. Ai shikon se asgjë përreth nuk është në harmoni me shpirtin e tij. Ai veçohet tej në kodra, larg zhurmave dhe gumëzhimave ku banonte. Ai kalon ditë dhe net në veçim të plotë dhe në meditim. Ai agjëron, në mënyrë që shpirti i tij dhe zemra e tij të pastrohen dhe të fisnikërohen edhe më shumë.

Ai mendon dhe mediton thellë. Ai kërkon dritën, që mund ta zhdukë errësirën gjithëpërfshirëse. Ai kërkon të kapet pas asaj Fuqie, me të cilën të mund të sjellë shkatërrimin e botës së kalbur dhe të çorientuar dhe të vërë themelet e një bote të re më të mirë.

Dhe ja, një revolucion i shkëlqyer ndodh në qenien e tij. Krejt papritur, zemra e tij ndriçohet nga Drita e Zotit dhe i jep



forcën që e kishte dëshiruar aq shumë. Ai del nga shpella Hira, shkon te njerëzit dhe u drejtohet atyre kështu: *"Idhujt, që adhuroni ju, janë absurditet. Mos i adhuroni më tani e tutje! Asnjë qenie e vdekshme, asnjë yll, asnjë dru, asnjë gur, asnjë shpirt nuk meriton të adhurohet nga njeriu. Prandaj, mos e ulni kryet para tyre! I tërë universi, me gjithçka përmban ai, i përket vetëm Zotit të Gjithëfuqishëm. Vetëm Ai është Krijuesi, Ushqyesi, Mbajtësi dhe prandaj vetëm Ai është Sovrani i vërtetë, përpara të Cilit të gjithë duhet të përkulen dhe të Cilit të gjithë duhet t'i falen dhe t'i binden. Atëherë, adhuroni vetëm Atë dhe bindjuni vetëm urdhrave të Tij! Preja dhe plaçkitja, vrasjet dhe grabitjet, padrejtësia dhe mizoria - të gjitha këto të këqija, ku ju jeni zhytur, janë krime në sy të Zotit. Largohuni nga këto rrugë të këqija! Zoti i urren të gjitha këto. Flisni të vërtetën! Jini të drejtë! Mos vrisni askënd! Mos grabisni askënd! Merrni atë që ju takon! U jepni të tjerëve atë që u takon, ashtu siç duhet! Ju jeni njerëz dhe të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara Zotit. Askush nuk ka lindur me njollën e turpit në ballë dhe askush nuk ka ardhur në këtë botë me qaforen e nderit përreth qafës. I lartë dhe i nderuar është vetëm ai që e ka frikë Zotin dhe është i përkushtuar e i drejtë në fjalë dhe në vepra. Dallimet për nga dera e lindjes dhe lavdia e racës nuk janë kritere të vlerësimit dhe të nderit. Ai që e ka frikë Zotin dhe bën vepra të mira është njeriu më fisnik. Ai që e ka humbur dashurinë për Zotin dhe është zhytur në sjellje të keqe, është i ndëshkuar. Ka një Ditë të caktuar pasi të vdisni, kur ju do të dilni para Zotit tuaj. Ju do të thërriteni për të dhënë llogari për të gjitha veprat tuaja - të mira ose të këqija dhe nuk do të mund të fshibni asgjë. E tërë jeta juaj e shkuar do të jetë një libër i hapur te Zoti. E ardhmja juaj do të përcaktohet nga veprimet dhe veprat tuaja të mira ose të këqija. Në gjykatoren e Gjykatës të Vërtetë - Zotit të Gjithëditur - nuk ka ndërmjetësime dhe anësi. Ju nuk do të mund të jepni mitë atë Ditë. Asnjë lloj dallimi nuk do të ketë për nga prejardhja që keni. Atë Ditë, vetëm besimi i vërtetë dhe veprat e mira do të qëndrojnë para jush. Ai që është i pajisur me të gjitha këto, do të hyjë në Xhenetin e lumturisë së përjetshme; ai që nuk i ka këto, do të hidhet në zjarrin e Xhehenemit."*

Ky është mesazhi, me të cilin ai vjen. Kombi injorant i kthehet kundër. Fyerjet dhe gurët hidhen mbi personin e tij madhështor. Mbi të bëhen të gjitha torturat dhe mizoritë, që mund të përfytyrojë



mendja e njeriut - dhe kjo vazhdon jo për një ditë apo për dy, por për trembëdhjetë vjet pa ndërprerje. Më në fund, ai mërgon; por as atje nuk gjen qetësi. Ai torturohet në mënyra të ndryshme në mërgim. E tërë Arabia ndërsehet kundër tij. Ai përndiqet dhe ndiqet atje për plot tetë vjet radhas. Ai i heq të gjitha këto vuajtje, por nuk lëviz as edhe një centimetër nga qëndrimi që kishte marrë. Ai është i vendosur, i patundur dhe i paepshëm në qëllimin e tij dhe në qëndrimin e tij.

Fjala e tij është gjithëpërfshirëse

Tashmë ai doli përpara popullit të tij si një filozof i paparë, reformator i mrekullueshëm, mbrojtës i shquar i kulturës dhe i qytetërimit, politikan i shkëlqyer, udhëheqës i madh, gjykatës i shkallës më të lartë dhe gjeneral i pashoq. Ky beduin i pashkollë, ky banor i shkretëtirës foli me një dije dhe urtësi të tillë, me të cilat askush më parë nuk kishte folur dhe me të cilat askush më pas nuk do të mund të fliste. Ai shpjegoi problemet e ndërlikuara të metafizikës dhe të teologjisë. Ai mbajti fjalime për parimet e shuarjes së kombeve dhe të rënies së perandorive, duke i mbështetur tezat e tij me të dhëna historike të së kaluarës. Ai shqyrtoi arritjet e reformatorëve të mëparshëm, dha gjykime për fetë e ndryshme të botës dhe për dallimet e kundërshtitë midis kombeve. Ai u mësoi të tjerëve normat etike dhe parimet e kulturës. Ai formuloi të tilla ligje të kulturës shoqërore, të organizimit ekonomik, të sjelljes në grup dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, sa edhe mendimtarët dhe dijetarët e shquar mund ta rrokin urtësinë e tyre të vërtetë vetëm pas kërkimesh të gjata shkencore dhe përvoja të madhe për njerëzit dhe për gjërat. Bukuritë e tyre shpalosen, vërtet gjithnjë e më shumë, ndërkohë që njeriu përparon në dijen teorike dhe në përvojën praktike.

Ky tregtar i heshtur dhe paqedashës, që nuk pati mbajtur kurrë shpatë më parë, që nuk pati përgatitje ushtarake, që pati marrë



pjesë vetëm një herë në një betejë dhe, thjesht si spektator, u kthye papritur në një ushtar kaq trim, sa edhe në betejat më të ashpra ai nuk u tërhoq kurrë. Ai u bë një gjeneral i tillë i madh, sa fitoi tërë Arabinë brenda nëntë vjetëve, në një kohë kur armët e luftës ishin primitive dhe mjetet e komunikimit më të dobëtat. Mendjemprehtësia e tij luftarake, fryma e lartë që ai mbrujti dhe stërvitja ushtarake që i bëri turmës së arabëve bënë një mrekulli të tillë, sa brenda pak vitesh ata përmbysën dy fuqitë më të egra ushtarake të kohës dhe u bënë zotër të pjesës më të madhe të botës së atëhershme.

Ky njeri i rezervuar dhe i qetë, që për plot dyzet vjet nuk dha asnjëherë asnjë shenjë se kishte interesa politike ose veprimtari politike, papritur u shfaq në skenën e botës si një reformator i tillë i madh politik dhe si një shtetar i tillë i madh, sa, pa radio, pa telegraf dhe pa shtyp, ai i bashkoi banorët e shpërndarë të shkretëtirës prej një milion e dyqind mijë km² – njerëz që ishin luftëdashës, injorantë, kryeneçë, të pakulturë dhe të molepsur në luftë vëllavrasëse fisnore - nën një flamur, nën një ligj, nën një fe, nën një kulturë, nën një qytetërim dhe nën një formë qeverisjeje.²

Ai ndriçoi mënyrën e tyre të menduarit, vetë zakonet e tyre dhe vetë moralin e tyre. Ai e ktheu njeriun e pagdhendur në një njeri të kulturuar, barbarin në një njeri të qytetëruar, njeriun e keq në një njeri të përkushtuar, që e ka frikë Zotin dhe që është i drejtë. Karakteret e pagdhendura dhe kryeneçe u transformuan në modele të bindjes dhe të nënshtrimit para ligjit dhe rregullit. Një komb që nuk kishte nxjerrë as edhe një njeri të madh për shekuj me radhë,

² William Muir, një kritik i ashpër i Islamit, pranon në librin e tij, *Life of Mohammad: "Veçantia e parë, që na tërbeq vëmendjen është ndarja e arabëve në grupe të panumërta..., secili i pavarur nga të tjerët: konfliktualë dhe shpesh në luftë me njëri-tjetrin; madje, edhe kur i bashkonte gjaku ose interesi, ata ishin të gatsbëm që për një shkak fare të parëndësishëm të veçoheshin dhe të shpërthenin në një armiqësi të papajtueshme. Kështu, në epokën e Islamit, retrospektiva e historisë arabike paraqet si në një kaleidoskop një gjendje që ndryshon vazhdimisht - me bashkim dhe me përplasje, dhe çdo përpjekje për bashkim të përgjithshëm pati rezultuar dështake... Megjithatë, problemi duhet zgjidhur. Me çfarë force mund të nënshtroheshin ose të tërhiqeshin në një qendër të përbashkët këto fise? Ky problem U ZGJIDH NGA MUHAMEDI." (Nënvizimet janë tonat - S.A.A. Maududi)*



nxori, në ndikimin dhe udhëheqësinë e tij, mijëra shpirtra fisnikë, të cilët shkuan në skajet më të largëta të botës për t'u mësuar njerëzve parimet e fesë, të moralit dhe të qytetërimit.³

Ai e kreu këtë vepër jo nëpërmjet ndonjë joshe botësore, as me shtypje dhe mizori, por me sjelljen e tij magjepsëse, me personalitetin e tij moral, që pushtonte zemrat e njerëzve dhe me mësimet e tij bindëse. Me sjelljen e tij fisnike dhe të dhembshur, ai bëri miq edhe armiqtë e tij. Me simpatinë e tij të pakufi dhe me nektarin e tij të mirësisë njerëzore, ai rroku zemrat e njerëzve. Ai udhëhoqi me drejtësi. Ai nuk u lëkund nga e vërteta dhe drejtësia. Ai nuk i shtypi as armiqtë e tij më të egër, që u përpoqën ta vrisnin, që e patën gjuajtur me gurë, që e patën detyruar të largohej nga vendlindja, që patën ngritur tërë Arabinë kundër tij - jo, madje as ata që ia patën ngrënë të gjallë mëlçinë xhaxhait të tij, tashmë të vdekur, në tërbimin e tyre për hakmarrje.⁴ Ai i fali të gjithë kur triumfoi mbi ta. Ai kurrë nuk u hakmor për askënd për shkaqe të tij vetjake ose

³ Do të ishte mësimdhënëse të përmendnim këtu një fjalë të rëndësishme të Xha'far Ibën Ebu Talibit. Kur shtypja mbi myslimanët e Mekës mbërriti kulmin, profeti Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) u tha disave prej tyre të mërgonin në shtetin fqinj të Abisinisë. Dhe një grup myslimanësh mërguan në atë vend. Por kurejshët, të cilët po i shtypnin mizorisht myslimanët, nuk qëndruan duarkryq. Ata i ndoqën mërgimtarët dhe i kërkuan mbretit Negus të Abisinisë që t'i kthente me forcë mërgimtarët. Në oborrin e mbretit Negus, Xha'far Ibën Ebu Talibi mbajti një fjalë dhe hodhi dritë në revolucionin e Profetit të Shenjtë. Një pjesë nga kjo fjalë është më poshtë: *"O mbret! Ne kemi qenë njerëz të paditur, të dhënë pas idhujtarisë. Ne hanim edhe mishin e kafshëve të ngordhura dhe bënim të gjitha llojet e punëve poshtëruese. Ne nuk kishim marrëdhënie të mira me farefisin dhe i keqtrajtonim fqinjët. Më i fuqishmi ndër ne përparonte në kurriç të të dobët, derisa, më në fund, Zoti solli një Profet për ndryshimin tonë. Ndershmëria e tij, drejtësia e tij, integriteti i tij dhe devotshmëria e tij njiën mirë nga të gjithë ne. Ai na ka ftuar ta adhurojmë Zotin dhe ta flakim tej idhujtarinë. Ai na ka urdhëruar të flasim të vërtetën, të mbajmë amanetin, të respektojmë farefisninë dhe të sillemi mirë me fqinjët. Ai na ka mësuar ta flakim tej çdo gjë të ligë dhe të shmangim gjakderdhjen. Ai na i ka ndaluar të gjitha punët e pandershme: gënjeshtërinë, keqtrajtimin e pasurisë së jetimit dhe akuzën e gënjeshtërt ndaj ndershmërisë së grave..."*

⁴ Në Betejen e Uhudit, Hindi, gruaja e një kryetari të arabëve paganë e hëngri, vërtet të gjallë mëlçinë e xhaxhait të Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), Hamzait.



për të këqijat që i patën bërë.

Edhe pse u bë sundimtar i vendit të tij, ai qe kaq vetmohues dhe modest, sa mbeti shumë i thjeshtë dhe shumë i kujdesshëm në sjelljen e tij. Ai jetoi në varfëri, si përpara, në shtëpinë e tij me qerpiçe e të mbuluar me kashtë. Ai flinte në një dyshek, që dyshek i thënçin, mbante rroba të rëndomta, hante ushqimin më të thjeshtë, që mund ta hante një i varfër dhe nganjëherë, dilte pa ngrënë fare. Ai kalonte net të tëra duke u falur para Zotit të tij. Ai i vinte në ndihmë nevojtarit dhe të varfrit.⁵ Ai nuk e kishte fare të vështirë të punonte si punëtor. Deri në çastet e tij të fundit, tek ai nuk u pa as shenja më e vogël e madhështisë mbretërore dhe nuk tregoi asnjë lloj mendjemadhësie, që është karakteristike për njerëzit e lartë dhe të pasur. Si një njeri i zakonshëm, ai do të rrinte dhe do të shëtiste me njerëzit dhe do të ndante me ta gëzimet dhe hidhërimet. Ai do të bashkohej e do të përzihej aq shumë me turmën, sa që një i huaj do ta kishte të vështirë të shquante udhëheqësin e popullit dhe sundimtarin e kombit nga pjesa tjetër e grupit.

Pavarësisht madhështisë së tij, sjellja e tij qe ajo e një njeriu të zakonshëm. Në tërë luftën dhe përpjekjet e tij gjatë tërë jetës së tij, ai nuk kërkoi asnjë shpërblim e përfitim për veten e vet dhe as nuk la asnjë pasuri për trashëgimtarët e vet. Ai nuk u kërkoi pasuesve të tij të vinin mënjandëçka për të ose për pasardhësit e tij. Përkundrazi, ai ua ndaloi pasardhësve të tij të përfitonin nga Zekati. Ai ia përkushtoi gjithçka Ymetit (Bashkësisë) të tij.



⁵ Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij) ka thënë: *"Kushdo që vdes pa paguar borxhin ose që lë pas trashëgues, që rrezikohen për t'u varfëruar, të vijë tek unë, sepse, unë jam ruajtësi i tyre."* E tërë jeta e tij është dëshmi e gjallë për këtë.

PROFETI I MËSHIRËS

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

Abstrakt

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është ballka e fundit e zinxhirit të profetëve të Allahut të Madhëruar. Ai ishte ngarkuar me misionin për të plotësuar ndërtësën, themelet e së cilës i kishte hedhur profetët e mëparshëm. Allahu i Plotfuqishëm e ka bërë Profetin Muhammed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) shembullin dhe modelin e përkryer për njerëzimin. Për këtë, Allahu na thotë në Kur'an: “Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu, tek Dita e Fundit dhe që e përmend shumë Allahun.”

Falënderojmë Zotin e Madhëruar që na dërgoi profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), udhëzues për mbarë njerëzimin.

“O Zoti i Madhëruar! Dërgoji përshëndetjet më të ngrohta hazreti Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili ka qenë besniku i shpalljes Tënde! Ai ka qenë personaliteti më i madh në mesin e të gjithë njerëzve. Ai ka qenë robi më i përkryer në mesin e të gjithë robve të Tu. Ai ka qenë profeti i mëshirës, udhëzuesi i njerëzve dhe çelësi i begatave të Tua. O Zot i Madhëruar! Lartësoje pozitën e tij në vendin më të lartë për shkak të gjithë mundit, sakrificës dhe kontributit që ka dhënë në rrugën e udhëzimit të njerëzve dhe në realizimin e misionit të shenjtë! Ngrije deri në atë nivel që askush të mos të jetë i njëjtë me pozitën e tij!” Këto janë fjalët e nipit të



profetit Muhamed, imam Zejnul Abidinit, të birit të imam Hysejnit (Paqja qoftë mbi të!), kushtuar profetit të mëshirës dhe diellit të udhëzimit të njerëzimit.

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka qenë një personalitet i madh. Sa më shumë që koha kalon dhe sa më shumë që përparon të menduarit e njeriut, aq më shumë pasqyrohet madhëria dhe personaliteti i lartë i tij, si dhe shtohet numri i njerëzve që e pasojnë atë dhe zbatojnë porositë e tij të ndritura.

Të gjithë profetët u urdhëruan nga Allahu i Madhëruar që të mbjellin farën e virtyteve të larta morale dhe të pastërtisë tek njerëzit. Qëllimi i tyre ishte të përhapnin besimin në Zotin Një e të Vetëm, të vendosnin drejtësinë dhe të gjykonin e të udhëhiqnin me drejtësi në mesin e njerëzve, të largonin njerëzit nga rruga e shtrembër, nga besëtytnitë dhe t'i udhëzonin ata në rrugën e drejtë e të vërtetë dhe drejt përsosurisë.

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është hallka e fundit e zinxhirit të profetëve të Allahut të Madhëruar. Ai ishte ngarkuar me misionin për të plotësuar ndërtesën, themelet e së cilës i kishin hedhur profetët e mëparshëm. Thirrja e tij ka qenë e bazuar mbi mësimet e Shpalljes së Allahut, siç thuhet edhe në Kur'an, në suren "Nexhm", në ajetet 3 - 5: **"Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje e Zotit, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (melek) shumë i fuqishëm (Xhebraili)."** Për këtë arsye, misioni i tij i përjetshëm nuk ka pësuar asnjë shtrembërim dhe asnjë ndryshim nga parimet themelore të Allahut. Sipas dijetarëve, roli i hazreti Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në ripërtëritjen e të menduarit të njerëzve dhe në shtimin e krijimtarisë dhe dinamizmit në shoqërinë njerëzore ka ndikuar tek ata njësoj siç ndikon rrezja e diellit në botën e ekzistencës. Ai ishte një vatër, e cila tërhiqte të gjithë njerëzit drejt tij. Ka qenë burim për ndryshimin, edukimin dhe udhëzimin e njerëzve. Sipas dëshmive



historike, shpallja e ajeteve kur'anore profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka qenë burim i lulëzimit të racionalizmit të njeriut. Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ndërtoi dhe edukoi një ymet sakrifikues, të mëshirshëm dhe vëllazërues nga njerëz të pacivilizuar e të paditur. Duke përhapur fenë e pastër islame, ai krijoi një lëvizje të madhe në fushën e arsimit dhe emancipimit të njerëzve, e cila arriti deri në atë masë, sa që myslimanët arritën shumë shpejt zhvillim të madh në shkencat e rëndësishme të asaj kohe. Kur'ani e lavdëron për cilësi të larta Profetin e fundit të Allahut. Ndër të tjera, thotë: **“Vërtet, ti je me virtyte madhore.”** (sure “Kalem”, ajeti 4) Ajetet kur'anore thonë se bindja ndaj urdhrave të profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është njësoj si bindja ndaj urdhrave të Allahut të Madhëruar, ndërsa mosbindja, mosrespektimi dhe moszbatimi i urdhrave të profetit Muhamed, është njësoj si mosbindja, moszbatimi dhe mosrespektimi i urdhrave të Allahut Fuqiplotë. Në shumë ajete të Kur'anit, Allahu e ka përshkruar dhe e ka lavdëruar profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Në ajetin 59 të sures “Ahzab” thuhet: **“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melekët e Tij luten për të. O besimtarë, lutuni për të dhe përshëndeteni me selam.”** Sipas Kur'anit, profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), është vula e profetëve, i cili me mësimet e tij i fton njerëzit drejt jetës së lumtur. Në Kur'an lexojmë: **“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është i Gjithëditur për çdo gjë.”** (sure “Ahzab”, ajeti 40) Në ajetin 107 të sures “Enbija”, Allahu na përmend cilësinë e lartë të profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), e cila është mëshira, ku thotë: **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”**



Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) gjithnjë është i gjallë dhe i tillë do të mbesë deri në ditën e fundit të kësaj jete. Nuk ka profet tjetër pas tij. Emri i tij i nderuar do të kujtohet gjithmonë, jo vetëm nga besimtarët, por edhe nga të gjithë ata që e duan lirinë e vërtetë, drejtësinë dhe pastërinë. Ai është i pavdekshëm, sepse mesazhi e tij është i përjetshëm.

Profeti i nderuar i Islamit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) do të mbetet personaliteti më i madh në historinë e njerëzimit. Udhëzimi i njeriut drejt lumturisë dhe mirësisë, ka qenë një detyrë shumë e vështirë, të cilën ai e mbarti mbi supe dhe e kreu me besikëri dhe çiltërsi të lartë. Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), me mësimet e tij të larta e të vyera, ka ndriçuar dhe do të vazhdojë të ndriçojë mbarë botën, sepse ato mësimet janë të shpallura nga Allahu i Madhëruar, i Cili është Drita e qiejve dhe e Tokës. Ato mësimet janë në përputhje të plotë me natyrën e njeriut. Pa dyshim se të mençurit dhe njerëzit e shkencës dhe diturisë mund ta kuptojnë më shumë se të tjerët rolin e këtij personaliteti të madh në udhëzimin e shoqërisë njerëzore drejt lumturisë dhe mirësisë.

Leon Tolstoi ka thënë: *“Vërtet, Sheriati i Muhamedit do të udhëbejë botën për shkak të përputhshmërisë së tij me logjikën dhe urtësinë.”* Marting Lings, mendimtar bashkëkohor anglez, i cili ka e pranuar fenë islame, rreth përhapjes së fesë islame, ka thënë: *“Arsyeja e parë, padyshim, kanë qenë ajetet e Kur’anit të shenjtë që përmbajnë dritën e Allahut dhe aftësinë udhëzuese. Ndërsa arsyeja e dytë, është personaliteti i profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ai është një personalitet i vërtetë dhe i pavdekshëm dhe para se gjithash, ai ka qenë i lidhur me shpalljen e Allahut. Mesazhi i tij ka qenë një mesazh i udhëzimit.”*

Kanë kaluar më shumë se 1400 vjet nga lindja e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), por shumë zemra vazhdojnë të rrahin me kujtimin dhe emrin e kësaj figure madhështore. Me miliarda myslimanë, në vende të ndryshme të botës, çdo ditë në namazet e tyre, dëshmojnë profetësinë e



profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i dërgojnë përshëndetje (salavate) dhe ndjekin mësimet udhërrëfyese të profetit të tyre. Me vdekjen e profetit Muhamed, shoqëria islame nuk u la pa udhëzim, sepse drita e profetit Muhamed vazhdon t'i ndriçojë rrugët e njerëzve. Për këtë arsye, njerëzit kanë detyrime përballë edukatorit më të madh të njerëzimit, Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ndër to, është respekti dhe ndjekja e rrugës së tij. Në Kur'an lexojmë se nëse duam që Allahu të na dojë, le të ndjekim profetin Muhamed: **“Thuaju (o Muhamed): ‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.’”** (sure “Ali Imran”, ajeti 31)

Respekti për Profetin është ndër çështjet që përmenden në Kur'an. Në ajete të ndryshme kur'anore, Allahu i Madhëruar, emrin e Profetit e ka përmendur përkrah emrit të Vet, që tregon se ndjekja e rrugës së Profetit dhe respekti për të është pjesë e besimit dhe e afrimit tek Allahu Fuqiplotë. Allahu thotë: **“Thuaju: ‘Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit...’”** (sure “Ali Imran”, ajeti 32) Askush nuk ka të drejtë të bëjë zgjedhje në kryerjen e një pune që e ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij. Në Kur'an thuhet: **“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre...”**¹

Pozita e lartë e profetit Muhamed duket shumë qartë në disa ajete të Kur'anit. Allahu na thotë që të zbatojmë çdo gjë që na thotë dhe na jep i Dërguari i Tij. Ai na thotë: **“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë ai, hiqni dorë prej saj...”**² Allahu na thotë se krahas Tij, edhe Profeti do t'i shohë punët tona në Ditën e Llogarisë: **“...Me siguri, Allahu dhe i Dërguari i Tij**

¹ Sure “Ahzab”, ajeti 36.

² Sure “Hashr”, ajeti 7.



do t'i shohin veprat tuaja...”³

Kushdo që e kundërshton të Dërguarin, ai do të jetë i humbur, siç na thotë Kur’ani: **“...Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai, me siguri, ka humbur.”⁴**

Në ajetin 157 të sures “A’raf” thuhet se ata të cilët e kanë respektuar dhe e kanë ndihmuar profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) janë prej të shpëtuarve: **“...Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit, të tillët janë të shpëtuarit.”**

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte një person i rrallë edhe në jetën familjare. Edhe pse ai kishte në duar të gjitha çështjet politike, gjyqësore, ushtarake etj., ai gjithmonë ishte njeri i thjeshtë dhe i afërt me njerëzit. Ai ka qenë i butë dhe falë kësaj butësie, njerëzit e pasonin dhe zbatonin ato që ai u thoshte atyre. Në Kur’an lexojmë: **“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishte i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.”⁵**

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), rrugën e devijuar të njerëzimit e ndryshoi me rrugën e drejtë dhe të përsosurisë. Atë popull të paditur, pagan e të egër e shndërroi në një popull të civilizuar, monoteist, të butë e të kulturuar. Pa dyshim, mësimet e Profetit tonë të dashur nuk kufizohen vetëm në një kohë të caktuar. Gjithashtu, as bindja ndaj tij nuk kufizohet vetëm me kohën kur ai ishte i gjallë. Allahu i Plotfuqishëm, profetin Muhammed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e ka bërë shembullin dhe modelin më të përkryer për njerëzimin. Për këtë, Ai na thotë në

³Sure “Teube”, ajeti 94.

⁴Sure “Ali Imran”, ajeti 32.

⁵Sure “Ali Imran”, ajeti 159.



Kur'an: "Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu, tek Dita e Fundit dhe që e përmend shumë Allahun."⁶

Ai ka qenë i pastër dhe larg çdo lloj egoizmi. Ai mendonte vetëm për kënaqësinë e Allahut. Ai ka qenë i mbrojtur nga çdo lloj gabimi. Profeti interesohej për njerëzit më shumë, sesa ata për veten e tyre. Ai është shembull i moralit të mirë. Ndjekja e rrugës së tij siguron lumturinë, përsosurinë dhe shpëtimin në të dyja Jetët. Kur'ani i Shenjtë u kërkon njerëzve që në fjalë, sjellje dhe tradita të ndjekin profetin Muhamed. Po ashtu, edhe shpirti i mësimeve fetare që solli ai, u kërkon shoqërive të prekura nga krizat aktuale që të njohin drejtë sjelljen dhe moralin e lartë të Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe t'i zbatojnë mësimet që përcolli ai, nëse duan të shpëtojnë nga epidemitë shkatërruese që janë përhapur në mesin e tyre.

⁶Sure "Ahzab", ajeti 21.




ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI VII

Abstrakt

Në këtë artikull njihemi me disa argumente shkencore nga Kur'ani, të tillë, si: shpërthimi i yllit në qiell, galaktika dhe tymi, bimët kërkojnë ndihmë, agimi i rremë, shikimi në hapësirë, llava dhe Xhebenemi, shpendi që e shikon peshkun, galaktika jonë etj.

Shpërthimi i yllit në qiell




Teleskopi “Hubble” ka fotografuar një pamje të mrekullueshme të shpërthimit të yllit në qiell, që quhet SN1987A. Ai është shpërthimi më i madh kozmik. Ylli shpërthyes quhet më madhështori. Nododhet 163000 vjet-dritë

larg nesh. Ka shpërthyer para 161000 vjetësh. Mirëpo ne nuk kemi mundur ta shohim këtë shpërthim veçse në vitin 1987, viti, kur drita e shpërthimit mbërriti te ne. Shkencëtarët thonë se epiqendra e rrethit rreth shpërthimit është rreth 20000 vjet-dritë. Një vit-dritë është afërsisht i barabartë me 9.5 milionë milionë kilometra. Shkencëtarët thonë se sot askush nuk e di vendin e vërtetë të këtij ylli dhe ka



nevojë për përlogaritje shumë delikate. Përballë kësaj pamjeje nuk kemi çfarë të themi asgjë tjetër, veçse: I Lartësuar është Krijuesi i kësaj gjithësie, i Cili e Di vendndodhjen e yjeve. Dhe Allahu betohet në yjet. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **“Betohem në çastin e lindjes e të perëndimit të yjeve. E ky është betim i madh. Veç sikur ta dinit!”** (Sure “Uakiah”, ajetet 75-76).

Galaktika dhe tymi




Kjo është galaktika EM 82. Ajo është 12 milionë vjet-dritë larg nesh. Habia është se kur shkencëtarët e analizuan këtë foto gjetën shtresë të dendur tymi (ngjyra e bardhë), shtrirë

për gjatë njëzet mijë vjet-dritë. Ky tym është përbërje kozmike. I Lartësuar është Allahu, i Cili në një prej ajeteve të Tij në Kur'an tregon për praninë e këtij tymi në gjithësi: **“Pastaj Ai iu kthye qiellit, që ishte në gjendje mjegullire e i tha atij dhe Tokës: ‘Ejani të dy me hir a me pahir!’. Ata u përgjigjën: ‘Erdhëm me gjithë dëshirë e të bindur!’”** (Sure “Fusilet”, ajeti 11.) Dhe: **“Prandaj ti prite atë (ditë), kur qielli do të lëshojë tym të qartë, që do t’i mbulojë njerëzit (e do t’u thuhet): ‘Ky është dënim i dhembshëm!’”** (Sure “Duhan”, ajetet 10-11). Shkencëtarët thonë se së afërmi ky tym kozmik mund të arrijë mbi kokat tona.

Pjesshmëria e ujit

Kjo pamje nuk është as diamant e as gur i çmuar. Ajo është një pjesshmëri e ujit. Studimet e kryera nga disa shkencëtarë thonë se trajta e pjesëve të ujit ndryshon dhe ndikohet nga fjalët që u drejtohen





atyre. Për këtë, leximi i Kur'anit mbi ujin ua shton aktivitetin pjesëve të ujit dhe vë në lëvizje fuqinë shëruese, që gjendet në këtë ujë. Kështu që, uji të cilit i janë lexuar ajete nga Kur'ani ndryshon nga uji i zakonshëm për nga fuqia e shërimit. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne shpallim nga Kur'ani atë që është shërim dhe mëshirë për**

besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.”
(Sure “Isra”, ajeti 82).

Jâ Sîn. Betohem në Kur'anin plot urtësi

Në fillim të sures “Jasin” Allahu i Madhëruar thotë: **“Jâ Sîn. Betohem në Kur'anin plot urtësi!”**. Në shkronjat e këtyre rreshtave duket qartë mrekullia numerike, që ka lidhje me numrin 114, që është edhe numri i sureve të Kur'anit. Po të shkruajmë numrin e shkronjave të çdo fjale, siç është shkruar në Kur'an, do të shohim këtë numër: Mrekullia duket te numri 6612. Ky numër është prej shumëfishit të numrit 114, pra: $58 \times 114 = 6612$.

Profeti i nderuar (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka quajtur këtë sure “zemra e Kur'anit”. Për këtë, po ta kthejmë në të kundërt numrin 6612, bëhet 2166 që është përsëri prej shumëfishit të numrit 114. Me gjuhën e numrave mund të shkruajmë: $19 \times 114 = 2166$.

Pra, numri i shkronjave tek të dy ajetet e mësipërme të sures «Jasin» është në përputhje me numrin e sureve të Kur'anit - sido që ta lexojmë numrin. A nuk është kjo mrekulli dëshmuese për vërtetësinë e Kur'anit?



Zogjtë: Kush e udhëzoi këtë zog?



Ky zog përpiket për të ushqyer të vegjëlit e tij pa asnjë lloj mësimi. Shkencëtarët vërtetojnë se të gjitha krijesat e gjalla janë të programuara, me qëllim që t'i kryejnë veprimet e tyre në formën më të plotë e të përsosur - në atë formë që garanton shumimin

dhe vazhdimësinë e tyre. Shkencëtarët pyesin: Kush është ai që ua inspiroi dhe ua mësoi atyre këtë teknologji të ndërlikuar? Kush është ai që i udhëzon këto krijesa që t'i kryejnë këto veprime? Është Allahu, i Cili thotë: **“Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar.”** (Sure “Ta Ha”, ajeti 50).

Të menduarit dhe besimi në vetvete

Në një studim të ri shkencor sqarohet se zona e përparme e trurit është përgjegjëse për drejtimin dhe vetëbesimin te njeriu. Numri i qelizave në këtë zonë është më i madh tek ata që kanë një vetëbesim të fortë në qëndrimet dhe vendimmarrjet e tyre. Shkenca thotë se zona e përparme e kokës (pjesa e ballukes) është pjesa më e rëndësishme e mendjes për të menduarit e shëndoshë. Në Kur'an është një tregues i shkëlqyer për këtë zonë dhe pikërisht në thënien e profetit Hud (Paqja qoftë mbi të!): **“Unë mbështetem tek Allahu, Zoti im dhe Zoti juaj. S'ka asnjë gjallesë që të mos jetë nën pushtetin e Tij. Me të vërtetë, Zoti im është në rrugë të drejtë.”** (Sure “Hud”, ajeti 56). Kjo do të thotë se ai që ia dorëzon mendjen e tij Allahut të Madhëruar, do të jetë në rrugën e drejtë dhe vendimmarrjet e tij do të jenë të drejta, me lejen e Allahut. Ja përse Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thonte në lutjen e tij: **“Në dorën Tëndë është mendja im.”**



Detet: Përzierja e dy deteve



Shkencëtarët thonë se në grykën e derdhjes, ujërat e ëmbla të lumenjve depërtojnë disa metra në det. Megjithë kripën e shumtë të ujit të detit, asnjëri prej këtyre ujrave nuk mund të kapërcejë

mbi tjetrin. Ky balancim qëndron me mijëra vjet sipas ligjeve të fizikës konstante, të caktuara nga Krijuesi i Plotfuqishëm. Këtë e thotë Kur'anë në një ajet madhështor: **“Është Ai që i ka lënë të lirë dy ujëra, - njëri i pijshëm e i ëmbël, kurse tjetri i kripur e i hidhur, - duke ngritur pengesë e kufi të prerë ndërmjet tyre.”** (Sure “Furkan”, ajeti 53).

Tymi i qiellit



Kjo është një re e madhe tymi kozmik. Shkencëtarët kanë zbuluar se galaktika në fillimet e formimit të saj ka qenë e mbushur plot më këto re tymi. Ato janë formuar para miliona vjetësh. Shkencëtarët thonë se përbërja e pjesëzave të këtyre reve i

ngjan tymit të zakonshëm. Prandaj e quajnë “smoke” - tym. Është e



mahnitshme: Kur'ani e përmend këtë të vërtetë shkencore para më se katërmëdhjetë shekujsh, kur thotë: **“Pastaj Ai iu kthye qiellit, që ishte në gjendje mjegullire e i tha atij dhe Tokës: ‘Ejani të dy me hir a me pahir!’. Ata u përgjigjën: ‘Erdhëm me gjithë dëshirë e të bindur.’”** (Sure “Fusilet”, ajeti 11). **I Lartësuar është Allahu!**

Toka: Plasaritja (çarja) e Tokës



Plasaritja e Tokës shkon deri në 1300 kilometra. Ka një rrjet të madh plasaritjesh që e ndajnë sipërfaqen e Tokës në një grup tablosh e që formojnë një plasaritje të bashkuar. I Lartësuar është Allahu, i Cili për këtë plasaritje (çarje) ka thënë: **“Dhe për**

Tokën që plasaritet.” (Sure “Tarik”, ajeti 11).

Bimët kërkojnë ndihmë

Kohët e fundit shkencëtarët kanë zbuluar se bimët kërkojnë ndihmë nga disa kandrra të mëdha, për t'i shpëtuar nga kandrrat e vogla. Këto bimë lëshojnë lëndë kimike që tërheqin kandrrat e mëdha që shkojnë te bima dhe gëlltitin kandrrat e vogla. Në këtë mënyrë, bimët shpëtojnë prej kandrrave të vogla. Ky zbulim tregon se bimët janë krijesa të zgjuara. Allahu i ka bërë të tilla, ua ka mësuar këtë metodë, që të shpëtojnë veten e tyre. Pyesim: Vallë, kush ua mësoi bimëve këtë metodë? Kush i udhëzoi bimët? Sigurisht, Allahu, i Cili në Kur'an thotë: **“Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar.”** (Sure “Ta Ha”, ajeti 50).



Agimi i rremë



Pamja e agimit të rremë është, thjesht pasqyrimi i rrezeve të diellit për shkak të pranisë së pluhurit. Ky agim shfaqet afërsisht gjysmë ore para agimit të vërtetë dhe zgjatet për së larti, siç shihet në foto. I lartësuar është Allahu. Profeti (Paqja dhe bekimet e

Allahut qofshin mbi tël) ka folur për këtë dukuri dhe e ka ngjasuar agimin e rremë me gjynahun e dhi'bul merfu. Ai ka thënë: “Agimi është dy llojesh: agimi ëndërrimtar, që është i rremë dhe hapet vertikalisht dhe agimi i vërtetë, që hapet horizontalisht.” (Es Silsiletu Es Sahihah) Me këtë thënie, Profeti ka bërë dallimin mes agimit të rremë dhe agimit të vërtetë dhe secilin e ka përshkruar me përpikëri. Ky përshkrim dëshmon vërtetësinë e profetësisë së tij.

Shikimi në hapësirë

Kur astronautët u ngritën në qiell, ndienin sikur po notonin në errësi të plotë, e sikur sytë ishin mbyllur. Prandaj themeluan një degë të re shkencore - ajo që zgjidhte problemin e shikimit gjatë qëndrimit në anijet kozmike në hapësirë. E habitshme është se Allahu e tregon këtë në Kur'an kur thotë: **“Edhe sikur Ne të hapnim një derë të qiellit dhe të ngjiteshin nëpër të, ata me siguri do të thoshin: ‘Sytë tanë kanë qenë të shushatur, madje na kanë magjepsur.’”** (Sure “Hixhr”, ajetet 14-15). Në ajetin: **“Sytë tanë kanë qenë të mbyllur...”** tregohet qartë për problemet në shikim kur dilet jashtë Tokës. Këtë e ka vërtetuar edhe shkenca e sotme.



Hapësira: Qëndrimi në hapësirë

Në vitet e ardhshme shkencëtarët do të krijojnë “hotele” hapësinore (kozmiqe), ku çdo njeri do të ketë mundësi të ngjitet dhe të qëndrojë një javë a më shumë. Para disa vjetësh kjo gjë sillej vetëm si shembull ëndërrimtar; sot është një e vërtetë reale: njeriu ka arritur të udhëtojë me anije kozmiqe drejt qiellit. E mahnitshmja është se Kur’ani na flet se njeriu do të udhëtojë në këto shtresa të hapësirës kozmiqe nëpërmjet mjeteve të ndryshme. Allahu i Madhëruar thotë: **“Betohem në kuqërrimin e muzgut, në natën e në gjithçka që ajo kaplon me errësirën e saj, si dhe në hënën e plotë se ju, me siguri, do të kaloni nga e keqja te më e keqja.”** (Sure “Inshikak”, ajetet 16-19). A nuk është kjo një mrekulli që dëshmon vërtetësinë e Kur’anit të shenjtë?

Zemra: Të dëgjuarit dhe zemra

Shkencëtarët kanë argumentuar lidhjen mes të dëgjuarit dhe zemrës. Sigurisht, zërat e lartë e të vazhdueshëm mund të shkaktojnë probleme në dëgjim, çorientim gjumi dhe acarim nervor e psikik. Zhurmat, me të cilat ballafaqohet vazhdimisht njeriu, ndikojnë edhe në funksionimin e zemrës dhe çojnë në atake kardiake. Problemet e zemrës në raste të veçanta çojnë në probleme dëgjimi. I Lartësuar është Allahu, i Cili ka paralajmëruar për këtë lidhje mes zemrës dhe dëgjimit, kur thotë: **“Ua vulosim zemrat, që të mos dëgjojnë.”** (Sure “Araf”, ajeti 100).

Mollëzat e gishtave të njeriut

Është vërtetuar shkencërisht se çdo njeri në sipërfaqen e Tokës, nga koha e Ademit (Paqja qoftë mbi të!) e deri në ditët e sotme, ka shenjë të veçantë në gisht: askush nuk është ortak në këtë shenjë;



secili ka shenjë e vet të posaçme. Kjo shenjë dallohet me vija të

imta e të ndërlikuara. Kjo shenjë është mjeti i njohjes së identitetit të njeriut. Sikur gishtat të ishin të gjithë të njëjtë, nuk do të kishin të tilla vija, hetuesit nuk do të ishin në gjendje të njihnin gjurmët e krimit. Kjo e vërtetë shkencore është zbuluar kohët e fundit,

kurse Kur'ani e thotë para më se 1400 vjetësh: **“...Ne jemi të Zotë t’ia ribëjmë bashkë me përsosuri edhe majat e gishtave të tij.”** (Sure “Kijameh”, ajeti 4). I Lartësuar është Allahu.



Dielli: Eklipsi i Diellit

Në këtë foto shikojmë eklipsin e Diellit. Eklipsi i Diellit është shenjë prej shenjave të Allahut të Madhëruar. Në të shkuarën, dukuria e

eklipsit të Diellit i frikësonte njerëzit. Nga frika, ata thurnin legjenda dhe besonin se ai ndodhte për shkak të vdekjes së ndonjë udhëheqësi ose paralajmëronte humbjen në ndonjë betejë etj. Mirëpo profeti Muhamed

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i hodhi poshtë legjendat për eklipsin e Diellit. Ai tha: “Vërtet, dielli dhe hëna janë dy shenja prej shenjave të Allahut të Madhëruar. Ato nuk eklipsohen as se vdes dikush e as se lind dikush. (Transmeton Bukhariu dhe




Muslimi.) A nuk dëshmon ky hadith se profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk flet nga vetja e vet?

Bleta: Krijimi i përsosur i bletës

Shkencëtari gjerman Vulgang Shturtsel thotë: “Edhe pse truri i bletës është i vogël porse ajo e sheh botën në disa kënde dhe arrin ta zbulojë atë në mënyrë të mahnitshme. Me anë të strategjive të thjeshta dhe trurit të vogël, bleta arrin të zgjidhë çështjet me lehtësi të paparë. Me të vërtetë, shkencëtarët janë të paaftë para këtij krijimi madhështorë që gjendet te bleta. Kush e frymëzoi bletën? Allahu Fuqiplotë. Ai thotë: **“Zoti yt e frymëzoi bletën** (duke i thënë): **‘Ndërto shtëpi në male dhe në drurë dhe në atë (kosheren) që kanë ngritur njerëzit.’**” (Sure “Nahl”, ajeti 68) I lartësuar është Allahu.

Llava dhe Xhehenemi

Pamje e llavës së shkrirë që vëlon në një vullkan veprues. Ky zjarr është një pamje e vogël e zjarrit të Xhehenemit. Allahu i Madhëruar thotë:



“Kurse për ata, që e mohojnë Zotin e tyre, dënimi është Xhehenemi. Eh, sa i shëmtuar është ai vendbanim! Kur të hidhen aty, do të dëgjojnë ulërimën e tij, ndërkohë që ai vlon gati për të shpërthyer me furi. Sa herë që aty

të hidhet ndonjë grup, rojtarët e tij do t'i pyesin ata: ‘A nuk



ju erdhi ndonjë paralajmërues?!’ ‘Po - do të përgjigjen ata - na kanë ardhur, vërtet paralajmërues, por ne i quajtëm ata gënjeshtarë dhe thamë: ‘Allahu nuk ka shpallur asgjë; ju jeni në një humbje të madhe.’ Ata do të thonë: ‘Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim midis banorëve të Zjarrit Flakërues!’ Kështu, ata do ta pranojnë gjynahun e tyre. Larg qofshin prej mëshirës së Zotit banorët e Zjarrit Flakërues!» (Sure “Mulk”, ajetet 6-11).

Ngjyra e kuqe e zjarrit tregon gradën e temperaturës (mijëra gradë). Por në Xhehenem ngjyra e zjarrit do të jetë e zezë dhe i gjithë Xhehenemi do të jetë errësirë. Prej habive të numrave në Kur’an është: Xhehenemi ka shtatë porta. Nëse do të hulumtojmë rreth ngjyrës së zezë në Kur’an, do të gjejmë se ajo përsëritet shtatë here. Ky numër është i barabartë me numrin e dyerve të Xhehenemit. I Lartësuar është Allahu.

Shpendi që e shikon peshkun

Allahu i Madhë-ruar i ka dhënë mundësi këtij shpendi ta shohë



peshkun në sipërfaqen e ujit, të përcaktojë me saktësi vendodhjen e tij dhe të bëjë të gjitha llogaritjet e duhura, që sulmi nga ajri të dalë me sukses. E gjitha kjo ndodh në trurin e shpendit

të vogël. Shkencëtarët habiten nga këto llogaritje të ndërlikuara. Ata thonë: Si ka mundësi që natyra ta ketë pajisur këtë shpend me këto karakteristika? Ne themi: Nuk është natyra e verbër, por është Allahu, i Cili thotë: **“Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë**



trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar.” (Sure “Ta Ha”, ajeti 50).

Galaktika jonë

Galaktika jonë, me yjet e saj të ndritshme. Shkencëtarët thonë se çdo yll është një diell si dielli ynë, madje mund të jetë shumë më i madh se dielli që shohim ne. Kjo galaktikë ka 100000000000 yje. Mirëpo ne shohim vetse pak prej tyre. Si do të ishte nëse ne do të mësonim se kozmosi ka më shumë se 100000000000 yje?! I Lartësuar është Krijuesi i Madhëruar. Pyesim: Ku je ti, o njeri në këtë gjithësi? Allahu i Madhëruar thotë: **“Krijimi i qiejve dhe i Tokës është më i madh se krijimi i njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e di.”** (Sure “Gafir”, ajeti 57).

Përse dënohet me goditje laviri dhe pirësi i alkoolit?

Disa shkencëtarë kanë zbuluar një metodë që ndikon në shërimin e varësisë seksuale dhe të drogës nëpërmjet goditjes së njeriut në shpinë. A është ky dënim i lavirit dhe i përdoruesit të alkoolit i drejtë në fenë tonë?

Më 7/1/2013 gazeta e njohur britanike “Daily Mail”, e cila është jofetare, ka botuar një artikull rreth metodës së re për shërimin e varësisë pas seksit, drogës dhe pijeve alkoolike: nëpërmjet goditjes disa herë në shpinë. Vallë, cili është sekreti i kësaj metode?

Doktori German Pilipenko dëshmon se ka shëruar më shumë se një mijë raste me këtë metodë. Madje, shumë njerëz nga shtete të huaja shkojnë tek ai për të përfituar nga ky shërim.

Një dijetar siberian thotë: Goditja ndihmon në prodhimin e endorfinës (Endorphins) nga truri. Kjo lëndë është përgjegjëse për kënaqësinë trupore. Ajo e bën njeriun të ndiejë lumturi. Kjo e shpëton nga kryerja e marrëdhënieve seksuale dhe nga konsumimi i drogës.

Psikologët thonë: “Vërtet, kjo metodë është si një dënim trupor për



mëkatet pas alkoolit a të zinasë. Por ajo e bën njeriun që ta ndiejë gjynahun e tij, ta ndiejë se ajo që po bën, është një gabim i madh e prandaj me doemos duhet hequr dorë prej saj dhe të mos e përsërisë atë. Kjo metodë është përdorur nga disa murgjër para qindra vjetësh. Doktor Sergei Speranski, drejtor i një Instituti të Mjekësisë në Novosibirsk të Rusisë, pohon se metoda e goditjes me kallam uji apo me thupër në shpinë ndikon në shërimin e krizave të dëshpërimit dhe të ndjenjës së mëkatit. Përse? Sepse, goditja ngacmon zona të posaçme në trurin e narkomanit, për shembull dhe në të ndodhin procese të ndërlikuara që çojnë në heqjen dorë nga varësia me lehtësi. Tani le të pyesim: Përse Perëndimi pranon çdo rrugë shërimi, qoftë edhe goditjen me shkop dhe e praktikon dhe e përhap këtë metodë, të cilën e ka përmendur Islami më parë? Përse i refuzon mësimet e Islamit?

Në Kur'an thuhet: **“I goditni lavirin dhe laviren me nga njëqind goditje!”** (sure “Nur”, ajeti 2) Ky dënim e pastron lavirin dhe laviren, ndalon të tjerët dhe shkël nga rrënjët marrëdhëniet e jashtëligjshme seksuale. Në këtë mënyrë, shpëtojnë miliona njerëz nga ky gjynah i madh dhe shkatërrues. Mirëpo, Perëndimi nuk pranon asnjë metodë shërimi që ka ardhur nëpërmjet Kur'anit. Sot shohim se ata e pranojnë po të njëjtën metodë shërimi me anë të goditjes, sepse ka ardhur nga Rusia dhe nga njerëz jomyslimanë. I Lartësuar është Allahu.



TRURI DHE EDUKIMI¹

Abstrakt

Në jetën e përditshme themi se “aksh njeri është i zgjuar e do të doja të dija sa ai.” Vlerësime të tilla lidhen me punën e cilësinë e trurit të tjetrit. Truri është vepër e geneve ose e recetave të koduara. Truri ynë kodifikon përvojat, drejton sjelljen, sistemon mendimet dhe emocionet. Truri ndryshon në varësi të edukimit që marrim. Truri riorganizohet pa ndërprerje në varësi të edukimit dhe të mjedisit. Psikologët thonë se gjenet kanë po aq pikë sa edukimi ose ndoshta pak më shumë. Gjenotipi është mundësia, potenciali, ndërsa edukimi e kthen mundësinë në realitet.

Jeta e njeriut fillon nga ngjizja dhe mbaron me vdekjen. Qeliza riprodhuese mashkullore dhe qeliza riprodhuese femërore bashkohen e formojnë zigotën, ose vezën e pllenuar. Veza e pllenuar ndahet në dy, katër, tetë qeliza e kështu me radhë. Dy javë pas ngjizjes, qelizat fillojnë të specializohen. Fillon formimi i organeve. Disa japin qelizat nervore, disa lëkurën, eshtrat e kështu me radhë, të gjitha organet e organizmit. Në muajin e tretë pas ngjizjes, fetusi është 2.5 cm i gjatë. Ai i ngjan një qenieje njerëzore: ka kokën, duart, këmbët... Zemra fillon të rrahë. Ajo e fillon punën e saj. Pushon kur vdes njeriu. Qelizat nervore shumohen me shpejtësi të jashtëzakonshme: 250,000 në minutë.

Njeriu i rritur ka afro 100 miliardë qeliza nervore në kokë. (Psikologjia,

¹ Fjala *edukim* përdoret në kuptimin e saj më të përgjithshëm: marrja e dijeve dhe e shprehive nga njeriu në shkollë, në familje, në shoqëri dhe nëpërmjet veprimtarisë së vet.




Charles G. Morris & Albert A. Maistro, Tiranë , 2008 f.44). Ai ka 16 herë më shumë qeliza se ka Toka banorë. Miliarda neurone të tjera janë në pjesët e tjera të sistemit nervor. Truri i njeriut të rritur peshon 1.6 kg. Në moshën dy vjeçare, truri i fëmijës ka 75% të masës së trurit të të rriturit. Në moshën 10 vjeç ka përfunduar rritja e trurit. Në 18 vjeç, truri është i aftë të mendojë në mënyrë abstrakte. Nga mosha 20 vjeç deri në 70 vjeç, njeriu humbet afro 20% të qelizave nervore. Të moshuarve u vdesin me shpejtësi qelizat nervore. Mendja e të moshuarit punon më ngadalë. Disa lloje kujtese e kanë të vështirë për të ruajtur e riprodhuar. Një i moshuar e ka të vështirë të mësojë pjesë përmendsh, siç ka bërë në rini. Në moshë madhore pakësohen shumë aftësitë njohëse.

Në jetën e përditshme themi se “aksh njeri është i zgjuar e do të doja të dija sa ai.” Vlerësime të tilla lidhen me punën e cilësinë e trurit. Truri është vepër e gjeneve ose e recetave të koduara. Një dukuri mjaft interesante është diferencimi qelizor. Qelizat nervore të lëkurës, të stomakut etj. kanë tek individit të njëjtën ADN, të njëjtat gjene. Përse ndodh që disa qeliza bëhen neurone e jo të njëllojta, të themi me qelizat kockore?

ADN ka katër baza të azotuara. Njëra është citozina, që simbolikisht shkruhet C. Sipas një shpjegimi, ndodh metilimi i C, që do të thotë, citozinës t'i shtosh një grup – CH₃. Metilimi bllokon transkriptimin e disa gjeneve e lejon disa të tjera të punojnë. Në këtë mënyrë, truri krijohet ndryshe nga lëkura, ose mëlçia.

Pamje e një neuroni



Qelizat nervore quhen neurone. Neuronit ka trupin me bërthamën në mes. Ajo ka zgjatimet e shkurtra, që quhen dendride dhe zgjatimin e gjatë, që quhet akson. Aksoni është i mbështjellë me një këllëf që quhet këllëfi i myelinës.



Ai është substancë e yndyrshme. Këllëfi siguron izolimin dhe rrit shpejtësinë e përcjelljes së mesazheve. Aksoni përfundon me nyjat fundore. Dendridet përcjellin mesazhet nga neuronet e tjera tek trupi i qelizës. Një qelizë nervore është e gjatë 1 - 2 milimetra. Aksoni i neuroneve të nervit të gjymtyrëve të poshtme shkon deri 100 cm. Aksoni i nervit të qafës së gjirafës arrin deri 300 cm. Aksoni çon njoftime te një neuron ngjitur ose në një gjëndër a muskul. Neuronit është si një rrugë me një korsi dhe me një drejtim lëvizjeje. Ai është si madhësi vektoriale. Njoftimi përcillet nga dendridet tek trupi i qelizës, nga trupi i qelizës tek aksoni dhe jo e kundërta. Kur flasim për një nerv, kuptojmë një grup aksonesh të grupuara në një kabëll elektrik. Nga truri dalin dymbëdhjetë çifte me nerva.

Disa neurone mbledhin njoftime nga organet e shqisave dhe i çojnë në tru ose në palcën e kurrizit. Këto quhen neurone shqisore. Pjesa fundore e syrit ose e veshit është zgjatim i nervave të trurit. Neuronet motore e çojnë mesazhin nga truri ose nga palca e kurrizit te muskujt dhe gjëndrat. Interneuronet mbartin mesazhe nga një neuron te një tjetër. Janë edhe qelizat ngjitëse (gliale). Këto i mbajnë qelizat të fiksuara, ushqejnë e largojnë mbetjet. Qelizat ngjitëse luajnë rol në proceset e të nxënies dhe të kujtesës, zgjerojnë komunikimin midis neuroneve, ndikojnë mbi reagimet e trurit ndaj përvojave të reja.

Neuronet “flasin” me njëra-tjetrën me gjuhën e impulseve elektrokimike. Impulset elektrokimike ngjasojnë me rrymën elektrike në tretësira të kripërave dhe jo me rrymën elektrike në metale. Në gjendje qetësie, membrana që rrethon neuronin ka nga jashtë jone natrium ose kalium të ngarkuar pozitivisht. Brenda membrana ka jone negative klori. Jonet negative të klorit janë më shumë se jonet pozitive të natriumit ose të kaliumit. Diferenca mes ngarkesave të joneve në dy anët e membranës së qelizës nervore krijon potencial elektrik. Ky quhet potencial i qetësisë. Neuronit në gjendje prehjeje është i polarizuar. Potenciali i prehjes është -70 milivoltë (mv). Kur një ngacmues stimulon dendridet e neuronit, membrana e



neuronit bëhet e përshkueshme. Poret e membranës hapen. Futen brenda fluks jonesh natrium, të ngarkuara pozitivisht. Ky proces quhet depolarizim. Pjesa e brendshme ngarkohet pozitivisht; pjesa e jashtme, negativisht. Krijohet një proces zinxhir depolarizimi përgjatë qelizës - lëvizja e drejtuar e joneve nga brenda jashtë e anasjellas. Ky quhet impuls neural a potencial veprues.

Madhësia e potencialit të veprimit është plus 40 mv. Kjo vlerë ulet në -90 mv. Sapo arrin -90 mv, rritet përsëri. Në -60 mv është pragu i nxitjes. Ky proces ndodh brenda disa të mijtave të sekondës. Duhet energjia e një ngacmuesi tjetër të “shkrepë” përsëri neuroni. Shpejtësia e përcjelljes së impulseve është nga 1.2 m për sekondë deri 120 m për sekondë. Kjo shpejtësi është shumë, shumë herë më e vogël se lëvizja e drejtuar e elektroneve në përcjellës metalik. Impulset elektro-kimike tejçohen me porcione, jo në mënyrë të vazhduar, si përcjellja elektrike te metalet.

Impulsi neural ngjan disi me natyrën e dritës. Emetimi i dritës bëhet me porcione, jo në mënyrë të vazhduar. Nëse atomit i japim energji, elektroni i tij kalon nga një nivel energjetik më i ulët në një nivel energjetik më të lartë. Elektroni kthehet në nivelin e mëparshëm energjetik. Gjatë kthimit, e çliron energjinë e thithur në formë drite. Duhet energji tjetër ta nxisë atomin përsëri.

Qelizat nervore nuk lidhen njëra me tjetrën si hallkat e një zinxhiri. Mes dy qelizave ngjitur që “flasin” ka një hapësirë që quhet hapësirë sinaptike. Nyja fundore e aksonit të një neuroni gati prek dendritet ose trupin e një neuroni tjetër. Kjo quhet sinaps. Hapësira sinaptike është një e milionta e 2.5 cm. Kur impulsi neural vjen në nyjën e aksonit, nyja çliron nga qeskat e saj një substancë neurotransmetuese që bën të lindë potenciali i veprimit të qelizës tjetër. Sa nxitet neuroni i dytë, neurotransmetuesi shkatërrohet. Nëse neurotransmetuese ka qenë acetilkolina, atëherë asnjansuesja e saj është kolinesteraza. Duhet të vijë impuls neural tjetër e të çlirohet neurotransmetuesi. Lëvizja e elektrolitëve në neuron lind përcjellje kimike e kjo e fundit është përsëri elektrolitike. Një neuron ka mundësi e aftësi për



t'u lidhur me shumë neurone të tjera. Lidhja sinaptike, nëse nuk përdoret, zhbëhet. Futet harresa. Këtu lind nevoja e përsëritjes. Që njeriu t'i mbajë lidhjet sinaptike në gjendje pune (të pakëputura), duhet të lexojë çdo ditë, të paktën 30 faqe libri.

Neurotransmetues janë katër kimikate të trurit:

- 1- Acetilkolina vepron kur neuroni takon me muskujt e skeletit. Ajo luan rol në përqendrimin, vëmendjen, kujtesën, motivimin. Sëmundja e Alzheimerit ka të bëjë me pakësimin e këtij kimikati. Pacienti ka dobësim të kujtesës, mosbashkërendim të muskujve. Ai mund të shkojë deri në paralizë ose ngurtësim të muskujve.
- 2- Dopamina ndikon mbi neuronet që lidhen me lëvizjet e vullnetshme, të nxënët, kujtesën, emocionet. Sëmundja e Parkinsonit ka të bëjë me humbjen e qelizave të trurit që prodhojnë dopaminë. Prodhet më pak dopaminë. Pacienti ka dridhje. Sasia e tepërt lidhet me deliret.
- 3- Serotina është kimikati i emocioneve, gjumit, ëndrrave, humorit, sjelljes agresive, depresionit.
- 4- Endomorfina është substancë që ka të bëjë me parandalimin e dhembjeve, deliret etj. Ajo çlirohet gjatë ushtrimeve të sforcuara fizike.

Sekreti i jetës fshihet në fjetet e ADN. Ajo ka informacionin e ngjizjes së organizmit të ri, formimin e imët të pjesëve të trupit, recetën që organizmi t'u ngjajë prindërve dhe të mos jetë fotokopje e tyre. Në formimin tonë, si qenie të ndërlikuara sociale ndikon trashëgimia dhe mjedisi.

Deri tani është folur për çfarë na ka dhënë Zoti.² Le të kalojmë tek edukimi. Ai fillon me ngjizjen. Truri ynë kodifikon përvojat, drejton sjelljen, sistemon mendimet dhe emocionet. Truri ndryshon në varësi të edukimit që marrim.³

² (2:21; 4:56; 6:2; 14: 20,21; 15:26; 22:5; 23:12-14; 23:78; 25:54; 27:93; 30:8; 39:6; 53:45,46; 55:14; 71:13; 80:17-19; 96:15,16) *Shënim i redaksisë.*

³ (8:24; 10:101; 35:28; 39:19; 55:33) *Shënim i redaksisë.*



Eksperimentet e bëra me minj, kanë treguar se kur këto gjallesa rriten në mjedise të "pasuruara", neuronet e tyre kanë më shumë lidhje sinaptike dhe neurone më të mëdha, në krahasim me ata të rritur në mjedise të zbrazura.

"Duke mbajtur mend, mbushemi me mend". (Kosova e Shqipëria, Rexhep Qosja, Tiranë 2013, f. 444.) Njeriu është vetë edukimi. Sot kemi më shumë inxhinierë kompjuterash, më shumë mjekë, më shumë inxhinierë etj. vetëm në saje të edukimit. Nëse përfytyrojmë një njeri që nuk ka marrë edukim, ai do të ngjajë më shumë me një qenie johumane. Truri ynë ndryshon sipas përvojave të organizmit, të ndikuara nga edukimi. Edhe të folurit që e kemi të programuar gjenetiksht, duhet të edukohet. Nëse mjedisi flet shqip ose anglisht, ashtu do të flasim edhe ne. Pianistët luajnë me lehtësi duart mbi tastierë. Edukimi ka çuar në ndryshime në trurin e tyre në raport me të tjerët, që nuk e kanë marrë këtë edukim. Çdo lëvizje i merr urdhrat nga truri.

Truri riorganizohet pa ndërprerje në varësi të edukimit dhe mjedisit. Edukimi është energji; ai përkthehet në terma materialë në tru: konkretisht, më shumë lidhje sinaptike - neurone më të organizuara. Truri bën të mundur rritjen e shpejtësisë së komunikimit përmes sinapseve. Instrumentistët e veglave me tela, që e fillojnë edukimin para moshës 10 vjeç, kanë shtim të aktivitetit neural në zonën e hemisferës, që përgjigjet për dorën e majtë, në raport me ata individë që nuk e kanë marrë këtë edukim. Një ushqim i balancuar ndikon në formimin tonë. Ai fillon që në çastin e ngjizjes e gjatë gjithë jetës. Njeriu ka 140 pikë të mundshme të formimit të tij intelektual. Mendohet se ushqimi i balancuar i jep atij 20 pikë për këtë formim. Nëse një student ka sezion provimesh dhe ka një lëndë të vështirë (ose ashtu e koncepton), truri tij e analizon situatën. Ai nis sinjale në gjëndrën e hipofizës. Hipofiza e përcjell te gjëndra mbiveshkore. Kjo e fundit prodhon kortizol më shumë se zakonisht. Kortizol në gjak do të thotë stres (goditje në tru e zemër). Studenti ka emocione, ritëm të shpejtuar të zemrës.



Psikologët i gjejnë rezervat intelektuale të njeriut në mosha të reja, falë plasticitetit neural të neurotransportuesve e strukturave qelizore. Fëmijët e emigrantëve e kanë mësuar gjuhën e vendit pritës më shpejt se prindërit e tyre. Konard Lorenc (1966) ka teorinë e fazave kritike. Ai thotë se sjelljet e të nxëniet kanë fazat absolutisht të fiksuara moshore. Në fazën e përcaktuar kritike mësohet më shumë, më mirë e më shpejt. Përpara e pas, mësohet me sforçime ose nuk mësohet fare. Edukimi duhet të jepet pak përpara fazës kritike. Nëse dy gota kanë të njëjtën sasi lëngu, por gota e parë është e gjatë dhe e hollë, kurse e dyta e gjërë, fëmijët para moshës pesë vjeç thonë se gota e parë ka më shumë lëng, sepse ata marrin në vëmendje vetëm lartësinë e kolonës së lëngut. Fëmijët e moshës tetë vjeç e përcaktojnë saktë. Kufiri moshor është te shtata. Sipas Piazhësë, psikolog zvicerian, 1896-1980, njeriu bëhet i aftë për të menduar në mënyrë abstrakte pas moshës 11-vjeçare. Ai vendos lidhjen shkak-pasojë jo më përpara kufirit kohor 11-vjeç. Psikologu Bedri Dedja ka shkruar para 50 vjetësh për dy vajza binjake nga Lezha. Ato kanë qenë homozigotë, që kanë të njëjtin material trashëgues. Njëra shkon në Korçë për disa vjet. Bie në një mjedis intelektual nxitës. Takohen më pas. Dallimet intelektuale kanë qenë të mëdha. Korçarja ka pasur zhvillim intelektual të mirë në raport me lezhianen e rritur në mjedis të zakonshëm.

Siç dihet, përcaktimet sasiore shpesh tregojnë shumë. Në formimin tonë kompleks, si qenie sociale, natyra e mjedisit kanë përqindjen e tyre në zhvillimin e trurit. Psikologët thonë se gjenet kanë po aq pikë sa edukimi ose ndoshta pak më shumë. Gjenotipi është mundësia, potenciali, ndërsa edukimi e kthen në realitet mundësinë. Karakteristikat e vëzhgueshme të personalitetit tonë, që përcaktojnë individin e papërsëritshëm, ndikohen nga të dyja – gjenotipi dhe edukimi.



PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ

Abstrakt

Në artikull jepen vetitë shërnese të borzilokut, bushit, sumullbarit, vjeshtullës së bardhë, karafilegenit, pelinit, pelinit të zi, estragonit, trumzës, sallatës, sallatës së athët, barit të etheve, ciklaminit, gjembit të zi, murrizit, koprës së egër, koprës së butë, kungullit, lajthisë etj.

Xhabir ibn Abdullahu ka transmetuar se profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “Për çdo sëmundje ka ilaç. Kur ilaçi e godet sëmundjen, shërohet me lejen e Allahut.” (Muslimi)

Borziloku (familja buzore)

Borziloku përdoret për lehtësimin e dhimbjeve, për shërimin e marramendjes, për shërimin e migrenës, për rikthimin e kujtesës. Ai përdoret edhe për shërimin e sëmundjeve infektive e inflamatore. Borziloku ndihmon për indet e buta të gojës e sidomos për mjekimin e aftës (mahisja e gojës me fluska që pasohen me plasaritje sipërfaqësore) dhe për heqjen e erës së keqe të gojës. Ai përdoret në formë përvëlesë për shërimin e dhimbjeve të stomakut, për qetësimin e sistemit nervor, për lehtësimin e urinimit, për astmën, për mahisjen e veshkave, për hapjen e oreksit etj.



Bushi

Bushi përmban alkaloide, buksinë, esencë tanine dhe alkaloide me veti hipotensive.

Bushi ka veti të ulë temperaturën që vjen nga mahisjet e rrugëve urinare dhe të tëmthit. Ai ndikon për uljen e tensionit të gjakut. Në përdorimin e jashtëm, vlen për sëmundjet e lëkurës në podogër (lloj sëmundjeje lëkure), për reumatizmin dhe për dezinfektimin e lëkurës.

Sumullbari

Kjo bimë përmban lupulinë. Lupulina përmban vaj esencial, fenol, lëndë rrëshinore, lëndë regjëse dhe vitaminë C. Bima në përmbajtje së lupulinës ose lupulonit ka veti të qetësojë sistemin nervor, të lehtësojë gjendjen e padëshirueshme gjatë tensionit e pagjumësisë. Sumullbari ka veti të hapë oreksin dhe të shtojë urinimin; ndihmon në tretjen e ushqimit dhe në lehtësimin e problemeve të prostatës.

Vjeshtulla e bardhë

Kjo bimë përmban proteina, celulozë, inozit, uran dhe rrëshirë. Në rrëshirë ndodhet lëndë ngjitëse që përbëhet nga viskina, acidi viskinik dhe viskikuacina. Ajo përmban yndyra, alkaloide, viskotoksinë, kolinë, acetil kolinë dhe acid aleonik. Vjeshtulla e bardhë përdoret për uljen e presionit të gjakut, për qetësimin kardiak gjatë çrregullimeve nervore, për hipertensionin arterial nga arteria skleroze, për pakësimin e kolesterolit në gjak, për përmirësimin e albuminës, për nxitjen e urinimit dhe për jashtëqitjen e uresë. Po ashtu, ndikon në zgjerimin e venave të gjakut, në qetësimin e sistemit nervor dhe kundër epilepsisë.



Parietarja mjekësore ose karafilegjeni

Kjo bimë përmban nitrat kaliumi, lëndë regjëse dhe lëndë të hidhura. Këshillohet si diuretik për gurë dhe rërë në veshka dhe në fshikëzën urinare. Përdoret për lyerjen e plagëve të plasaritura dhe kundër astmës.

Pelini

Pelini përmban substanca të hidhura, esencë, vaj esencial me ngjyrë blu dhe të gjelbër, glukozide të hidhura, absintinë dhe anabsintinë. Në gjethe përmban vitaminë C, B6, A. Vaji esencial përbëhet nga ketani, tujoni dhe helmet. Esenca e pelinit përmban azulen të ngjashme me kamazulenin e lules së kamomilit. Ky përdoret për të shtuar oreksin, kundër kolikave, sëmundjeve të stomakut, për vështirësi në tretje, në uljen e acidit klorhidrik të lëngut gastrit, në çrregullimet e mëlçisë së zezë dhe të tëmthit, në dhimbjet e barkut, në sëmundjet e mushkërive (në pleurit dhe në malarje).

Pelini i zi

Kjo bimë përmban vaj esencial, lëndë të hidhura, vitaminë A, B1, B2, C, adenine dhe kolinë. Në gjethe ka gjurmë alkaloidesh, lëndë të hidhura, vitaminë C, A, B1, B2. Kjo bimë përmban esencë me cineal dhe tujon. Në mjekësinë popullore përdoret kundër anemisë, dobësimit të sistemit nervor, epilepsisë, malarjes. Ajo përdoret edhe për shpejtimin e tretjes së ushqimit, për rregullimin e ciklit menstrual dhe për mbytjen e insekteve (insekticid).

Estragoni

Kjo bimë shërben për tretjen e ushqimeve dhe për nxitjen e oreksit. Esenca e estragonit përdoret si kundërhelm nga kafshimi i



i gjarprit, ndërsa në Francë përgatitet një uthull e mirë aromatike që përmban emrin e estragonit.

Trumza ose shtërmëni

Kjo bimë përmban esencë me karvakol e cimol, taninë, fenol dhe terpen. Përdoret për nxitjen e tretjes së ushqimeve, largimin e gazrave nga zorrët, për nxjerrjen e gëlbasës, kundër heqjes së barkut, kundër dizanterisë dhe majasëllit. Lëngu i gjetheve përdoret në rastet e pickimit nga bletët. Po ashtu, përdoret për erëza në kuzhinë. Në Gjermani quhet “erëza e fasuleve“, sepse fasulet nuk i shërbejnë asnjëherë pa trumzë. Në Angli quhet “Savori“, që do të thotë e *shijshme* dhe përdoret shumë në sallatë.

Sallata

Sallata përmban një lëng qumështor me shije të hidhur që ka shenja të hiosciaminës, fenol dhe mangan. Sallata e njomë përdoret për neurozat e zemrës, për lëkundjet e presionit të gjakut, për çrregullime të humorit dhe të gjumit nga kolla e fortë dhe e bardhë. Ajo përdoret për diabetikët sepse ul sheqerin në gjak. Lëngu qumështor përdoret për të qetësuar dhimbjet e stomakut nga spazmat. Ndërsa çaji i përftuar nga zierja e farave të sallatës, këshillohet për gratë me fëmijë në gj, për të shtuar qumështin. Ai përdoret për shplarjen e syve në rastet e inflamacionit të mbulesës së mukozës.

Për shërimin e veshkave dhe të disa sëmundjeve kanceroze merren në sasi të barabarta: marule (farë sallate), karrota, spinaq dhe selino dhe shtrydhen në mikser. Lëngu i përftuar pihet nga 1 lugë gjelle, 3 herë në ditë.



Sallata e athët

Sallata e athët është erëz kuzhine, e cila ka gjetur përdorim të gjerë në Europë. Ajo përdoret e shoqëruar me vaj ulliri dhe kripë për shkak të shijes së athët. Disa receta janë: salmon i shoqëruar me sallatë të athët, eskallap i shoqëruar me sallatë të athët, supë e athët. Këto receta shërbejnë për tretjen e ushqimeve, për dhembjet e barkut dhe për ngërçet në stomak.

Kinëfusha ose bari i etheve

Kjo bimë përmban heterozide të hidhura. Bari i etheve përdoret për të shtuar lëngun e stomakut, për të përmirësuar oreksin dhe tretjen, për të zgjeruar enët e gjakut të stomakut, për shtim të leukocideve dhe për rritjen e aftësisë vetëmbrojtëse të organizmit. Po ashtu, këshillohet për sëmundjet e mëlçisë, për pakësimin e sekretimit të tëmthit dhe në sëmundjen e sheqerit.

Koriandri

Frutat e koriandrit përmbajnë esencë të pasur me linalol, që ka veti antibiotike. Koriandri këshillohet për nxitjen e prodhimit të tëmthit nga qelizat e mëlçisë, shpejton zbrazjen e tëmthit dhe shton bilirubinën në gjak. Ai përdoret në veprimin e mbaresave nervore të gojës, në aparatën gjëndrorë të mukozës së stomakut tek të sëmurët me gastrit dhe tek personat që vuajnë nga mungesa e oreksit, në përmirësimin e tretjes së ushqimit. Po ashtu, ai përdoret nga personat që vuajnë nga kapsllëku dhe majasëlli. Koriandri lufton krimbat e zorrëve (antihelmintik) dhe krimbat në rrugët e frymëmarrjes. Esenca e tij ka përdorim të gjerë në fushën e kozmetikës dhe të farmaceutikës. Koriandri përdoret si erëz në gjithë Europën, sidomos në kuzhinën franceze.



Ciklamini

Zhardhoku i ciklaminit është i ngjashëm me zhardhokun e patates. Siç e dimë, lëngu i shtrydhur dhe i freskët i patates përdoret për kurimin e sëmundjes së kancerit, domethënë për sëmundjet e brendshme. Zhardhoku i grirë ose i shtypur përdoret për mjekimin e jashtëm të sëmundjes kanceroze. Pra, merret zhardhoku i ciklaminit i grirë ose i shtypur mirë dhe imët dhe vendoset mbi plagë. Zhardhoku i saj përmban amidon, gomë, pektinë, arthonatinë. Arthonatina ka efekte të ngjashme me sapaninën: është bimë helmuese për peshqit dhe për njerëzit.

Gjembi i zi, murrizi

Kjo bimë është shpëtimtare për sëmundjen e mishrave të dhëmbëve dhe mishrave të gojës nga brenda. Për këtë, duhet të shtypen 1-2 grushta rrënjë dhe pastaj duhet të valojnë në ujë. Shtohet një copë e vogël shtipëz. Kur solucioni ftohet, bëhet shpërlarja e gojës, fillimisht 3 herë në ditë, e më pas, 2 herë në ditë.

Kopra e egër ose maroja

Frutat përmbajnë vaj esencial, anetol, fenhon, lëndë të hidhura, kamfor, alfa-pinen kamfen, alfa-felandrinë, dipenten, pcinol, acid anisik, aldehid anisik, sheqer, albuminë, amidon.

Në mjekësi përdoret kundër dhimbjeve të stomakut, të zorrëve, të veshkave, të fshikëzës urinare. Ajo përdoret kundër rërës në veshka dhe në fshikëzën urinare, kundër kollës. Po ashtu, përdoret për shtimin e qumështit tek nënat që ushqejnë fëmijë me gjë, si dhe për shtimin e hormoneve seksuale femërore. Përvëlesa e frutit të koprës përdoret për mjekimin e mëlçisë, për zbrazjen e rrugëve të tëmthit, për ndalimin e dhimbjeve të barkut te fëmijët, për shërimin e pagjumësisë etj.



Kopra e butë

Kopra përmban vaj esencial dhe proteina. Ajo përdoret si qetësues nervor. Në Greqinë e lashtë e quanin bari i Diskoridit dhe mjekët e asaj kohe e rekomandonin koprën për çdo lloj sëmundjeje. Ata e kanë përdorur edhe për të ndaluar krizat e epilepsisë. Kopra nxit jashtëqitjen tek fëmijët e vegjël në rast koliti, prerje barku etj. Ajo është përdorur për mjekimin e veshkave dhe të rrugëve urinare, si në heqjen e gurëve në veshka dhe në fshikëzën urinare.

Kungulli

Në farat e kungullit ka: fitosterinë, kukurbital, kukumarinë, lecitinë, sheqerna, proteina, keratinë. Kungulli përdoret për të përmirësuar veprimtarinë e aparatit tretës dhe të mëlçisë, për nxitjen e sekrecionit të tëmthit, në sëmundjet e zemrës dhe të veshkave që shoqërohen me enjtje. Farat e kungullit të ziera me qumësht përdoren kundër parazitëve në zorrë, shiritëve, askarideve, oksiuñëve, sidomos te fëmijët e vegjël. Lëngu i freskët i kungullit përdoret kundër pagjumësisë që vjen nga shqetësimet nervore. Kungulli përdoret edhe për lyerje të plagëve të shkaktuara nga djegiet nga rrezet e diellit.

Lajthia

Lajthia përmban proteina, yndyrna, celulozë, lëndë estraktive jo azotike, keratinë, vitaminë C, taninë, rrëshirë, acide, pigmente flavonike, vaj esencial, lëndë regjëse, albuminë dhe sheqerna. Mielli i lajthisë përmban kripëra minerale dhe vitaminë A, B1, B5, C, PP. Lajthia këshillohet për anoreksi. Gjethja e lajthisë, në formë përvëlese, përdoret kundër dhimbjeve dhe infeksioneve të zorrëve dhe kundër diareisë. Vaji i nxjerrë nga farat e saj përdoret për mjekimin e djegjeve lokale. Lëkura e lajthisë e përzier me lëkurë plepi të egër



përdoret për hipertrofinën e prostatës. Ajo këshillohet për mjekimin e rrugëve urinare, për shërimin e variçeve, për hemoroidet. Ajo ka veti të ngushtojë enët e gjakut.



VEPRIMET E ALLAHUT NUK JANË KOHËSORE¹

Abstrakt

Siç dihet, Allahu është jashtë kohës, por është Ai që e krijon kohën. Allahu nuk ka vend, por është Ai që e krijon vendin. Kurse gjithçka në këtë botë ka kohën dhe vendin. Atëherë, lidhja midis Allahut dhe gjërave që kanë kohë dhe vend, është kohësore apo jokohësore? Tashmë, është provuar se gjatësia, gjerësia dhe madhësia janë përmasa të qenies lëndore. Kështu është edhe koha. Ajo është një tjetër përmasë. Çdo gjë ka kohën e saj të veçantë, siç ka gjatësinë, gjerësinë dhe madhësinë e saj të veçantë.

Siç dihet, Allahu është jashtë kohës, por është Ai që e krijon kohën. Allahu nuk ka vend, por është Ai që e krijon vendin. Kurse gjithçka në këtë botë ka kohën dhe vendin. Atëherë, lidhja midis Allahut dhe gjërave që kanë kohë dhe vend, është kohësore apo jokohësore?

Folja pa kohë

Si në çdo gjuhë tjetër, edhe në gjuhën tonë janë tri kohë gramatikore kryesore: e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja. Atëherë, kur duam të flasim për diçka që nuk lidhet me kohën, çfarë folje duhet të përdorim?

Njerëzit e letrave përdorin një thënie të vlefshme në këtë rast. Ata thonë se foljet që kanë të bëjnë me Allahun, nuk kanë kohë.

¹Titulli është i redaksisë. E përktheu nga gjuha angleze H. Shehu.



Për shembull, në Kur'an thuhet **"...dhe Allahu është i Gjithëditur, i Urtë."**² Ata thonë se kjo **"është"** nuk ka kohë. Ata që e njohin sintaksën dhe gramatikën e arabishtes, e dinë se kjo fjalë (folja) shënon pikërisht këtë, domethënë, kohë. Por, pikërisht në këtë rast ajo është pa kohë.

Nuk ka kohë kur flitet për veprimet e Allahut. Kur themi se kjo folje nuk ka kohë, do të thotë se kemi të bëjmë me kohë të shkuar gramatikore minus kohën e saj të shkuar. Ajo që shihet këtu, është lidhja me subjektin, pa marrë parasysh kohën, sepse Ai (Allahu) nuk ka vend, sepse Krijuesi nuk është kohësor. Rrjedhimisht, edhe marrëdhënia nuk është kohësore. Por, kur Allahu krijon një qenie kohësore, ajo krijohet me kufizime kohore; ndërkohë, për Allahun, i Cili është jokohësor dhe përfshin të gjitha kohët, marrëdhëniet e Tij me të shkuarën, të tashmen dhe të ardhshmen janë të njëjlojta. Ai nuk është subjekt i asnjë kohe. Ai i përfshin të gjitha kohët.

Nëse duam ta vëmë një folje kohësore te një folje jokohësore, atëherë, çfarë (folje) mund të përdorim? A do të shënojë ajo kohë apo jo? Kur ajo ka të bëjë me Allahun, i Cili është jokohësor, folja është, gjithashtu, jokohësore. Kur ka të bëjë me një krijesë, ajo duhet të jetë kohësore. Që ta sqarojmë pak më tej këtë, le të imagjinojmë një copë spangoje ose litari, ku njëri skaj i saj lidhet me Allahun, i Cili nuk ka kohë dhe skaji tjetër lidhet me natyrën kohësore. Duket sikur ky shembull nuk mund ta mishërojë të vërtetën; megjithatë, shërben si i tillë. Një shembull tjetër: Le të imagjinojmë një kon, baza e të cilit është në pambarimësi, kurse kulmi është vendosur në një gjë konkrete. Njeriu mund ta imagjinojë diçka të tillë. Baza, e cila është në pambarimësi, nuk ka kufi, nuk ka pikë të dallueshme dhe as kohë të dallueshme; por kulmi i konit, që lidhet me botën e kufizimeve, duhet pashmangshmërisht të mbështetet në një pikë të caktuar, ku kufijtë, koha dhe vendi shquhen. Kështu janë edhe veprimet e Allahut. Ato kanë dy skaje: Njëri lidhet me Allahun e pakufi, kurse tjetri, me krijesën, e cila ka kufi kohor dhe vendor. Njëri skaj lidhet

²Surja "Nisa": 17.



me botën e përjetësisë, të përhershmes, të pakufishmes, kurse skaji tjetër lidhet me botën e kufizimeve, të kohës dhe të vendit.

Veprimet e Allahut

Rrjedhimisht, mund të thuhet se veprimet e Allahut, që lidhen me gjëra kohësore dhe lëndore, kanë dy aspekte: Njëri, është ai që lidhet me Allahun dhe është jokohësor. Veprimi që bëhet nga Ai, nuk e ka kornizën e kohës.

Aspekti tjetër, që lidhet me këtë botë, është kohësor. Gjëja e krijuar ka të bëjë me kohën. Në të vërtetë, është abstrakt.

Atëherë, një veprim i tillë është, nga njëra anë, i pamatur kohësisht dhe joshkallëzor, kurse, nga ana tjetër, ai matet kohësisht. Përse? Sepse ai bëhet nga Allahu, i Cili është jashtë shkallëzorësisë, ngaqë shkallëzorësia është binjake e kohës. Sepse të gjitha gjërat, madje edhe ato lëndore, janë krijuar nga Allahu pa kohë. Allahu vetëm thotë: **“Bëhu!”**. Është Vullneti i Tij. Kur Allahu vendosi se duhej të kishte një botë njerëzore, kjo ndodhi menjëherë. Natyrisht, Allahu nuk ka nevojë të lëvizë për të bërë diçka. Kështu, kur Allahu dëshiron ta krijojë diçka, Atij i mjafton vetëm dëshira dhe diçkaja bëhet.

Koha si përmasë e qenies fizike

Tashmë, është provuar se gjatësia, gjerësia dhe madhësia janë përmasa të qenies lëndore. Kështu është edhe koha. Ajo është një tjetër përmasë. Çdo gjë ka kohën e saj të veçantë, siç ka gjatësinë, gjerësinë dhe madhësinë e saj të veçantë. Kjo është provuar nga *Sadrul Muta'alibini* i Shirazit (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Kjo është ndryshe nga problemi, që Albert Anjshtanji tha se e kishte zgjidhur duke e marrë kohën si përmasë të katërt. Ideja e parë është shumë më e gjërë sesa e dyta. Megjithatë, ne nuk do ta diskutojmë këtë në këtë rast. Në qoftë se ne e kemi zgjidhur që koha është përmasa e



vetë botës dhe ajo është shfaqur njëherësh me vetë shfaqjen e botës, atëherë, do ta kuptojmë se krijimi nga Allahu nuk ndodh para se të ketë kohën, meqë ende nuk kishte kohë. Me krijimin e botës u shfaq koha. Po me krijimin e botës u shfaq gjatësia, gjërësia dhe thellësia e saj. Po ta kuptojmë se koha është një përmasë tjetër e kësaj qenieje, do të vijmë në përfundimin se të krijosh diçka, do të thotë të krijosh kohën e saj, ngaqë koha nuk është diçka e ndarë nga krijesat. Pra, veprimet e Allahut nuk karakterizohen nga koha. Kur Ai krijon një gjë kohësore, krijohet edhe koha bashkë me të, sepse ajo (koha) është një nga përmasat e gjësë, ashtu si, kur bëjmë një tavolinë, njëherësh me të bëhen edhe përmasat. Përmasat nuk bëhen veçuarazi. Ku ka tavolinë, ka edhe përmasa. Kështu është edhe koha. Prandaj, meqë bota është kohësore, edhe krijimi i saj është kohësor. Por, meqë ajo është bërë nga Allahu, i Cili nuk ka kohë, edhe krijimi i saj është jokohësor. Por si? Ja, kështu: Është vetëm Allahu, Ai që kur dëshiroi ta krijonte botën, tha: “Bëhu!”. Dhe, ajo u bë.

Kur Allahu desh të krijonte gjatësinë e botës, a i duhej Atij ta shkelte këtë gjatësi? A i duhej Atij, të ishte i pranishëm në vend? Kur Atij i duhet të krijojë diçka me gjatësi ose me madhësi, a duhet të vizatojë Ai një vijë që të ecë nëpër të, siç bën një arkitekt? Sigurisht, jo. Sepse Allahu nuk ka hapësirë.

Po kështu, Allahu nuk ka nevojë ta përshkojë kohën, kur Ai krijon një krijesë kohësore, sepse Ai nuk është kurrë i njëkohshëm me kohën. As Allahu dhe as veprimi i Tij nuk kanë kohë. Por, në qoftë se veprimi lidhet me krijimin kohësor, ai do të jetë, gjithashtu, kohësor. Atëherë, asnjë nga veprimet e Allahut nuk është kohësor. **“Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t’i thotë asaj “Bëhu!” - dhe ajo bëhet.”**³ Por, çfarë urdhri? Nuk ka rëndësi se çfarë urdhri është - lëndor apo jolëndor-, kur Ai vendos ta bëjë diçka.

Disa komentues mendojnë se ky ajet ka të bëjë me diçka jolëndore. Kjo nuk pajtohet me përgjithësimin që sjell ajeti, sepse

³Surja “Jasin”: 82.



Kur'ani nuk thotë, kur Allahu dëshiron të krijojë diçka lëndore, Ai thotë: “Bëhu!”, por thotë: “Kur Ai dëshiron diçka, Ai thotë: Bëhu!” dhe ajo bëhet.” (Nënvizimi është i përkthyesit.)

Po krijimi? Të gjitha krijimet lëndore kanë përmasa kohësore dhe hapsinore. Allahu thotë se krijimi i Tokës dhe i qiejve u bë në gjashtë ditë: **“Është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë...”**⁴. Krijimi i njeriut do nëntë muaj. Por, kjo nuk do të thotë se Allahu i shoqëron këto krijime gjatë kohës së plotësimit dhe të zhvillimit. Allahu nuk është i pranishëm kur prodhohet sperma, pastaj kur bëhet droçkë e ngjizur, pastaj kur bëhet një copë mishi e përtypur, etj. Jo, Allahu nuk lëviz bashkë me kohën. Të gjitha kohët janë tek Ai.

Duke u marrë në konsideratë këto fakte, ajeti, në përgjithshmërinë e tij, është i vërtetë për të gjitha gjërat. Edhe për diçka, krijimi i së cilës kërkon miliarda vjet, Allahu thotë “Bëhu!” dhe ajo bëhet. Çdo të thotë “Bëhu!” për diçka? Do të thotë: “O ti, që je gjashtë milionë vjet, ekzisto!” Por, kjo nuk do të thotë se Allahu ka lëvizur gjatë atyre gjashtë milionë vjetëve nga një pikë në një tjetër. Një milion vjet - dritë ose një minutë e vetme nuk përbëjnë asnjë dallim për Allahun. Thënë shkurt, veprimet e Allahut janë jokohësore, sepse vetë Allahu është Jokohësor.



⁴ Surja “Hud”: 7. Në suren “Haxh”, ajeti 47 thuhet se: **“...Një ditë te Zoti yt është sa një mijë vjet sipas llogarisë suaj.”** (*Shënim i përkthyesit*)

TA NJOHIM MË TEJ KUR'ANIN

Mësime nga surja “Bekare”

(Ajetet 94 – 112)

“Thuaju: ‘Nëse Shtëpia e jetës së përtejme (Xheneti) tek Allahu është vetëm për ju e jo për njerëzit e tjerë, atëherë kërkon vdekjen, nëse ajo që thoni është e vërtetë.’”

“Por ata kurrsesi nuk e dëshirojnë vdekjen për shkak të këqijave që kanë bërë. Allahu i njeh mirë keqbërësit.”

“Dhe, vërtet, do t’i gjesh ata më lakmues për të jetuar sesa njerëzit e tjerë, madje, edhe se paganët. Secili nga ata dëshiron të jetojë njëmijë vjet; por edhe nëse jeton aq, nuk do të mund t’i ikë dënimit! Allahu i sheh punët e tyre të këqija.”

“Thuaju (o Muhamed) atyre që janë armiq të Xhebrailit, se ai e ka zbritur Kur’anin në zemrën tënde me lejen e Allahut, si vërtetues të librave të shenjtë të mëparshëm dhe si udhërrëfyes e lajm të mirë për besimtarët.”

“Kush është armik i Allahut, i melekëve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhebrailit dhe i Mikailit, ta dijë se Allahu është armik i jobesimtarëve.”

“Ne të kemi zbritur ty shpallje e shenja të qarta, të cilave vetëm njerëzit e këqij nuk duan t’u besojnë.”

“A thua çdoherë që japin ndonjë premtim, disa prej tyre e flakin tej atë? Jo, por shumica e tyre nuk besojnë.”

“Tani që atyre u erdhi një i Dërguar nga Allahu, vërtetues i



Shkrimeve që kanë me vete, një grup prej atyre, të cilëve iu dhanë Shkrimet, e hodhën pas shpine Librin e Allahut, gjoja se nuk dinin gjë për atë.”

“Dhe shkuan pas shpifjeve që bënëin djajtë kundër mbretërisë së Sulejmanit. E Sulejmani nuk ishte mohues, por djajtë ishin mohues. Ata u mësonin njerëzve magjinë dhe dijeninë që u ishte dërguar dy melekëve në Babiloni - Harutit e Marutit. Këta melekë nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: ‘Ne jemi dërguar për t’ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!’ Dhe njerëzit mësuuan nga këta të dy se si t’i ndajnë bashkëshortët. Por magjistarët nuk mund t’i bëjnë dëm askujt pa lejen e Allahut. E megjithatë, njerëzit mësojnë ato gjëra që i dëmtojnë e nuk u bëjnë dobi. Në të vërtetë, ata e dinin se ai që e përvetësonte këtë mjeshteri, nuk do të kishte kurrfarë të mirë në Jetën Tjetër. Eh, sa e keqe është ajo për të cilën shitën shpirtrat e veta! Ah, sikur ta dinin ata!”

“Sikur ata të besonin dhe të ruheshin (nga gjynahet), shpërblimi i Allahut do të ishte më i mirë. Ah, sikur ta dinin ata!”

“O besimtarë! Mos thoni: ‘Rá‘iná’, por thoni: ‘Undhurná!’ – ‘Na shiko!’ dhe dëgjoni! Për mohuesit ka dënim pikëllues.”

“Ata që mohojnë, si ithtarët e Librit, ashtu edhe paganët, nuk dëshirojnë që t’ju zbresë ndonjë e mirë nga Zoti juaj. Por Allahu ia dhuron mëshirën e Vet kujt të dojë. Allahu zotëron mirësi të madhe.”

“Për çdo varg (Kur’ani) që Ne e shfuqizojmë apo që e bëjmë të harrohet, Ne sjellim ndonjë tjetër më të mirë ose të ngjashëm me të. A nuk e di ti se Allahu është i Fuqishëm për (të bërë) çdo gjë?!”

“A nuk e di ti se vetëm Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës? Përveç Allahut, ju nuk keni tjetër mbrojtës e as ndihmës.”

“A mos doni të pyesni të Dërguarin tuaj, ashtu siç u pyet Musai



më parë? Cilido që e ndërron besimin me mohim, pa dyshim që e ka humbur rrugën e drejtë.”

“Shumë nga ithtarët e Librit, prej zilisë që kanë në vete, dëshirojnë që t’ju kthejnë nga besimi në mosbesim, tani që e vërteta është e qartë për ata. Por ju falini ata dhe lërin, derisa të arrijë urdhri i Allahut. Vërtet, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”

“Faleni namazin dhe jepeni zekatin! Çfarëdo të mire që të bëni për shpirtin tuaj, do ta gjeni tek Allahu. Në të vërtetë, Ai sheh mirë gjithçka që bëni.”

“Ata thonë: ‘Askush nuk do të hyjë në Xhenet, përveç hebrenjve ose të krishterëve’. Këto janë dëshirat e tyre boshe! Thuaju (o Muhamed): ‘Nëse është e vërtetë ajo që thoni, atëherë sillni provën tuaj!’”

“Vërtet, ata që i përulen Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.”

Nga këto ajete mësojmë:

1- Njeriu duhet të jetojë në mënyrë të tillë, që në çdo çast të jetë i gatshëm për vdekjen. Njeriu duhet të ketë zbatuar me përpikëri detyrat e tij dhe çdo mëkat ta ketë korrigjuar me pendim, në mënyrë që të mos ketë frikë nga vdekja.

2- Jeta e gjatë nuk është e rëndësishme, por e rëndësishme është jeta nën bindjen e plotë ndaj Zotit. Imam Sexhadi (Paqja qoftë mbi të!), në një lutje të tij, thotë: “O Zot, nëse jeta ime është mjet për t’u bindur dhe për të të shërbyer Ty, atëherë ma zgjat jetën dhe nëse jeta ime shërben për realizimin e qëllimeve të djallit, ma ndalo atë.”



3- Feja është një tërësi detyrash dhe të drejtash për zbatimin e të cilave është i nevojshëm besimi. Nuk mund të themi se besojmë Zotin, por këtë melek e kemi armik dhe atë profet nuk e besojmë. Besimtar i vërtetë është ai që beson tek të gjithë profetët dhe tek të gjithë melekët e Zotit.

4- Nëse shohim se shumë njerëz nuk janë të gatshëm të besojnë, nuk duhet të dyshojmë tek feja, por ta dimë se mëkati ndikon aq shumë tek shpirti i njeriut, saqë e privon atë nga aftësia për të pranuar të vërtetën.

5- Nuk mjafton vetëm dituria, por nevojitet edhe pranimi i së vërtetës. Dijetarët jehudi, në bazë të Teuratit, ishin në dijeni të Profetit të Islamit, por jo vetëm që nuk e pranuan atë, por i inkurajonin edhe të tjerët që të mos besonin tek ai.

6- Dituria nuk është gjithmonë e dobishme. Ajo është si një thikë e mprehtë, e cila nëse është në dorën e kirurgut, mund të shpëtojë jetën e të sëmurit, por nëse është në dorën e kriminelit, mund të shkaktojë vdekjen e një njeriu të shëndoshë.

7- Shejtanët synojnë të krijojnë përçarje mes gruas dhe burrit dhe në gjirin e familjeve, ndërsa melekët synojnë pajtimin dhe afrimin mes burrit dhe gruas. Edhe njerëzit janë ndarë në dy grupe. Një grup është në shërbim të shejtanëve dhe një tjetër, në shërbim të melekëve.

8- Besimi nuk mjafton i vetëm, por nevojitet edhe devotshmëri dhe kujdes në mënyrë që të mbrohet besimi nga dëmtimi dhe rreziku.

9- Armiku po ndjek me vëmendje çdo lëvizje, madje edhe fjalët tona dhe ne duhet të largohemi nga çdo lëvizje dhe fjalë që armiqtë mund t'i shfrytëzojnë kundër Islamit dhe myslimanëve.

10- Armiqtë e Islamit dëshirojnë që çdo zhvillim të jetë monopol i tyre, duke mos dashur që besimtarët të përfitojnë nga ndonjë e mirë dhe begati. Atëherë, pse ne duhet të presim mëshirën e tyre duke



patur mundësinë që t'i mbështetemi vetëm Zotit të Gjithëditur?

11- Shpallja, ndryshimi apo pezullimi i vendimeve është vetëm në dorë të Zotit dhe në bazë të nevojave të njerëzimit dhe urtësisë së Tij, Zoti merr vendime për të ndryshuar apo anuluar një ligj a rregull.

12- Disa pritje të kota që ka njeriu nga Eulijatë e Allahut krijojnë kushtet për devijim nga besimi, sepse Eulijatë nuk ndikohen nga këto kërkesa të kota dhe nuk plotësojnë këto dëshira të pabaza dhe, si rrjedhim, personi fillon të dyshojë në besimin e tij.

13- Falja dhe butësia kanë prioritet përballë agresionit në përballje me jobesimtarët dhe kjo falje nuk është shenjë e dobësisë, por krijon kushtet për tërheqjen dhe përmirësimin e tyre.

14- Ne duhet t'i ndihmojmë njerëzit edhe nëse ata nuk e kuptojnë këtë dhe nuk falënderojnë, sepse Zoti sheh gjithçka dhe veprat e mira ruhen pranë Tij. Dhe, në Ditën e Gjykimit ndahen edhe shpërblimet për këto vepra.

15- Të mos mendojmë se Xheneti është në duart e një populli apo fisi të caktuar. Të mos e mashtrojmë veten se ne jemi myslimanë dhe Xheneti u takon vetëm myslimanëve. Duhet ditur se kusht për të hyrë në Xhenet është besimi dhe veprat e mira e jo vetëm emri mysliman.

16- Qetësia e vërtetë në këtë botë dhe në Botën Tjetër mund të sigurohet vetëm nën hijen e besimit, të devotshmërisë dhe të veprave të mira. Njeriu që është dorëzuar përballë Zotit dhe vetëm Atij i mbështetet, nuk ka frikë nga askush dhe nga asgjë.

(Ajetet 113 – 127)

“Hebrenjtë thonë: ‘Të krishterët nuk kanë kurrfarë udhërrëfimi ku të mbështeten!’ Edhe të krishterët thonë: ‘Hebrenjtë nuk



kanë kurrfarë urdhërrëfimi ku të mbështeten!’ Ndërkohë, të dyja palët lexojnë të njëjtin Libër. Po kështu, edhe ata që nuk dinë, thonë të njëjtat fjalë. Allahu do t’i gjykojë kundërshtitë e tyre në Ditën e Kiametit.”

“Kush është më fajtor se ai që pengon të përmendet Emri i Allahut nëpër xhamitë e Tij dhe përpiket për shkatërrimin e tyre?! Ata nuk duhet të hyjnë në to, përveçse të frikësuar. Për ata, në këtë jetë ka poshtërim, kurse në Jetën Tjetër dënim të madh.”

“Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni është Qenia e Allahut. Vërtet, Allahu është Gjithëpërfshirës dhe i Gjithëditur.”

“Ata thonë: ‘Allahu ka bërë një fëmijë’. I Lavdishëm dhe i Lartësuar qoftë Ai! Përkundrazi, Atij i përket çdo gjë që gjendet në qiej e në Tokë dhe Atij i nënshtrohet gjithçka.”

“Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, pa shembull të mëparshëm dhe, kur vendos për diçka, vetëm thotë për të: ‘Bëhu!’ - dhe ajo bëhet.”

“Kurse të paditurit thonë: ‘Përse Allahu nuk flet me ne ose së paku, të na sillte ndonjë shenjë!’ Njësoj thonin edhe ata para tyre; zemrat e tyre i përngjajnë njëra-tjetrës! Ndërkohë, Ne ua kemi treguar qartë shenjat Tona atyre që besojnë bindshëm.”

“Njëmend, Ne të kemi dërguar ty (Muhamed) si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; ti nuk do të pyetesh për banorët e Zjarrit flakërues.”

“As hebrenjtë, as të krishterët nuk do të jenë të kënaqur me ty, derisa të pranosh besimin e tyre. Thuaju: ‘Vetëm udhërrëfimi i Allahut është i drejtë!’ E, në qoftë se pas ditorisë që të ka zbritur, ti ndjek dëshirën e atyre, atëherë askush nuk do të të ndihmonte apo mbronte nga dënimi i Allahut.”

“Ata që u kemi dhënë Librin dhe e lexojnë ashtu siç është shpallur, ata besojnë vërtet në të. Kurse ata që nuk besojnë në të, pa dyshim, janë të humbur.”



“O bijtë e Izraelit, kujtoni të mirat që ju dhashë dhe që ju ngrita mbi gjithë njerëzit e tjerë (të asaj kohe)!”

“Frikësojuni Ditës kur askush nuk do të mund të bëjë asgjë për askënd dhe, kur prej askujt, nuk do të pranohet as ndërmjetësim, as shpërblësë dhe as që do të ndihmoheni.”

“Kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa urdhërime, të cilat ai i plotësoi, Allahu i tha: ‘Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!’ – ‘Po pasardhësit e mi?’ - pyeti ai. Allahu tha: ‘Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët.’”

“Kujtoni kur Ne e bëmë Qabenë vend grumbullimi dhe sigurie për njerëzit, duke thënë ‘Bëjeni vendin e Ibrahimit si vend faljeje!’ Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: ‘Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrijnë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përulur.’”

“Kur Ibrahim i lut: ‘Zoti Im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoji me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në Jetën Tjetër!’ - Allahu tha: ‘Atë që nuk beson, për pak kohë do ta bëj që të kënaqet e pastaj do ta hedh në dënimin e zjarrit.’ Eh, sa vendbanim i keq që është ai!”

“Kur Ibrahim dhe Ismaili ngritën themelet e Qabes, u lutën: ‘O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka!’”

Nga këto ajete mësojmë:

1- Fanatizmi dhe prirja e kotë në grupe njeriun e tërheq drejt fjalëve dhe mendimeve të gabuara. Ai mendon se vetëm ai e flet të drejtën duke mohuar gjithcka tjetër.

2- Xhamitë janë baza e luftës kundër mosbesimit dhe idhujtarisë dhe për këtë arsye, armiku përpiqet të zhdukë ndërtesat dhe pamjen e jashtme të këtyre vendeve të shenjta. Duhet të përpiqemi që xhamitë të jenë aq madhështore dhe aq të mbushura me njerëz, saqë armiku



të mos mund të depërtojë në to.

3- Prindërit, edukatorët dhe përgjegjësit e xhamive, jo vetëm që nuk duhet të pengojnë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve nëpër xhamia, por duhet që vazhdimisht t'i inkurajojnë ata për t'i vizituar këto vende të shenjta.

4- Zoti nuk ka anë dhe vend të caktuar. Ngado që të kthehemi, Zoti është aty. Mirëpo, begatia e ekzistencës së Qabes është në atë, që tubimet dhe lutjet e bashkuara të besimtarëve janë më të koordinuara dhe më të unifikuara dhe ato kryhen drejt qendrës së monotezimit, Qabes.

5- Zoti nuk është njeri që të ketë nevojë për fëmijë dhe bashkëshorte. Ai është Krijuesi i njeriut, i fëmijës dhe i bashkëshortes, ashtu siç është Krijuesi i gjithësisë. Ajo që ne imagjinojmë në mendje për Zotin është krijesë e jona e jo Krijuesi Ynë.

6- Të vërtetën duhet ta pranojmë edhe sikur të na vijë nga të tjerët. Të vërtetën dhe të pavërtetën duhet ta vendosim si masë për të njohur të tjerët. Ata të jenë për ne masë për të caktuar të vërtetën a të pavërtetën.

7- Të dërguarit e Zotit kanë ardhur për të udhëzuar e këshilluar, e jo për të detyruar njerëzit që të besojnë. Kundërshtarët janë vetë përgjegjës për veprat e tyre, sepse ata me vullnet dhe me dëshirë kanë zgjedhur rrugën e gabuar.

8- Ftesa e të tjerëve drejt fesë nuk duhet të bëhet shkak për largimin nga bazat e fesë, sepse ne duhet të udhëzojmë të tjerët e jo të përbushim dëshirat e tyre.

9- Drejtësia duhet të respektohet, edhe nëse bëhet fjalë për kundërshtarët e fesë. Edhe ajetet kur'anore që flasin kundër popullit beni izraelit shfrytëzojnë fjalë si (shumica) apo (një grup), në mënyrë që



të mos shkelen të drejtat e atyre që janë të mirë në mesin e atij populli.

10- Zoti, pozitat e njerëzve i përcakton në bazë të meritave të tyre. Ngjarjet e ndryshme janë vetëm sprova nga Zoti, në mënyrë që njerëzit t'i vërtetojnë meritat dhe aftësitë e tyre për atë detyrë.

11- Imameti dhe udhëheqja e popullit është një detyrë e shenjtë, e jo një detyrë e kësaj bote. Si rrjedhim, jo çdokush mund të jetë imam i shoqërisë islame.

12- Xhamitë janë vende të shenjta të Zotit dhe për këtë duhet të gëzojnë një pozitë dhe respekt të veçantë, kurse çështjet e xhamive duhet të udhëhiqen nga njerëz të zgjedhur dhe të pastër.

13- Meka, qyteti shembullor i myslimanëve është edhe vend ibadeti, edhe qendër sigurie, sepse ibadeti i besimtarëve duhet të kryhet në qetësi dhe siguri të plotë. Feja nuk është e ndarë nga kjo botë.



KUR'ANI, MREKULLI E PËRJETSHME

Abstrakt

Kur'ani është libër mbi mendjet e njerëzve. Deri sot, askush nuk ka mundur të sjellë një libër të njëjtë si ai. Ky libër i bekuar mes të gjitha mrekullive të Profetit konsiderohet dokumenti më i fortë e më i gjallë për profetësinë e Profetit të fundit, sepse Kur'ani është mrekulli folëse, e përjetshme, mbarëbotërore dhe shpirtërore. Kur'ani sfidon çdo mohues, që mund të përpiqet të sjellë një sure të ngjashme si e atij (Kur'anit). E pamundësia e tyre për ta bërë këtë, të jetë argument i qartë për originalitetin e Shpalljes qiellore, se ajo është prej All'llahut të Madhëruar.

Ajetet 23 dhe 24 të sures “Bekare”

“Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robit tonë, atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj në vend të Allahut, nëse jeni të sinqertë.”

“Nëse nuk mundeni, dhe kurrësi nuk do të mundeni, atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët, zjarr, i cili është përgatitur për të ndëshkuar mohuesit.”



Komentimi

Kur'ani, mrekulli e përjetshme

Këto ajete përqendrohen tek mrekullia e përjetshme, Kur'ani, me qëllim që të zhduket çdo dyshim përreth mesazhit të Profetit të Islamit. Ajeti thotë: **“Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robit tonë, atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë!”**¹ Në këtë mënyrë, Kur'ani sfidon çdo mohues, që mund të përpiqet të sjellë një sure të ngjashme si e atij (Kur'anit). E pamundësia e tyre për ta bërë këtë, të jetë argument i qartë për originalitetin e Shpalljes qiellore, se ajo është prej Allahut të Madhëruar. Me qëllim që ta përforcojë më tepër këtë sfidë, Kur'ani i fton ata mohues që të mos e bëjnë vetëm këtë punë, por u thotë: **“Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj në vend të Allahut, nëse jeni të singertë.”**

Fjala *Shuheda* (dëshmues) tregon për një grup që i përkrahte ata në kundërshtimin e Revelatës së Profetit (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe fraza: **“...nëse jeni të singertë.”** ka për qëllim nxitjen e tyre për ta pranuar këtë ballafaqim. Kuptimi i frazës është: *Nëse e keni të pamundur për ta bërë këtë, atëherë ky është argument se ju jeni gënjeshtarë, prandaj ngribuni për ta vërtetuar thënien tuaj!*

Natyra e sfidës duhet që britma e saj të arrijë deri në kufijtë më të largët dhe të jetë nxitëse për armikun sa të ketë mundësi. Me fjalë të tjera, sfida duhet të ndikojë në brendësinë e njeriut, me qëllim

1 Disa komentues thonë se përemri *me atë* në fjalën “mithlihi”, bën fjalë për Profetin, njësoj si përemri në fjalën *abdina* (robi Ynë). Atëherë kuptimi i ajetit është: *Nëse dyshoni në revelatën, atëherë sillni një person të pashkolluar si Muhammedi, i cili ka mundësi që të sjellë të njëjtë si Kur'ani.* Por ky supozim është i largët, sepse në një vend tjetër të Kur'anit thuhet: **“Atëherë le të sjellin një libër të ngjashëm me të”** (Sure “Tur”, ajeti 34)

Në një vend tjetër, në suren “Junus”, ajeti 38 thuhet: **“Atëherë, sillni një sure të ngjashme.”** Ky është argument, se përemri pronor me fjalën *mithlihi* bën fjalë për Kur'anin.





që të gjitha fuqitë e veta t'i vërë për të përballuar sulmet. E kur të dështojë dhe të bindet se është i pamundur e i paaftë, atëherë do ta kuptojë se ndodhet para një dukurie hyjnore e jo njerëzore. Nga kjo pikëpamje, vazhdimi i ajetit tjetër përqendrohet në elementin ndikues, kur thotë: **“Nëse nuk mundeni, dhe kurrsesi nuk do të mundeni, atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”** Ky zjarr nuk është thjesht ndodhi e ardhshme, por është realitet: **“...dhe që është përgatitur për të ndëshkuar mohuesit.”**

Një grup komentuesish kanë thënë: *‘Gurët që përmenden në ajet janë idhujt prej guri.’* Për këtë, ata sjellin si dëshmi ajetin 98 të sures “Enbija” që thotë: **“Me të vërtetë, ju dhe idhujt që i adhuronit në vend të Allahut, do të jeni lëndë djegëse për Xhehenemin.”**

Një grup tjetër thonë: *‘Gurët që përmenden në ajet tregojnë për shkëmbinjtë fosforikë, temperaturat e të cilëve është më e lartë se e shkëmbinjve të tjerë.’*

Disa të tjerë besojnë se kuptimi i kësaj fjale është tërheqja e vëmendjes për temperaturën e lartë të Xhehenemit. Pra, temperatura e Xhehenemit dhe zjarri i tij arrin deri në atë shkallë, sa që prej tij digjen shkëmbinjtë dhe trupat e njerëzve njësoj siç digjen lëndët djegëse. Nga pamja e jashtme e ajeteve të përmendura duket se zjarri i Xhehenemit ndizet brenda trupit të njerëzve e brenda gurëve. Nuk është i vështirë kuptimi i kësaj çështjeje, nëse e dimë që shkencat moderne ka konstatuar se të gjitha trupat e ekzistencës përmbajnë në brendësi të tyre zjarr të madh. *(Me fjale të tjera, ato përmbajnë energji që është e aftë të shndërrohet në zjarr.)* Nuk mund ta krahasojmë zjarrin e Xhehenemit me zjarrin që shohim në këtë botë. Në një vend tjetër, Allahu i Madhëruar thotë: **“Ai është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut.”**²

² Sure “Humeze”, ajetet 6 dhe 7.

Kërkime

1- Përse profetët kanë nevojë për mrekulli?

Ne e dimë se posti i profetësisë është posti më i lartë që Allahu ua ka dhënë Eulijave të Tij të veçantë. Çdo post, zakonisht i jepet atij njeriu që e zë atë, fuqinë e udhëheqjes mbi trupat e individëve, me përjashtim të postit të profetësisë, sepse Profeti udhëheq mbi trupat dhe zemrat e njerëzve të shoqërisë së tij. Për këtë, posti i profetësisë është më i madhi e më i larti ndër postet e tjera. Po ashtu, njerëzit, që gënjënin duke thënë se jemi profetë, ata kanë qenë më të ulët e më të devijuarit.

Njerëzit këtu qëndrojnë para dy zgjedhjeve: ose të besojnë të gjithë në da'vetin (thirrjen) e profetësisë, ose të gjithë ta kundërshtojnë e të mos besojnë. Nëse të gjithë e pranojnë atë, atëherë mejdani i feve do të shndërrohet në rrëmujë e çrregullim. Nëse të gjithë do ta refuzojnë atë plotësisht, përfundimi do të jetë humbje. Pra, argumenti i zanafillës së profetësisë, në vetvete, kërkon që profetët të jenë të vërtetë e të pajisur me argumente për profetësinë e tyre, me qëllim që të dallohen të vërtetët nga gënjeshtarët, pra profetët duhet të jenë të pajisur me mrekulli, e cila tregon vërtetësinë e thënieve të tyre.

El mu'xhize (mrekullia), siç është e qartë nga vetë emri i saj, është vepër e jashtëzakonshme, të cilën e kryen Profeti, ndërsa të tjerët janë të paafte ta kryejnë atë.

Profeti që zotëron mrekullinë, duhet të përballet me njerëzit e tij dhe t'i lajmërojë ato se mrekullia e tij është argument për vërtetësinë e thënieve të tij.



2- Kur'ani, mrekullia e përjetshme e Profetit islam

Kur'ani është libër mbi mendjet e njerëzve. Deri sot, askush nuk ka mundur të sjellë një libër të njëjtë si ai. Ky libër i bekuar mes të gjitha mrekullive të Profetit konsiderohet dokumenti më i fortë e më i gjallë për profetësinë e Profetit të fundit, sepse Kur'ani është mrekulli folëse, e përjetshme, mbarëbotërore dhe shpirtërore.

Përsa i përket të qenit e tij mrekulli folëse, themi kështu sepse mrekullitë e profetëve të tjerë të mëparshëm nuk kanë qenë të tilla, pasi, ata kanë patur nevojë për praninë e Profetit që t'u flasë njerëzve për mrekullinë e tij e me të, të ballafaqohet me ta. Edhe mrekullitë e tjera të Profetit tonë Muhamedit (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me përjashtim të Kur'anit, kanë qenë të tilla, ndërsa Kur'ani është mrekulli folëse. Nuk ka nevojë për njohje. Ai fton vetë për veten e vet, i fton kundërshtarët për ballafaqim, i mposht ata dhe del triumfues nga mejdani i sfidimit. Ai i sfidon njerëzit sot, njësoj siç i sfidoi ata që ishin në fillim të Shpalljes. Ai është feja, mrekullia, ligji dhe dokumenti që konstaton dhe vërteton se është fjalë e Krijuesit.

Përsa i përket përjetësisë dhe mbarëbotësisë, Kur'ani i ka shkërmuar fortifikatat e kohës e të vendit dhe ka dalë mbi ta. Mrekullitë e profetëve që erdhën para Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), deri edhe disa mrekulli të tjera të Profetit, përveç Kur'anit, janë të shënuara në një pjesë të caktuar të kohës. Ato kanë ndodhur në një sipërfaqe të caktuar vendi dhe para një grupi të kufizuar njerëzish, njësoj si mrekullia e Hazreti Isait (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), kur foli në djep dhe kur ringjalli të vdekurit.

Është e qartë se ndodhitë janë të kushtëzuara me kohën dhe me vendin. Sa më shumë t'i largohemi në kohë, aq më shumë



zbehet pamja e tyre. Kjo është specifike e çështjeve kohore. Mirëpo, Kur'ani nuk ka lidhje me kohën e as me vendin. Ai na ndriçon ne sot, njësoj siç ndriçonte arabët e paditur para disa shekujve. Jo vetëm kaq, kalimi i kohës ia shtoi aftësitë njeriut në dije e në mundësi, me qëllim që ai të përfitojë më shumë prej Kur'anit se sa përfituan të parët. Ajo çka nuk është e lidhur me kohën dhe me vendin, përmban elementë të vazhdimësisë, përjetësisë e të gjerësisë së rrethit mbarëbotëror dhe të përjetshëm.

Përsa i përket, cilësisë shpirtërore që ka Kur'ani, këtë e kuptojmë kur shohim mrekullitë e profetëve të mëparshëm, shumica e të cilave ka qenë trupore, p.sh: shërimi i sëmundjeve të rënda trupore, të folurit e fëmijës në djep etj. Këto kanë pasur si qëllim pjesët e trupit. Kurse Kur'ani ka si qëllim zemrat dhe shpirtrat. Ai ka lidhje me shpirtrat dhe logjikën e njerëzve. Pra, duket qartë dallimi i kësaj mrekullie nga mrekullitë e tjera trupore.

3- Vallë, a sfidoi Kur'ani?

Kur'ani i fton njerëzit për ballafaqim në disa sure të tij:

a) Në suren “Isra”, ajeti 88: **“Thuaj: ‘Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kur’an të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin.’”**

b) Në suren “Hud”, ajetet 13 dhe 14: **“Nëse ata thonë: ‘Ai e ka trilluar atë!’ Thuaju: ‘Sillni dhjetë sure të ngjashme të trilluara dhe thirrni në ndihmë kë të mundni, përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën!’ ‘E, nëse nuk ju përgjigjen, atëherë ta dini se ai (Kur’ani), ka zbritur me dijen e Allahut dhe se s’ka zot tjetër përveç Tij. Prandaj, a jeni ju myslimanë?’”**



c) Në suren “Junus”, ajeti 38: **“Ata thonë: ‘Ai (Muhamedi) e ka trilluar atë (Kur’anin)’, thuaju: ‘Atëherë, sillni një sure të ngjashme me të dhe thirrni kë të mundni, përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën.’”**

d) Po ashtu edhe në suren “Bekare”, gjejmë ajetin 23.

Në këto ajete, Kur’ani sfidon me qartësi e forcë. Ai është argument për të vërtetën e tij. Ai nuk ka mjaftuar në ballafaqimin e tij me njerëzit që të sjellin të ngjashëm me të, por ai i nxiti ata për këtë gjë. Shprehjet e nxitjes i gjejmë në thëniet e Allahut të Madhëruar: **“nëse jeni të sinqertë”... “Sillni dhjetë sure të ngjashme të trilluara”... Thuaj: “Sillni një sure të ngjashme”... “dhe thirrni kë të mundni, përveç Allahut” ...Thuaj: “Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet...”... “nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të” ...“Ruajuni prej zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët” ...“Nëse nuk mundeni, dhe kurrsesi nuk do të mundeni...”**.

Duhet përmendur se sfida e Kur’anit nuk është e kufizuar e as e përcaktuar për një kohë apo një vend. Kjo sfidë vazhdon edhe në ditët e sotme.

4- A u soll një i njëjtë me Kur’anin?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje sqarohet nëse hedhim një vështrim mbi situatat dhe shpifjet, të cilat i përjetoi zbritja e Kur’anit dhe mbi historinë në të cilën përmenden përpjekjet për shkrimin e një libri të ngjashëm me Kur’anin.

Dihet se Revelata, si në kohën e zbritjes, ashtu edhe pas saj, është përballur me kundërshtarë të rreptë prej mushrikëve, jehudive, të krishterëve dhe dyfytyrëve. Ata përdorën çdo gjë që dispononin prej fuqisë e mashtrimit për t’u përballur me thirrjen islame. Disa munafikë, si rabini Ebu Amir, e disa të



tjerë prej munafikëve, të cilët e përkrahnin atë, komunikuan me perandorin e Romës për t'i thurur kurthe Islamit. Vepra e tyre arriti deri në ndërtimin e xhamisë “Dirar” në Medine. Si pasojë e këtij veprimi ndodhën ngjarje të habitshme, të cilat i tregon Kur’ani në suren “Teube”.

Është e natyrshme se ata armiq të rreptë prej dyfytarakësh e të tjerë, rrinin e mbikëqyrnin myslimanët dhe prisnin kohën që t'i dëmtonin ata. Nëse ata do të kishin një libër që i përgjigjet sfidave të Kur’anit, do të mblidheshin rreth tij, do ta botonin e do të organizonin ceremoni gëzimi dhe do të përpiqeshin ta ruanin atë.

Për këtë shohim se historia ka ruajtur emrat e këtyre, të cilët supozohet që ata e kundërshtuan Kur’anin, si p.sh: Abdullah bin Mukaffa, për të cilin thuhet se e ka kundërshtuar Kur’anin me librin e tij “Dariretul jetime.” Mirëpo në këtë libër, që e gjejmë të pranishëm në këto ditë, nuk shohim tregues që ai të ketë kundërshtuar Kur’anin, por nuk e dimë se përse u akuzua ibn Mukaffa me këtë libër.

El Mutenebij, Ahmed ibn Hysejn Kufij, poet, është përmendur në mesin e kundërshtarëve. Mirëpo, studimet rreth jetës së tij letrare, vërtetojnë se në të shumtën e rasteve, ai e fillonte poezinë me vargje të humbjes së shpresës për të arritur më pas në shkallën më të lartë.

Ebu A’la el Mua’rij është akuzuar po ashtu, për këtë gjë. Janë përcjellë poezi në të cilat përmendet kundërshtimi i tij për disa çështje të fesë. Por, ai asnjë ditë nuk e ka ngritur zërin e tij kundër Kur’anit. Përkundrazi, nga ai janë transmetuar fjalë e fraza në të cilat e madhështon Librin e Allahut të Lartësuar.

Ndërsa Musejlemetu Kedhab (gënjeshtar), prej banorëve të Jemenit, i është kundërvënë Kur’anit dhe ka sjellë ajete të cilat janë më afër talljes se sa të vërtetës. Prej atyre ajeteve përmendim: “Pasha mbjellësit e farës. Pasha korrësit e të korrave. Pasha grumbulluesit e grurit. Pasha bluarësit e miellit.





Pasha gatuesit e brumit. Pasha pjekësit e bukës...”³

Dy prej ekzemplarëve të ajeteve të tij janë: “O bretkosë, zgjidh, se ajo që do të zgjedhësh është më e mirë! Për ty nuk ka as vend ku të hysh e as ujë ku të notosh.”⁴

5- *Dëshmi rreth Kur'anit*

Është mirë për ne që të përcjellim fjalët e disa prej të shquarve përreth Kur'anit, në të cilët ka edhe prej atyre që e akuzuan se i janë kundërvënë Kur'anit.

1- Ebu A'la el Muarij (i akuzuar për kundërvënie ndaj Kur'anit) na thotë: “Ateisti dhe udhëzuesi janë të një mendimi se ky libër që e solli Muhamedi është libër plot me mrekulli e armiku dridhet para tij... Ai nuk është poemë me rimë...”⁵

2- Velid ibn Mugijretu el Makhzumij, i cili ishte i njohur në mesin e arabëve para Islamit dhe është quajtur “Rejhanetul Kurejsh”, një ditë dëgjoi disa ajete prej sures “Gafir”. Pastaj u kthye te kombi i tij, fisi Makhzuna dhe u tha: “Betohem në Zotin, se unë dëgjova prej Muhamedit pak më parë fjalë, që nuk janë fjalë prej njerëzve e as prej xhindeve. Në to ka ëmbëlsi e bukuri. Ato janë të larta dhe asgjë nuk është mbi to.”⁶

3- Dijetari dhe historiani britanik Karlejl thotë për Kur'anin: “Nëse i hedhim një vështrim këtij libri të shenjtë, do të shohim të vërteta të mëdha, specifikat e sekreteve të ekzistencës, të prezantuara në formë të pjekur në përmbajtjen e tij. Këto sqarojnë madhësitinë e Kur'anit. Ky dallim i madh është i veçantë për Kur'anin dhe nuk e ka asnjë libër shkencor, politik, ekonomik etj. Po, leximi i disa librave lë ndikim të thellë në mendjen e njeriut, mirëpo ky ndikim nuk mund të krahasohet me ndikimin e

3 T'xhazul Kur'an i Rafiut.

4 Përcjellë nga libri: “T'xhazul Kur'an” i Hatibit, vëll.1, f. 483.

5 Risaletul gufran, f. 263.

6 Mexhmaul Bejjan, vëll.10, sure “Mudeththir”.

Kur'anit. Nga këtu duhet të themi: Dallimet themelore të Kur'anit kanë lidhje me të vërtetat dhe ndjenjat e pastra që ndodhen në të, çështjet madhore dhe përmbajtjet e rëndësishme për të cilat nuk ka asnjë dyshim. Ky libër përmban të gjitha të mirat e duhura që i sigurojnë njeriut përsosurinë dhe lumturinë.”⁷

4- Xhon Defon Bort, autor i librit “El i'tidhar ila Muhamedi uel Kur'an” thotë: “Kur'ani është i largët prej mangësisë dhe nuk ka nevojë për ndreqje apo saktësim. Kur një njeri e lexon atë prej fillimit e deri në fund, nuk mërzitet.”⁸

Po ashtu thotë: “Nuk ka kundërshtim që Kur'ani ka zbritur me gjuhën letrare e me retorike, me dialektin Kurejshit, të cilët janë arabët më orgjinal e letrar...”⁹

5- Gureh, poeti gjerman thotë: “Lexuesi i Kur'anit në fillim ndien rëndesë në fjalët e tij, por kur vazhdon më tej, ai ndien tërheqje kah Kur'ani. Kur hyn në thellësi të tij, ai hyn në bukurinë e tij magjike.”¹⁰

Në një vend tjetër thotë: “Për shumë vjetë, priftërinjtë na larguan nga kuptimi i të vërtetave të Kur'anit të shenjtë dhe nga madhështia e Profetit Muhamed. Por, sa më shumë që ecim në rrugën e kuptimit të dijes, aq më shumë na largohen perdet e paditurisë e të nervozizmit verbues. Së afërmi, ky libër i vetëm do të tërheqë vëmendjen e botës dhe do të bëhet boshti i mendjeve njerëzore.”

Gjithashtu thotë: “Ishim kundërshtarë të Kur'anit, por ky libër na tërhoqi vëmendjet dhe na magjepsi, derisa na bëri që të gjunjëzohemi për shkak të bazave e ligjeve të mëdha shkencore që ai ka.”

6- Uil Djurant, historian i njohur thotë: “Kur'ani solli për myslimanët krenarinë, drejtësinë dhe devotshmërinë, për të cilat

7 Prej hyrjes së librit: “Tendhimat hadarijetu fi imbaratorijetil islam”.

8 I njëjti burim; f.111.

9 I njëjti burim; f. 91.

10 Nga libri i i'tidhar ila Muhamedi uel Kur'an.





nuk ka të ngjashme në asnjë vend të botës.”

7 - Mendimtari francez, Xhyle Labom, në librin “Tefsijlul ajat” thotë: “Dija në botë është përhapur nga dora e myslimanëve. Myslimanët e morën dijen nga Kur’ani, që është deti i dijeve. Ata formuan me të lumenj, uji i të cilëve ecën nëpër botë.”

8- Orientalisti britanik, Dinort, thotë: “Duhet të pohojmë se shkencat e natyrës, të astronomisë, filozofisë dhe matematika që u përhapën në Europë, janë prej mirësive të studimeve kur’anore. Ne në Europë jemi borxhlinj ndaj myslimanëve. Jo vetëm kaq, Europa është prej vendeve islame, për nga studimet kur’anore.”¹¹

9- Dr. Lora Vaksia Vaglari, profesore në universitetin e Napolit, në librin “Tekademul islam es serij”, thotë: “Libri qiellor i Islamit është ekzemplar i mrekullive. Kur’ani është libër që nuk mund të imitohet. Metoda e tij në letërsi nuk ka të ngjashme. Ndikimi që lë libri dhe metoda e tij në shpirtin e njeriut, e kanë burimin te dallimet dhe madhështia e tij. Si mund të jetë kjo mrekulli prej dorës së Muhamedit, përderisa ai ishte i pashkolluar?! Në këtë libër ne shohim thesare prej shkencave, të cilat janë më të larta se aftësitë e njerëzve më të zgjuar: se filozofët, politikanët e ligjvënësit.”¹²

11 Mu’xhizetul Halide.

12 Tekadumul Islam es Seriu, marrë nga Muhamed uel Kur’an.

FJALOR KUR'ANOR: XHINET

Xhindet janë krijesa të padukshme dhe ne njerëzit nuk mund t'i shohim ashtu siç shohim njëri-tjetrin. Këtë e kuptojmë edhe nga origjina gjuhësore e fjalës “xhin” dhe nga thëniet e Kur'anit.

Kur'ani flet për botën e xhindeve. Në Kur'an ka një sure me emrin “Xhin”.

Fjala “xhin” në Kur'an përmendet 22 herë. Fjala “el xhaan” përmendet 7 herë. Fjala “xhinnetun” përmendet 10 herë.¹

Xhindet janë krijuar nga zjarri. Këtë e dëshmon ajeti 15 i sures “Rrahman”, që thotë: “...ndërsa xhindet i krijoi prej flakës së zjarrit.”

Xhindet janë krijuar para Ademit (Paqja qoftë mbi të!), siç thuhet në ajetin 27 të sures “Hixhr”: “...kurse para tij kemi krijuar xhindet nga zjarri pa tym.”

Edhe shejtani është prej xhindeve, siç thotë edhe Kur'ani në suren “Kehf”, ajeti 50: “**Kur u thamë melekëve: ‘Përluni në sexhde para Ademit!’, ata u përlën, përveç Iblisit. Ai ishte një nga xhindet dhe nuk iu bind urdhrin të Zotit të vet...**”

Prej veçantive të xhindeve është se ata na shohin, kurse ne jo. Allahu i Madhëruar në suren “Araf”, ajeti 27 thotë: “**Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata.**” Në ajet bëhet fjalë për djallin, i cili ishte prej xhindeve...”

Xhindet jetojnë në fise, bashkësi dhe togje. Këtë e dëshmon Kur'ani në disa sure, si për shembull: “**Ditën kur Ai do t'i tubojë të gjithë, do të thotë: ‘O tog i xhindeve! Ju keni mashtruar shumë njerëz!’ - Ithtarët e tyre midis njerëzve do të thonë: ‘O Zoti ynë! Ne u**

¹ Mu'xhemul Mufehres lil elfadhil Kur'anil Kerijm/Muhamed Fuad Abdul Bakij, f. 228-229, botim i vitit 1994.



kënaqëm me njëri-tjetrin dhe arritëm në afatin tonë, të cilin na e pate caktuar Ti.”²

“O tog i xhindeve dhe i njerëzve, a nuk ju patën ardhur të dërguar nga mesi juaj, për t’ju treguar shpalljet Tona dhe për t’ju paralajmëruar takimin me këtë ditë?’ Ata do të thonë: ‘Ne dëshmojmë kundër vetes sonë’. Vërtet, jeta e kësaj bote i mashtroi ata, kështu që ata do të dëshmojnë kundër vetes se kanë qenë mohues.”³

“O tog i xhindeve dhe njerëz, nëse keni fuqi të përshkoni kufijtë e qiejve dhe të Tokës, atëherë përshkojini ato! Por nuk do të mund ta bëni këtë, përveçse me një fuqi të madhe (nga Allahu).”⁴

“Allahu do t’u thotë: ‘Hyni në zjarr me popujt - xhindet dhe njerëzit - që kanë qenë para jush’. Kurdo që një popull do të hyjë në zjarr, do të mallkojë të tjerët që kanë hyrë para tij. Dhe, kur të tubohen të gjithë atje, atëherë i fundmi i tyre do t’u thotë të parëve: ‘O Zoti ynë, këta na kanë sjellë në humbje, prandaj jepu atyre një dënim të dyfishtë zjarri!’ Allahu do t’u thotë: ‘Për secilin (nga ju) ka dënim të dyfishtë, por ju nuk e dini.’” (Sure “A’raf”, ajeti 38)

Xhindet dëgjojnë. Në Kur’an thuhet: “**Thuaj** (o Muhamed): ‘**Mua më është shpallur se disa prej xhindeve kanë dëgjuar** (Kur’anin) dhe kanë thënë: ‘Me të vërtetë, kemi dëgjuar një Kur’an të mrekullueshëm.’”⁵

Xhindet janë me ne në Tokë dhe janë një prej dy barrëve të saj. Këtë e dëshmon ajeti 31 i sures “Rahman”, i cili thotë: “**O ju dy barrët e Tokës** (njerëz dhe xhinde), së shpejti do të caktojmë gjykimin tuaj.”

Xhindet janë besimtarë dhe jobesimtarë. Ata do të japin llogari në

² Sure “En’am”, ajeti 128.

³ Sure “En’am”, ajeti 130.

⁴ Sure “Rahman”, ajeti 33.

⁵ Sure “Xhin”, ajeti 1.



Ditën e Llogarisë. Në Kur'an lexojmë: **“E midis nesh ka të mirë, por ka edhe që nuk janë të mirë; jemi ndarë në grupime të ndryshme.”**⁶

Dhe: **“Ne kemi paracaktuar për Xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit.”**⁷

Dhe: **“...Do të plotësohet Fjala e Zotit tënd: Me të vërtetë që do ta mbush Xhehenemin me xhinde dhe njerëz bashkërisht.”**⁸

Dhe: **“Ne u kishim caktuar atyre shokë të këqinj, të cilët ua zbukuronin të tashmen dhe të shkuarën e tyre e për ta u përmbush Fjala, ashtu si për popujt që kanë qenë para tyre prej xhindesh dhe njerëzish. Ata kanë qenë vërtet të humbur.”**⁹

Dhe: **“Idhujtarët kanë trilluar fafëfisni ndërmjet Zotit dhe xhindeve, kurse xhindet e dinë se ata do të sillen të gjithë para Tij.”**¹⁰

Dhe: **“Njerëz të tillë do të pësojnë fatin e kombeve të kaluara prej xhindeve dhe njerëzve, ndaj të cilëve u përmbush Fjala (e dënimit). Vërtet, ata janë përherë të humburit.”**¹¹

Allahu ka dërguar profetë për xhindet, siç thuhet në suren “En’am”, ajeti 130: **“O tog i xhindeve dhe i njerëzve, a nuk ju patën ardhur të dërguar nga mesi juaj, për t’ju treguar shpalljet Tona dhe për t’ju paralajmëruar takimin me këtë ditë?”** Ata do të thonë: **“Ne dëshmojmë kundër vetes sonë”. Vërtet, jeta e kësaj bote i mashtroi ata, kështu që ata do të dëshmojnë kundër vetes se kanë qenë mohues.”** Por Ai nuk na ka lajmëruar me detaje për këtë. Po ashtu, Ai nuk na ka lajmëruar me detaje për të

⁶ Sure “Xhin”, ajeti 11.

⁷ Sure “Araf”, ajeti 179.

⁸ Sure “Hud”, ajeti 119.

⁹ Sure “Fussilet”, ajeti 25.

¹⁰ Sure “Saffat”, ajeti 158.

¹¹ Sure “Ahkaf”, ajeti 18.



dërguarit e shumë të njerëzit. Në Kur'an lexojmë: **“Për disa të dërguar të kemi treguar më parë dhe për disa të tjerë nuk të kemi treguar ty...”**¹²

Allahu na paralajmëron që të mos lidhemi me xhindet dhe të mos u kërkojmë ndihmë atyre. Në Kur'an thuhet: **“Në të vërtetë, ka pasur njerëz që kërkonin mbrojtje nga xhindet, por kjo vetëm sa i çoi më tej në gabime.”**¹³

Mirëpo, bazuar në Kur'an, Allahu e ka përjashtuar profetin Sulejman (Paqja qoftë mbi të!), nga kjo porosi. Allahu i dha atij një mbretëri të paparë në tokë dhe në shërbim të tij vendosi djajtë dhe xhindet. Kur'ani thotë: **“...dhe tha: ‘O Zoti im, më fal dhe më dhuro një pushtet që të mos e ketë askush pas meje! Me të vërtetë, Ti je Dhurues i madh!’ Pastaj, Ne ia nënshtruam atij erën që të frynte me urdhrin e tij, andej nga të donte ai. (Gjithashtu ia nënshtruam) edhe djajtë, ndërmjet të cilëve kishte ndërtues dhe zhytës në ujë, si dhe të tjerë të lidhur në pranga. (Ne i thamë): ‘Kjo është dhurata Jonë për ty, prandaj jep lirisht ose mos jep gjë prej saj, sepse nuk do të kesh kurrfarë llogarie për këtë.’”**¹⁴

Dhe: **“Para Sulejmanit u tubua ushtria e Tij e përbërë prej xhindeve, njerëzve dhe shpendëve, të gjithë të radhitur në çeta të gatshme.”**¹⁵

Dhe: **“Njëri nga xhindet - Ifriti, tha: ‘Unë do të ta sjell ty para se të ngrihesh prej vendit; unë për këtë jam i fuqishëm dhe i sigurt’.**¹⁶ Në këto ajete duket qartë se Allahu ia nënshtroi xhindet profetit Sulejman (Paqja qoftë mbi të!).

Sipas Kur'anit, shumë njerëz i kanë adhuruar xhindet duke menduar se ato kanë afrimet me Allahun. Me këtë veprim ata iu shmangën rrugës së Allahut të Madhëruar. Në suren “Sebe”, ajeti 41 lexojmë:

¹² Sure “Nisa”, ajeti 164.

¹³ Sure “Xhin”, ajeti 6.

¹⁴ Sure “Sad”, ajetet 35-39

¹⁵ Sure “Neml”, ajeti 17.

¹⁶ Sure “Neml”, ajeti 39.



“Ata do të thonë: ‘Qofsh i lavdëruar Ti, o Zoti ynë! Ti je Mbrotësi ynë, jo ata. Ata adhuronin xhindet dhe shumica e mohuesve u besonin atyre.’” Gjithashtu, në suren “Saffat”, ajeti 158 thuhet: **“Idhujtarët kanë trilluar fafëfisni ndërmjet Zotit dhe xhindeve, kurse xhindet e dinë se ata do të sillen të gjithë para Tij.”**

Fjalët “el xhin”, “el xhaan” dhe “xhinnetun”, përveç sureve të cituara më lart, përmenden, edhe në sure të tjera.¹⁷

Vullnet Merja

¹⁷ *El xhin, el xhaan dhe xhinnetun*: 6:76, 100, 112; 128; 130; 7:38; 179, 184; 11:119; 15:27; 17:88, 18:50; 23:25, 70; 27:10, 17, 39; 28-31; 32: 13; 34:8, 12, 14, 41; 37: 157; 41:25, 29; 46:18, 29-32; 51:56, 55:15, 33, 39, 56, 74; 72:1-15; 114:6; *El Xhin*, Sure 72. (Marrë nga *Tregues i Kur'anit* i prof. dr. Hajri Shehu, germa Xh, faqja 96.)



HISTORI E PROFETËVE

Profeti Shuajb¹ (Paqja qoftë mbi të!)

Profeti Shuajb është dërguar si profet për popullësinë e Medjenit dhe Ejkeas. I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Shuajbi është vëlla në soj me medjenasit dhe është dërguar si profet për ta dhe Ejkeasit.*”

Pas shkatërrimit të këtyre dy popujve, Shuajbi është kthyer në Meke bashkë me ata që e besonin. Atje i ka ditët e fundit të jetës. Ai është varrosur në Hatim.

Shuajbi falej shumë dhe u kushtonte shumë kujdes detyrave të tij si rob i Zotit. Ai bënte ç'ishte e mundur që veglat e matjes dhe të peshimit të punonin saktë dhe që gjithkujt t'i jepej haku që i takonte. I lindur dhe i rritur në Medjen, Shuajbi i përkiste një familjeje fisnike. Rininë e kaloi mes popullit të vet, por meqë populli kishte devijuar nga udha, ai bënte një jetë të thjeshtë e të pastër, larg punëve të tyre të këqija. Me këtë jetë të thjeshtë, si dhe me këshillat që jepte, bëhej shembull dhe model për njerëzit.



¹ *Vargu i Profetëve*, Osman Nuri Topbash, Stamboll 2001, vëll. 2, f. 99-113.

Medjenasit

Medjenasit patën devijuan dhe e patën lënë bindjen dhe adhurimin ndaj Zotit. Ata adhuronin idhujt dhe statujat. Populli merrej me tregti. Ndërkaq mes tyre ishte përhapur hileja (në tregti), që ishte kthyer në mjeshteri. Në matje e peshim njerëzit anonin nga vetja, matnin e peshonin gabim, çmonin sipas interesit të tyre. Madje, në shitblerjet me shkëmbim malli, përdornin matëse e peshore të veçanta për të blerë e të veçanta për të shitur. Merreshin edhe me pirateri, ua prisnin rrugën njerëzve dhe ua rrëmbenin mallin. Sidomos vinin dorë mbi mallrat e të huajve e të të varfërve duke përdorur intriga të ndryshme. Ata nuk e njihnin vlerën e të mirave që u kishte falur Zoti e ta falënderonin, përkundrazi, tregoheshin mosmirënjohës duke kundërshtuar dhe adhuruar idhujt. Shkurt, besimi i medjenasve ishte idhujtaria; parimet e tregtisë së tyre, hileja dhe mashtrimi; profesioni më i pëlqyer, pirateria.

Në Medjen ishin hedhur poshtë të gjitha parimet e larta njerëzore. Allahu i Lartë u dërgoi atyre Shuajbin (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*). Shuajbi u dha njerëzve këshilla të mira. Ai u tregoi se kush ishin urdhrat dhe ndalimet e Zotit. U tha që të mos i bënin shok Zotit, por ta adhuronin vetëm Atë, që të mos bënin padrejtësi në matje e peshim, që të besonin në Ditën e Ringjalljes e që të mos shkaktonin ngatërresa mbi tokë. Ai ua bëri të qartë se ndëshkimi i Zotit është i vështirë, kurse të mirat dhe dhuntitë e Tij, të pafundme. Në Kur'an thuhet: **“Edhe Medjenit (i dërguam) vëllanë e tyre, Shuajbin që u tha: ‘O populli im, adhurojeni Allahun, veç të Cilit nuk ka Zot tjetër për ju! Mos matni dhe peshoni mangut! Ju po jetoni mirë, kurse unë kam frikë se një ditë do t’ju përfshijë një ndëshkim i rëndë!’”** (*Hud, 84*)

“E u tha: ‘O populli im! Adhurojeni Allahun, sepse nuk ka për ju Zot tjetër veç Tij! Juve ju ka ardhur mrekulli nga Zoti juaj, matni e peshoni drejt! Mos prishni rendin në tokë! Nëse jeni njerëz që kuptoni, këto janë më të mira për ju!’” (*A'raf, 85*)



“O populli im! Adhurojeni Allahun dhe kijeni frikë Ditën e Fundit...” (*Ankebut, 36*)

Shuajbi (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) vazhdimisht ua tërhiqte vëmendjen njerëzve që të mos matnin e të mos peshonin gabim, sipas interesit të vet. Veçanërisht i paralajmëronte se, nëse nuk do të pendoheshin dhe nuk do të hiqnin dorë nga kjo gjë, të gjitha të mirat që u qenë dhënë, do t’u merreshin prapë. Zoti i kishte dhuruar shumë të mira atij populli. Ata nuk kishin asnjë të drejtë ta kalonin kufirin në atë mënyrë.

Shuajbi (*Paqja qoftë mbi të!*) vazhdoi ta këshillonte popullin: **“O populli im! Matni dhe peshoni me drejtësi! Mos ua jepni njerëzve mallrat mangut; mos shkaktoni trazira dhe padrejtësi!”** (*Hud, 85*)

Pas kësaj, Shuajbi përcaktoi parimin e tregtisë; matje dhe peshim i saktë dhe kënaqje me fitim normal. Në fitimin normal kishte siguri pune dhe tregtie, si dhe respektim të të drejtave të robit të Zotit, gjë që do të thoshte faqe e bardhë para Tij. Shuajbi (*Paqja qoftë mbi të!*) vazhdoi me këshillat e tij: **“Nëse jeni njerëz që besoni, fitimi i lënë nga Allahu (fitimi hallall) është më i dobishëm dhe më i mbarë për ju. Unë nuk jam roje mbi ju!”** (*Hud, 86*)

Me këto fjalë ai donte t’u thoshte se ai vetë nuk mund t’i ndëshkonte ata për punët e këqija, as nuk mund të bëhej pengesë që të mirat që kishin, t’u dilnin dore për shkak të padrejtësive që kryenin dhe mosmirënjohjes ndaj Zotit. Ai vetëm u kumtonte atyre ato çka i ishin bërë të njohura.

Shuajbi i ftonte njerëzit në këto pesë çështje:

1. Besim monoteist dhe adhurim vetëm ndaj Allahut.
2. Pranim të profetësisë së tij.
3. Matje e peshim të drejtë.
4. Respektim i të gjitha të drejtave të njeriut. Braktisje e të gjitha punëve të hapura e të fshehta, si: vjedhje, grabitje, rushfet,



pirateri.

5. Të mos shkaktohen intriga dhe grindje në punët e fesë e të jetës së përditshme.

Këto pesë parime të propozuara prej Shuajbit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) shprehen në mënyrë të përmbledhur, kështu: “Respekt ndaj Zotit, dhembshuri dhe mëshirë ndaj krijesave”. Ky kriter i shprehur në këtë mënyrë, përmbledh në vetvete pranimin e monoteizmit dhe të profetëve, respektimin e të drejtave të njeriut dhe qetësinë e rendin për të gjithë.

Ftesa e Shuajbit (*Paqja qoftë mbi të!*) pati një ndikim të madh. Ajo zgjoi një interesim të madh në të gjitha mjediset. Njerëzit shkonin tek ai me grupe, i shprehnin besimin dhe i zbatonin porositë e tij. Duke adhuruar Zotin, nuk hiqnin dorë nga drejtësia në tregti. Mirëpo edhe ata që nuk besonin ishin shumë.

Mosbesuesit i zemëronte shumë kjo situatë. Atyre u dukej fitimi i paktë. Duke i thënë njëri-tjetrit se me fitimin normal askush nuk mund të pasurohet, nxitnin padrejtësinë dhe të shtrembrën. Njerëzit e harbuar i thonin profetit të tyre: **“O Shuajb! A mos namazi yt po të mëson të na thuash t’i braktisim ata që kanë adhuruar prindët tanë e të mos bëjmë si të duam me mallin tonë? Shumë i mençur e i butë na qenke!”** (*Hud, 87*)

Me fjalën namaz, këtu nënkuptohet feja, besimi.

“(Shuajbi) tha: ‘Ç’thoni nëse unë kam argumente të qarta nga Zoti im e nëse më ka pajisur me të mira? Unë nuk dua të bëj të kundërtën e atyre gjërave që po ju ndaloj, por vetëm përpiqem t’ju përmirësoj aq sa mundem, gjë që mund ta arrij vetëm me ndihmën e Allahut. Unë vetëm Atij i drejtohem dhe vetëm tek Ai mbështetem!” (*Hud, 88*)

Shuajbi vazhdonte kumtimin e tij brenda dritës së këtyre kritereve pa u lodhur. Por populli i harbuar nuk ua vuri veshin porosive dhe këshillave të tij. Me kalimin e kohës ata bëheshin më të harbuar e më të papërmbajtur. Edhe pse nuk mund t’i bënin Shuajbit vetë ndonjë të keqe pasi i përkiste një fisi më të fuqishëm,



nuk rrinin pa i kërcënuar ata që i besonin. Lidhur me këtë, Shuajbi i paralajmëroi: **“Mos zini pusi në çdo rrugë për t’i kërcënuar e penguar njerëzit nga rruga e Zotit! Pa mendoni se ju ishit të paktë e Allahu ju shumoi dhe shihni se si që fundi i ngatërrestarëve!”** (*A’raf, 86*)

Pavarësisht nga të gjitha shqetësimet, Shuajbi vazhdonte ta ftonte popullin në udhë të drejtë. Ai vepronte sipas urdhrave të fesë së drejtë të zbritur Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*). Profetësia e Shuajbit që dëgjuar gjer në Damask. Zemrat e djegura me dashurinë për Zotin, udhëtonin gjer në Medjen për ta parë atë. Kurse popullsia e Medjenit u zinin rrugën të ardhurve besimtarë për t’i penguar që të takoheshin me profetin Shuajb (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo ishte një shfaqje e hapur e bashkimit me shejtanin.

Shuajbi përpiquej t’i pengonte ata:

1. që t’u dilnin njerëzve në rrugë, t’i kërcënonin e t’i mundonin;
2. që t’i ndalonin njerëzit për t’i besuar Allahut
3. që t’i shmangnin nga udha e drejtë besimtarët dhe ata që donin të besonin, duke u shtënë në shpirt dyshime e lëkundje.

Paralajmërimet e fundit

Shuajbi (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshpërohej për sjelljet e këqija dhe kundërshtimet e popullit të tij dhe me një durim të madh, përpiquej t’i zgjonte ata nga gjumi i injorancës: **“O njerëzit e mi! Kujdes se mos armiqësia që tregoni kundër meje ju sjell edhe juve ndonjë fatkeqësi si ato që u ranë në kokë popullit të Nuhut, Hudit dhe Salihut! Edhe përvojën e popullit të Lutit nuk e keni larg.”** (*Hud, 89*)

Ai donte t’u thoshte se historia e popujve të shkuar nuk ishte fort e largët për ta, ashtu siç nuk ishin të ndryshme as të këqijat që bënin.

“Kërkoni falje nga Zoti juaj, pastaj pendohuni! Pa dyshim, Zoti im është shumë mëshirues.” (*Hud, 90*)



Politeistët nga parësia e popullit nuk i pëlqyen këto këshilla të Shuajbit: **“E thanë: ‘O Shuajb! Shumicën e atyre që thua nuk i kuptojmë dhe shohim se me të vërtetë nuk je në rregull. Po të mos ishte fisi yt, do të të kishim vrarë me gurë. Ti nuk je më i shquar se ne!’”**

“(Shuajbi) Tha: ‘O populli im! Për ju më i çmuar është fisi im apo Allahu që i keni kthyer shpinën? Pa dyshim, Zoti im i di të gjitha ato që po bëni!’” (*Hud, 91-92*)

Kur Shuajbi (*Paqja qoftë mbi të!*) e preu shpresën se ai popull i harbuar do të besonte, ia la Zotit në dorë. Nuk kishte mbetur më gjë për të bërë. Megjithatë, ua kujtoi edhe njëherë ndëshkimin e Zotit: **“Po qe se një grup prej jush beson, bashkë me mua, në atë që më është dërguar mua, e një grup nuk beson, prisni gjersa Allahu të vendosë për ju. Pa dyshim, Ai është më i Miri i Gjykatësve!”** (*A'raf, 87*)

Por medjenasit përsëri e fajësuan Shuajbin për gënjeshtar. Atë vetë, si dhe ata që i besonin atij, i kërcënuan se do t'i nxirrnin prej Medjenit. Tani e shihnin me rrezik që besimtarët t'i kishin mes tyre.

“Paria mendjemëdhenj i thanë: ‘O Shuajb! Ose ty dhe ata që besojnë bashkë me ty, do t'ju nxjerrim prej vendit ose do të ktheheni në fenë tonë!’ Shuajbi tha: ‘Edhe nëse nuk duam?’” (*A'raf, 88*)

Dhe shtoi: **“Po qe se kthehemi në fenë tuaj, nga e cila Allahu na shpëtoi, do të thotë se e përgënjeshtrojmë Allahun. Është krejt e pamundur të kthehemi ne pas, pa e dashur Zoti një gjë të tillë. Dija e Tij përfshin gjithçka! Ne vetëm tek Ai mbështetemi! Zoti ynë! Vendos me drejtësi mes nesh dhe njerëzve tanë! Ti je më i dobishmi i gjykatësve!”** (*A'raf, 89*)

Ky qëndrim i Shuajbit është shprehje e dorëzimit dhe e nënshtrimit ndaj vullnetit të Zotit pa e diskutuar as llojin dhe as zbatimin e atij vullneti. Të gjithë profetët dhe të urtët vazhdimisht janë frikësuar e frikësohen prej ndëshkimit të Allahut.



Pavarësisht nga çdo gjë, njerëzit e ulët nuk urtësoheshin, nuk mundeshin ta pranonin jo vetëm Shuajbin, por as edhe ata që e besonin atë. I dënonin ata dhe vazhdimisht i kërcënonin.

“Heretikët nga parësia e popullit u thanë: ‘Nëse bëni siç thotë Shuajbi, pa dyshim që do të dëmtoheni...’” (*A'raf, 90*)

Uturima e ardhur nga lart

Pasi nuk kishte mbetur më gjë për të bërë për ata njerëz të dalë përfundimisht nga udha e drejtë, Shuajbi tha: **“O populli im! Bëni çfarë të doni! Edhe unë do të bëj. Shumë shpejt keni për t’a parë se për kë ka për të ardhur ndëshkimi dhe se kush është gënjeshtar. Prisni! Edhe unë do të pres bashkë me ju.”**

“Kur nisi të zbatohej urdhri Ynë, Shuajbin dhe besimtarët i shpëtuan me një mëshirë nga ana Jonë, kurse mohuesit i rrëmbeu një uturimë dhe mbetën nën gërmadhat e shtëpive të tyre!” (*Hud, 93-94*)

“Ndërkaq, ata i zuri një tërmet i fuqishëm dhe mbetën ashtu, nën gërmadhat e shtëpive të tyre...” (*A'raf, 91*)

“Ata që e përgënjeshtroan Shuajbin, ishin sikur nuk kishin jetuar fare në shtëpitë e tyre. Ata që pësuan disfatë, ishin pikërisht ata që e patën quajtur Shuajbin gënjeshtar!” (*A'raf, 92*)

E kështu, njerëzit e Medjenit morën ndëshkimin e punëve të tyre të shëmtuara, e kundërshtimit ndaj Allahut dhe profetit të tyre. Ky ndëshkim ishte fundi i pashmangshëm i të padrejtëve dhe i mizorëve. Për ta nuk kishte keqardhje.

“Shuajbi u kthye e tha: ‘O populli im! Unë ju kumtova porositë e Zotit tim e ju këshillova. Eh, sa keq më vjen për një popull që nuk e besoi!’” (*A'raf, 93*)

“(E gdhinë) Si të mos kishin banuar fare aty. Qoftë i shkatërruar Medjeni, ashtu siç qe shkatërruar edhe Themudi!” (*Hud, 95*)

Edhe populli i Shuajbit u shkatërrua me një uturimë



dhe tronditje të menjëhershme, sikurse populli i Themudit. Kjo ngjashmëri në ndëshkim tregon për ngjashmërinë e atyre dy popujve në rrugën e keqe. Përsëri që të dy popujt patën mbetur njëlloj të privuar prej mëshirës së Zotit, pra edhe patën marrë të njëjtin ndëshkim.

Populli Themud qe shkatërruar me një uturimë dhe tronditje të ardhur nga poshtë, kurse populli i Medjenit, me një uturimë dhe tronditje të ardhur nga lart. Kështu, ata, të privuar prej mëshirës së Zotit, pësuan disfatën e të dy botëve.

Ejkeasit

Ejke do të thotë pyll i dendur. Si shtrirje gjeografike, ky vend ndodhet mes bregut të Detit të kuq dhe Medjenit. Banorët janë quajtur ejkeas.

Shuajbi qe ngarkuar edhe me detyrën për t'u treguar rrugën e drejtë ejkeasve që jetonin mes të gjitha të mirave, por që ishin shkëputur prej besimit monoteist dhe prej rrugës së drejtë.

Edhe ejkeasit e quajtën Shuajbin gënjeshtar. Allahu i Lartësuar thotë: **“Edhe populli i Ejkeas e fajësuan profetin e tyre si gënjeshtar...”** (*Shu'ara*, 176)

“Edhe populli i Ejkeas qenë me të vërtetë të padrejtë e mizorë...” (*Hixbr*, 78)

“Shuajbi u pati thënë kështu atyre: ‘A nuk po keni frikë (që kundërshtoni Allahun)?’”

“Ta dini se unë jam një i dërguar i besueshëm për tek ju...”

“Frikësohuni, më në fund, nga kundërshtimi i Allahut dhe bindmuni mua!”

“Unë nuk kërkoj asnjë pagesë prej jush për këtë gjë. Është vetëm Zoti i botëve Ai që ka për të ma dhënë mua shpërblimin tim!” (*Shu'ara*, 177-180)

Të dërguarit e Allahut dilnin para njerëzve me dy attribute:



1. Ata nuk kërkonin asnjë lloj pagese apo shpërblimi dhe ua bënë të ditur njerëzve se shpërblimi i tyre është vetëm në dorë të Allahut.

2. Ata përbënë një model virtyti për të gjithë njerëzit. Mes fjalëve dhe veprimeve të tyre kishte një përputhje të plotë.

Mbi rëndësinë e këtyre dytributeve tërhiqet vëmendja edhe në suren **“Jasin”**. Atje tregohet se, në një rast, kur përfaqësuesit e fshatarëve pyetën se ç’kërkonin të dërguarit prej tyre, u përgjigjën se ata nuk u kërkonin asgjë veçse të hynin në udhën e drejtë.

Profeti Shuajb vazhdoi t’i këshillonte ejkeasit: **“Matni mirë dhe mos jepni mangut!”**

“Peshoni me peshore të sakta!”

“Mos i cënoni gjërat që janë haku i të tjerëve! Mos krijoni ngatërresa dhe rrëmujë!”

“Dhe kijeni frikë Allahun që ju ka krijuar ju dhe paraardhësit tuaj!”

“Ata thanë: ‘Ti s’je veçse një i magjepsur.’”

“Ti je vetëm një njeri i zakonshëm si ne. Dije se ne të quajmë gënjeshtar.”

“Po që se je ndër ata që thonë të drejtën, na hidh nga qielli një ndëshkim!” (*Shu’ara, 181-187*)

Ndëshkimi i rënë nga qielli

Si përgjigje ndaj kërkesës së guximshme të popullit për ndëshkim, Shuajbi u tha: **“Zoti e di se ç’bëni.”** (*Shu’ara, 188*)

Ai iu lut Zotit që t’u dërgonte ndëshkimin që e kërkonin.

Atëherë, papritmas nisën të frynin erëra të nxehta. Tufa mizash ngjyrë blu iu hodhën njerëzve nga sipër. Heretikët s’dinin ç’të bënë. Nxehtësia sa vinte e shtohej. Njerëzit vrapuan në vendet me ujë, pyje e hije. Por nxehtësia shtohej nga dita në ditë.

Në këtë mes, Xhebraili (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) solli një re duke e



mbajtur jashtë qytetit. Me ta parë renë, mohuesit pandehën se kishte një hije të freskët dhe vrapuan që të gjithë nën të. Kur u mbledhën të gjithë, u erdhi një zë: “O ejkeas! Shijojeni, pra, ndëshkimin, që duke e quajtur gënjeshtar profetin tuaj, pandehët se nuk ju vjen! Vendoseni ballin në tokë dhe u thoni idhujve tuaj t’ju shpëtojnë nëse kanë fuqi!”

Dhe mbi mohuesit dhe heretikët nisën të binin shkëndija dhe zjarr nga reja. Çdo gjë e tyre u dogj: edhe gurët e drurët, madje.

“E quajten Shuajbin gënjeshtar, pra i zuri ndëshkimi i resë së asaj dite. Me të vërtetë, ai ishte ndëshkimi i një Dite të madhe!”

“Pa dyshim, këtu ka një mësim të madh. Mirëpo shumica nuk besojnë...”

“Pa dyshim, Zoti yt është Triumfuesi absolut dhe Mëshiruesi i madh!” (*Shu’ara, 189-191*)

Nga popujt tek të cilët qe dërguar si profet Shuajbi, medjenasit u shkatërruan me uturimë dhe tërmet, kurse ejkeasit, me zjarrin e rënë nga reja që e kujtuan për hije.

Pas shkatërrimit

Pas shkatërrimit të popujve të ulët, Shuajbi u vendos në Medjen. U martua dhe pati dy vajza.

Shuajbi ishte një profet që derdhte shumë lot nga frika e Allahut. Kur u plak, sytë iu dobësuan. Edhe trupit iu pre fuqia.

Mes profetëve, Shuajbi quhej “Oratori i profetëve” (Hatibul Enbija), ngaqë i fliste bukur popullit dhe jepte përgjigje të qëlluara.

Një veçori tjetër e tij qe edhe qarja e shumtë. Disa herë ai qau gjer në humbjen e syve. Më në fund, Zoti ia ktheu sytë dhe e pyeti: “O Shuajb! Ç’është kjo e qarë? Prej dëshirës për Xhenetin, apo prej frikës nga Xhehenemi?”

Dhe Shuajbi iu përgjigj: “O Zot! Ti e di se as nga dëshira për Xhenetin e as nga frika për Xhehenemin. Në zemrën time ka zënë vend dashuria për Ty! Kam edhe një frikë: s’e di, a do mund të ta shoh bukurinë...”



Po t'ia arrij kësaj, s'më dubet asgjë tjetër më."

Dhe Zoti iu përgjigj: *"Meqë je besnik, të qoftë i bekuar shikimi Im, o Shuajb! Me këtë rast, bashkëbiseduesin tim, Musa bin Imranin, po ta jap si shërbyes."*

Ja, kjo është situata e të afërmeve të Zotit! Ata e kanë menduar pëlqimin e Zotit para së gjithash, kurse pëlqimin e njerëzve e kanë lënë për më pas. Meqë dashuria hyjnore ua ka rrethuar zemrat, kanë mundur të hedhin vështirimin në të dy botët.

Allahu i Lartësuar i ka dërguar profetët (Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!) për t'ua hapur njerëzve sytë e zemrës, duke ua larguar indiferentizmin, për t'u bërë pretekst për bashkimin e njerëzve me Zotin përmes moralit të bukur dhe adhurimit.

Ata që janë të aftë për t'u hapur sytë e zemrës, e kërkojnë me dëshirë orientimin dhe edukimin dhe bëjnë përpjekje për të përparuar në udhën e Zotit. Por ata që nuk e dëshirojnë një gjë të tillë, që kundërshtojnë dhe tregohen mendjemëdhenj, ata që nuk ua vënë veshin paralajmërimeve të profetëve dhe që nuk duan të ngjiten në nivelin e kuptimit të së vërtetës evidente, mbeten në errësirë dhe shtrembërohen, bien në situata të mjera, pa ndonjë ndryshim prej situatës së të verbrit që nuk di nga të shkojë. Prandaj në suren "Araf", në ajetin 93 shprehet keqardhja e Shuajbit (*Paqja qoftë mbi të!*) në këtë mënyrë: **"...Eh sa keq më vjen për një popull që nuk besoi!"**



BIBLIOGRAFI E REVISTËS “DRITA E KUR’ANIT”, 2014

2014/1

1. *Koncepti i dashburisë për Zotin*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 9-15.
2. **Umm Abdur Rahman Hirschfelder**: *Të drejtat e Profetit Muhamed*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 15-26.
3. **Abdu Daim Al Kahiil**: *Argumente Shkencore nga Kur’ani IV*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 26-41.
4. **Vullnet Merja**: *Çështje të moralit sipas Kur’anit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 41-49.
5. **Xhemal Balla**: *Personaliteti i njeriut në dritën e Kur’anit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 49-55.
6. **Hajri Shehu**: *Rreth betimeve sipas Kur’anit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 55-65.
7. **Hajri Mandri**: *Estetika e ligjërit në Kur’an*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 65-77.
8. **Sherif Ahmeti**: *Koment i sures “El-Gashije”*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 77-80.
9. **Ali Muhamed Ali Duhajjil Dehili**: *Profeti Hud*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 80-87.
10. **Qani Banaj**: *Për çdo sëmundje ka ilaç: Mjalti*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 87-94.
11. **Hoxha Tahsin**: *Sekretet e ujit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 94-101.
12. **Vullnet Merja**: *Iblisi*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 101-105.
13. **Liseda Ramaj**: *Bibliografi e revistës “Drita e Kur’anit”, 2013*, “Drita e Kur’anit”, nr. 1/2014, f. 105-110.



2014/2

1. **Aisha Hamdan:** *Koncepti për Zotin*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f. 10-17.
2. **Murad Eilfried Hofman:** *Ta duash Zotin sipas Islamit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f. 17-21.
3. **Mansur Ebu Sharia Al’abadi:** *Shkëmbi nga i cili doli deveja*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f. 21-27.
4. **Vullnet Merja:** *Çështje të moralit sipas Kur’anit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f.27-38.
5. **Abdu Daim Kahiil:** *Argumente Shkencore nga Kur’ani V*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f.38-50.
6. **Qani Banaj:** *Për çdo sëmundje ka ilaç*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f. 50-56.
7. **Vullnet Merja:** *Programi i agjëruetit sipas hytbes së Profetit Muhamed*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f.56-67.
8. **Vivian Bint Vondal Tejlör:** *Mirëqenia shpirtërore dhe fizike gjatë agjërimit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f.67-72.
9. **Shakeel Ahmed:** *Inteligjenca emocionale dhe myslimanët*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f. 72-78.
10. *Surja Muhammed*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f.78-86.
11. **Ali Muhamed Ali Duhajjil – Dehili:** *Profeti Jusuf*, “Drita e Kur’anit”, nr. 2/2014, f. 86-111.

2014/3

1. **Sheikh Faisal Al – Baadani:** *Profeti dhe Haxhi*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f.10-26.
2. **Fatme Chehab:** *Haxhi, detyrë e caktuar nga Allahu*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f.26-31.
3. **Abdu Daim Kahiil:** *Një vizion i ri për kohën*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f. 31-50.
4. **Seid Abul A’la Maududi:** *Jeta pas vdekjes: Provë racionale*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f. 50-54.



5. **Qani Banaj:** *Për çdo sëmundje ka ilaç*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f.50-61.
6. **Muxhtaba Musavi Lari:** *Treguesit shkencorë të Ringjalljes*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f.61-70.
7. **Vullnet Merja:** *Duaja në Kur’an*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f. 70-80.
8. **Haxhi Selim Stafa:** *Singeriteti sipas Kur’anit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f.80-89.
9. **Mahmood A. Madani:** *Mesazhi Islam, mesazh i paqes dhe i sigurisë për të gjithë*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f.89-95.
10. **Ali Muhamed Ali Duhajjil – Dehili:** *Profeti Jakub*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f.95-100.
11. **Vullnet Merja:** *Es Siraat (Rruga)*, “Drita e Kur’anit”, nr. 3/2014, f. 100-107.

2014/4

1. **Aisha Hamdan:** *Koncepti për Zotin*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.10-17.
2. **Aliaa Ibrahim Dakroury:** *Një qasje filozofike për hermeneutikën e Kur’anit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.17-28.
3. **Rajmonda Feza:** *Natyra holistike dhe shtyllat e edukimit dhe pedagogjisë profetike*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.28-32.
4. **Abdu Daim Kahiil:** *Argumente Shkencore nga Kur’ani VI*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.32-45.
5. **Qani Banaj:** *Për çdo sëmundje ka ilaç*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.45-52.
6. **Sabrie Feza:** *Ndikimet e namazit në gjendjen shëndetësore të njeriut*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.52-60.
7. **Zahra Ixhlal:** *Gra të larta në Kur’an dhe Synet*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.60-66.
8. **Hajri Shehu:** *Merjemja, gruaja më e lartë në botë*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.66-72.
9. **Fatme Chehab:** *Vlerësimi i lartë i femrës sipas Islamit*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f. 72- 80.



10. **Vullnet Merja:** *Librat e Allahut*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.80-87.
11. **Muhsin Keraeti:** *Mësime nga surja “Bekare”*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f.87-95.
12. **Ali Muhamed Ali Duhajjil – Dehili:** *Profeti Nuh*, “Drita e Kur’anit”, nr. 4/2014, f. 95-101.



AKTIVITETE KUR'ANORE

Kur'ani, ndër librat më të shitur në Francë

Pas publikimit të karikaturave fyese ndaj Pejgamberit të Islamit në Francë, Kur'ani dhe librat për Islamin janë duke u bërë librat më të shitur në Francë.

Sipas lexxpress.fr, numri i njerëzve që blejnë Kur'anin dhe libra islame në libraritë franceze është shtuar shumë ngaqë një revistë satirike franceze publikoi karikaturat e Profetit të Shenjtë të Islamit, Muhammedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Një pronar i një librerie në Paris thotë se të gjitha kopjet e Kur'anit në dyqanin e tij janë shitur. Një tjetër shitës thotë shitja e përkthimit të Kur'anit në frëngjisht është rritur tri deri katër herë në javët e fundit.

850.000 hafizë të Kur'anit në Iran

Reth 850,000 individë kanë mësuar deri tani Kur'anin përmendsh në Iran. Lideri Suprem i Revolucionit Islamik bëri thirrje për trajnimin e dhjetë milion hafizëve të Kur'anit në Iran. Organizata të ndryshme dhe organet qeveritare, duke përfshirë Organizatën e Çështjeve Fetare, të Bamirësisë dhe Ministrinë e Arsimit janë të përfshirë në zbatimin e planit në të gjithë Iranin.



Zehraja trevjeçare hafizja më e re e Kur'anit në Azerbajxhan

Zehra Hussein, e cila është vetëm tre vjeç, është duke u bërë hafizja më e re e Kur'anit në Republikën e Azerbajxhanit. Ajo ka mësuar përmendsh 37 sure të Librit të Shenjtë, Kur'anit pa pasur mësues tjetër përveç nënës së saj. Nëna e Zehras thotë se kur ishte shtatzanë, ajo lexonte Kur'anin dhe dëgjonte këndimin e Kur'anit. Që nga dita kur Zehraja ka lindur, i kam kënduar sure të vogla të Kur'anit në vend të këndimit të ninullave. Kur ishte e vogël, 1 vjeç, i kam mësuar përmendsh suret e vogla të Kur'anit, si Ihlas, Nas dhe Felek.

Kursi për hafizë të Kur'anit për shurdhmemecët zhvillohet në Oman

Shkolla e Kur'anit "Ma'adh bin Xhebel" në Oman ka organizuar një kurs për mësimin përmendsh të Kur'anit për nxënësit me aftësi të kufizuara të dëgjimit. Klasat e kursit kur'anor mbahen dy ditë në javë. Nxënësit njihen me mësimet kur'anore dhe parimet e madhështinë e Kur'anit të Shenjtë.

Seminar ndërkombëtar: Kur'ani në shoqërinë bashkëkohore

Seminari ndërkombëtar për Kur'anin në shoqërinë bashkëkohore, me temën bosht "Kur'ani -udhëzues i ymetit" është



planifikuar të mbahet në Universitetin “Sulltan Zejnel Abidin”, Terengganu, Malajzi më 10 - 11 tetor, 2015 (ditën e shtunë dhe të diel). Seminari mbahet dy herë në vit dhe organizohet nga Fakulteti i Studimeve Islame.

Në këtë seminar do të ketë tema të ndryshme në lidhje me shoqërinë bashkëkohore, si: Kur’ani, shkenca dhe teknologjia; Kur’ani, politika dhe marrëdhëniet ndërkombëtare; Kur’ani, popullsia dhe ekonomia; Kur’ani, civilizimi dhe kultura; Kur’ani, drejtësia dhe ligji; Kur’ani, doktrinat dhe mendimi; Kur’ani dhe mjekësia; Kur’ani, thirrja dhe edukimi.

Botohet një përkthim i ri i Kur’anit në gjuhën azere

Një përkthim i ri i Kur’anit të Shenjtë në gjuhën azere është botuar nga Instituti “Terxhumani Uahi”. Përkthimi është përshkruar si një veprimtari akademike, bazuar në studimet kur’anore.

Regjistrimi i këndimit të Kur’anit më i vjetër në botë

Një regjistrim i këndimit të Kur’anit, lëshuar kohët e fundit, mendohet të jetë më i vjetri në botë. Audioklipi është ekspozuar në galerinë e Dubait. Thuhet se është regjistruar 130 vjet më parë. Ai është regjistruar nga Hurgonje Snouck Christiaan, një qytetar holandez, gjatë një udhëtimi në qytetin e shenjtë të Mekës në vitin 1885. Është regjistruar surja 93 e Kur’anit, “ED-DUHA”. Këndimi i Kur’anit është regjistruar me cilindrat e dyllit, të sapozbuluar nga Thomas Edison.



Dorëshkrime të rralla të Kur'anit u zbuluan në Jemen

Ministri i Kulturës i Jemenit tha se rreth 1250 kopje të dorëshkrimeve të rralla të Kur'anit janë zbuluar në kryeqytetin e Jemenit, në Sana'a. Dorëshkrimet, datojnë nga shekujt XIV dhe XV. Ato u zbuluan në xhaminë "Salahaddin", në Sana'a. Sipas Mukbil el-Tam al-Ahmadi, zyrtar në ministrinë e kulturës, tha se disa prej dorëshkrimeve të zbuluara të Kur'anit janë të praruara dhe disa janë të shkruar në pergamenë. Ai tha se dorëshkrimi më i vjetër i Kur'anit të Shenjtë është në Jemen. Arkivi Qendror i Jemenit në Sana'a tashmë ruan qindra kopje të dorëshkrimeve të Kur'anit të Shenjtë. Disa nga kopjet datojnë që në vitet e para të ardhjes së Islamit. Shumë prej dorëshkrimeve janë kopje të rralla të shkruara në pergamenë ose në lëkurë viçi.



SUMMARIES

Sayyid Abul A'la Maududi

Muhammad's Prophethood

(Peace and blessings of Allah be upon him and his family!)

The Greatest Revolutionary

Throughout the long course of world history, sublime figure of this great man rises above other great people of all times. He cogitates and deeply meditates. He is looking for the light, which obliterates the full darkness. He wants to cling to that power, which brings about the destruction of the rotten and disoriented world and lays the foundations of a new best world. And lo, a great revolution befalls his being. Suddenly, his heart is illumined by the Light of God and is provided with the strength he had desired so much. Ai comes out of the cave of Hira, joined the people and addressed them with these words: **"The idols that you worship are absurdities. Do not worship them to any further extent! No mortal being, no star, no tree, no stone, no spirit deserves to be worshiped by man. Therefore, do not lower your head before them! The whole universe, and everything in it, belongs exclusively to Allah Almighty..."**

Drita e Kur'anit - Nr. 1 - 2015



Hajj Vullnet Merja

The Prophet of Mercy (Peace and blessings of Allah be upon him!)

Prophet Muhammad (Peace and blessings of Allah be upon him and his family!) Is the last link of the chain of prophets of Allah Almighty. He was charged with the mission of completing the building, whose foundations were laid by the previous prophets. Allah Almighty has made the Prophet Muhammad (Peace and blessings of Allah be upon him and his family!) a perfect example and role model for the whole humanity. Referring to this, Allah says in the Qur'an: **"Indeed in the Messenger of Allah you have a good example to follow for him who hopes for (the meeting with) Allah and the Last Day, and remembers Allah much."** (Noble Qur'an, 33:21)

Abdu Daem Kaheel

Scientific Arguments from the Qur'an VII

In this article we are acquainted with some scientific arguments from the Qur'an, such as the explosion of the star in the sky, galaxy and smoke, water partialness, polar days, the plants requiring help, the illusive dawn, observing the space, lava and Jahannam, a bird that discerns the fish, our galaxy etc....



Metush Skeja

Brain and Education

In everyday life we say “this man is smart enough and I would like to be like him.” Such assessments are associated with the function and quality of other’s brain capacity. The brain is the work of genes or encoded set of instructions. The brain encodes experiences, directs behavior, systematizes the thoughts and emotions. The brain varies depending on the education we receive. The brain is constantly restructured depending on education and the environment. Psychologists say that the genes have as many points as education or probably, a bit more. Genotype is the probability, potential, while education converts probability into reality.

Qani Banaj

There is a Remedy for Every Disease

The article provides the healing properties of sweet basil, bush, virgin’s bower or clematis virginiana, visci herba, gillyflower, wormwood herb, black wormwood, estragon, thyme, lettuce, bitter lettuce, fever grass, cyclamens, blackthorn, hawthorn, wild fennel, mild fennel, pumpkin, hazelnut, etc.

Prof. Mezbah Yazdi

Allah’s Deeds Are not Temporal

As it is known, Allah exists outside of time, but He created the time. Allah exists without a place, but He created the place. But everything



in this world exists in time and space. Then, is the relationship between Allah and the things that have time and space, temporal or atemporal? At present, it is proved that the length, width and size are overall dimensions of material existence. The time is the same, too. It is another dimension. Everything has its specific time, as it has the length, the width and its particular size.

Muhsin Keraeti

Lessons from Surah “Al-Baqarah”

There are many lessons in the Qur’anic verses. In this article are presented some lessons from Surah “Al-Baqarah”, such as: Revelation, amendment or cancellation of the decisions is only up to God and according to the needs of humanity and His wisdom, God makes decisions to change or cancel a law or a regulation. Genuine peace, in this world and in the Hereafter, may only be provided under the shadow of faith, piety and good deeds. The man who is yielded before Allah and relies upon Him, is not afraid of anybody or anything; God defines the status of people according to their merits. Various events are just trials of God for the people to prove their merits and capabilities for a given task, etc.

Naser Mekarim SHIRAZI

Qur’an, the Eternal Miracle

The Qur’an is a book far beyond human capacity. Until now, no one has been able to create and provide us a book with the same values. This blessed book among all the miracles of the Prophet is considered the most powerful and vivid document for the



prophethood of the last Prophet, because the Qur'an is a speaking miracle; It is an eternal, spiritual and ubiquitous miracle. Qur'an challenges every disbeliever who pretends to create a similar surah like that of Qur'an. And their inability to do this is an obvious proof for the authenticity of Divine Revelation; it is a miracle of Allah Almighty.

Vullnet Merja

Qur'anic Glossary: Jinns (Genies)

Jinns are invisible creatures and we, humans, cannot discern them visually as we see each other. The Qur'an refers to the world of jinns. There is a surah named "Jinn" in the Qur'an. Jinns were created from fire. This is proved through the verse no.15 of Surah "*Ar Rahman*", which says: **"... and He created the jinn from a smokeless flame of fire."** Jinns were created before Adam (Peace be upon him!), as it is stated in verse no. 27 of Surah "*Hijr*": **"... and the jinn we created before from the scorching fire."** What is particular about jinns is that they see us, but we do not see them. Almighty Allah, in Surah "*Al-A'raf*", verse no. 27 says: **"He and his retinue see you, from where you do not see them."** Jinns are believers or non-believers. They will render account on the Day of Judgment.

Osman Nuri Topbash

Prophet Shu'ayb (Peace be upon him!)

Prophet Shu'ayb was sent as a prophet to the Madyan and Jakes population. The Messenger of Allah (Peace and blessings of Allah



be upon him and his Progeny!) said: *“Their brother Shu`ayb was sent to the Medyans and Jakes as a Prophet.”* After the destruction of the two nations, Shu`ayb returned to Mecca accompanied with those who had confidence in him. There he passed the last days of his life. He was buried in Al- Hatim.



ملخصات

الحاج/ فولنت مريا

نبي الرحمة

(صلاة الله وسلامه وبركاته عليه و على آله)

إن النبي محمد (صلاة الله وسلامه وبركاته عليه وعلى آله) هو الحلقة الأخيرة في سلسلة أنبياء الله سبحانه وتعالى. إنه مكلف بمهمة خاصة ليتم البناء الذي أرسى أسسه الأنبياء السابقون. إن الله سبحانه وتعالى جعل النبي (صلى الله عليه وآله) أسوة والنموذج الأحسن للبشرية كلها كما يقول الله سبحانه وتعالى لهذه الحقيقة في القرآن الكريم: «لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا» (سورة «الأحزاب» الآية رقم ١٢).

عبد الدائم كحيل

أدلة علمية في القرآن الكريم

يعرفنا هذا المقال على بعض أدلة علمية موجودة في القرآن الكريم مثل انفجار النجمة في السماء ومجموعات النجوم والدخان والنباتات التي تطلب الغوث والفجر الكاذب والنظر إلى السماء واليابسة النارية التي تطلقها البراكين والجحيم والطير الذي يرى السمك ومجموعة نظامنا الكوكبي الخ.



مَتَوْش إِسْكيا

الدماغ والتربية

إننا نقول في حياتنا اليومية بأن فلانا ذكي وكان لي رغبة ان اكون مثله. إن مثل هذه التقديرات لها ارتباط بعمل ونوعية دماغ الإنسان. إن الدماغ نتيجة الجينات والوصائف لنظام رقمي دقيق، وأن دماغ الإنسان يحفظ الخبرة التي يكتسبها الإنسان حسب نظام رقمي خاص وهو أيضا يدير التصرفات ويرتب الأفكار والشعور. يختلف دماغ الإنسان حسب التربية التي يتلقاها. هذا وأن الدماغ ينتظم باستمرار حسب التربية والبيئة. يقول أطباء النفس أن للجينات نقاط تتناسب مع التربية وأن لها عدد أكبر من النقاط. إن نوعية الجينات هي للإمكانية والطاقة، بينما التربية تحوّل الإمكانية إلى واقع.

كاني باناي

لكل داء دواء

يعرفنا هذا المقال على الصفات العلاجية للزهور والنباتات البرية والعشبيات وبعض الخضروات المزروعة مثل الصلابة الخضراء وغيرها وكذلك بعض الثمار مثل البندق الخ.



آية الله مصباح يزدي

أمور الله ليست بزمنية

إعلم أن الله تعالى خارج عن الزمان، لكنه هو خالق الزمان، وكذلك ليس لله سبحانه وتعالى مكان ولكنه هو خالق المكان وكل شيء سواه سبحانه وتعالى في هذا العالم له زمان ومكان؛ إذن فإن العلاقة بين الله والأشياء التي لها زمان ومكان هل هي علاقة زمنية أم هي علاقة غير زمنية؟ والآن، فقد ثبت بأن الطول والعرض والحجم كلها مقاييس تخص الكائنات المادية وكذلك الزمان وأن الزمان له مقياس آخر للأشياء المادية. لكل شيء زمان خاص به كما أن كل شيء له طول وعرض والحجم الخاص به.

محسن قرائتي

دروس مستنبطة من سورة «البقرة»

لا شك بأن في آيات القرآن الكريم دروس كثيرة. وفي مقالنا هذا سنتعرف على بعض الدروس الكامنة في سورة «البقرة» مثل: الرسالة وتغيير أو إلغاء القرارات وهو أمر يخص الله سبحانه وتعالى وهذا التغيير أو الإلغاء يجري حسب احتياجات البشرية وحسب حكمته تعالى. إن الله سبحانه وتعالى هو الذي يقرر لتغيير أو لإلغاء أمر ما. هذا وأن الهدوء الحقيقي في عالمنا هذا وفي الآخرة يكون آمناً فقط تحت ظل الإيمان والتقوى والأعمال الصالحة. إن الإنسان المستسلم أمام الله فهو يتوكل فقط على الله ولا يخاف من أي أحد كان سوى الله. إن الله سبحانه وتعالى يقدر مكانة الإنسان حسب جدارته؛ هذا وأن الأحداث المختلفة التي تحدث فهي ليست إلا إختبارات من الله سبحانه وتعالى لكي يتحقق من الناس - بحسب جداراتهم ومؤهلاتهم - المهمة الملقاة عليهم الخ.



إن القرآن معجزة خالدة

إن القرآن الكريم كتاب يفوق عقول الناس. حتى إيماننا هذه لم يستطع أي أحد أن يأتي بكتاب مثل القرآن. إن هذا الكتاب المبارك ضمن معجزات النبي هو البرهان الأقوى ودائم عصري يثبت نبوة النبي الأخير وذلك لأن القرآن معجزة متكلمة، وهو معجزة خالدة وهو أيضا معجزة روحية لكافة العالم. إن القرآن الكريم يتصدى كل كافر ليجتهد بأن يأتي بسورة مثل سورة القرآن. وطبعا فإن الكافر لا يقدر بأن يأتي بمثل هذا العمل وهذا يدل دلالة واضحة على إصالة الرسالة السماوية ويدل أيضا على أن هذه الرسالة منزلة من الله العزيز الجبار.

الحاج/ فولنت مريا

قاموس قرآني: الجن

إن الجن مخلوقات غير مرئية ولذلك فإننا نحن الإنس لانستطيع أن نشاهد الجن كما نرى بعضنا-البعض. يتكلم القرآن عن عالم الجن وفي القرآن الكريم سورة تسمى سور «الجن». إن الجن خُلِقُوا مِنَ النَّارِ كما تشهد هذه الحقيقة الآية رقم ٥١ من سورة «الرحمن»: «وَخَلَقَ الْجَانَّ مِنْ مَّارِجٍ مِّنْ نَّارٍ». ومن خصوصيات الجن أنهم يروننا بينما نحن لانرى الجن. ويقول الله سبحانه وتعالى في الآية رقم ٧٢ للسورة «الأعراف»: «إِنَّهُ يَرَاكُمْ هُوَ وَقَبِيلُهُ مِنْ حَيْثُ لَا تَرَوْنَهُمْ». ومن الجن مؤمنون وغير مؤمنون وأن الجن سيحاسبون يوم القيامة.



عثمان نوري طوب باش

النبي شعيب (صلاة الله وسلامه تعالى عليه)

إن نبي الله شعيب أرسل نبيا لشعب مدين وشعب أيكة. لقد قال رسول الله (صلاة الله وسلامه وبركاته عليه وعلى آله): «إن شعيبا أخي ومن نسل مدين وأرسل نبيا لهم ولأصحاب الأيكة». وبعد هلاك هذين الشعبين، عاد شعيب مع الذين آمنوا إلى مكة وفي مكة قضى الأيام الأخيرة لحياته ودفن في حاتم.



نور قرآن

فصلنامه علمي قرآني

صاحب امتياز: مؤسسه قرآن كريم آلباني

مدير مسئول: شيخ وُلْتُتْ (عباس) مريا

سردبير: پروفيسور دكتور خيرى شهو

معاون سردبير: صبريه فزا

اعضاي هيئت تحريريه:

پروفيسور دكتور بدري بولوكو

پروفيسور دكتور فتحي مهديو استاد دانشگاه پرشستينا (كوزوو)

حاج افندي سليمان رجي - رئيس مشيخه اسلامي کشور مقدونيه

حاج سليم اصطفی

حاج يتمير چيلا

ويرايش ادبي: ليسيدا راماي

صفحه آرايي و جلد: صبريه فزا

شماره: ۱/ ۲۰۱۵ (۳۲)



KUJTESË PËR AUTORËT

Revista pranon me kënaqësi bashkëpunimin e të gjithë teologëve e të studiuesve të Kur'anit dhe të fushave të tjera të shkencës. Prandaj, janë të lutur autorët që të sjellin në redaksi artikuj studimorë që kanë të bëjnë me Kur'anin dhe kur'anologjinë.

Që të shqyrtohen artikujt nga redaksia, autorët janë të lutur të ndjekin udhëzimet e mëposhtme:

- Shkrimi nuk duhet të jetë më shumë se 10-12 faqe kompjuteri, bashkë me një abstrakt.
- Është e detyrueshme gjuha shqipe standarde.
- Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjave *ë* dhe *ç* me *e* dhe *c*.
- Të mos përdoret shkronja e madhe I aty ku nuk duhet.
- Midis shenjës së pikësimit dhe fjalëve pasardhëse të lihet vetëm një hapësirë.
- Citimet në tekst të jepen me shkrim të pjerrët.
- Poshtëshënimet të jepen me numra arabë dhe të numërohen sipas rendit që citohen. Ja, si mund të ishte një shembull poshtëshënimi: Shih M. Golshani, *Kur'ani i Shenjtë dhe shkencat e natyrës*, Tiranë, 2007, f. 73. Librat e pabotuar e dorëshkrimet nuk citohen, por mund të jepen në tekst në kllapa.
- Artikulli të jetë i radhitur në "Word" dhe të dërgohet nëpërmjet postës elektronike (e-mail):

f_quran114@yahoo.com

quranfondation114@gmail.com

